

# ETIKA



**KADERI DHE NËNSHTRIMI**  
OSMAN NURI TOPBASH



**FITIMI HALAL DHE HARAM**  
IREAN EZTYBK



**SUBHANELLAH  
VE BIHAMDIHI**  
MUHAMED EL-GAZALI



**FËMIJËT DHE  
BOTA E LIBRAVE**  
NUREDIN NAZARKO



**TË NDJESH  
RAMAZANIN**  
MEXA RYNA I



**VLERA E NATËS SË KADRIT**  
FERIT PIKU

## ATIJ

i përgjërohet  
gjithçka deri  
në amshim!..



*Shtëpia botuese Progresi  
vjen me 6 libra të rinj, të cilët  
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore  
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë  
individuale dhe shoqërore.*

TË  
RINJ

Një këshillë  
1001 mësimë  
**350 Lekë**  
**3 Euro**



Si edukonte  
Ai (s.a.v.s.)  
**150 Lekë**  
**1 Euro**



101 Parime  
në shërbim  
**200 Lekë**  
**1.5 Euro**



Shqetësimi  
për brezat  
**200 Lekë**  
**1.5 Euro**



Udhëtimi  
drejt Zotit  
**200 Lekë**  
**1.5 Euro**



Shërbimi  
**200 Lekë**  
**1.5 Euro**



Të shpëtosh...

Është bukur të shpëtosh nëse të zë furtuna në det.

Bukur është të shpëtosh edhe kur ndodh ndonjë tërmet.

Po ashtu, bukur është të shpëtosh edhe kur hyn në provim.

Në agjendën e njeriut, bën pjesë edhe përpjekja për të shpëtuar gjatë gjithë jetës.

Kurani vendos para njeriut një agjendë “shpëtimi” të veçantë. Dhe atë shpëtim, e cilëson si shpëtimin e vërtetë. Nëse shprehemi me gjuhën e Kuranit, ky është **“shpëtimi i madh”**.

Të gjitha vështirësitë që përjetohen në këtë botë, janë pika sprovash për një kohë të shkurtër. Ndërsa njeriu, në pikat e tilla të sprovave, shkon e vjen midis frikës dhe shpresës, gjë e cila mbaron së bashku me jetën e përkohshme të kësaj bote.

Kurani, “shpëtimin e madh”, e përkufizon si një shpëtim në botën tjetër. Dhe kjo, mund të shprehet me lumturinë e përjetshme, që është Xheneti dhe shikimi i bukurisë së Allahut.

Mirëpo, ka edhe “katastrofë të madhe”. E shprehur me gjuhën e Kuranit, ky është “dështimi”. Kjo është dalja e rrugës së njeriut drejt e në Xhehenem. **“Sa vendstrehim i keq është ai!”**

Sistemi Dynja-Ahiret që ka ndërtuar Allahu i Madhëruar dhe historia e njeriut brenda këtij sistemi, është historia e ecjes së njeriut drejt shpëtimit ose dështimit të përjetshëm.

Ose do të fitojmë, ose do të humbim!

Nëse e rikujtojmë shembullin e Ibrahimit (a.s.), i cili i përgjerohej Allahut të Madhëruar, duke i thënë: **“...Mos më turpëro ditën kur të ringjallen njerëzit!..”**, do të vërejmë se në vazhdim të asaj lutjeje, ai ka thënë: **“Ditën kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”** (Shuara, 88-89)

As pasuria, as fëmija, as fama, as madhëria dhe asnjë status i kësaj bote, nuk do të jenë shpëtuese atë ditë. Shpëtuese do të jetë vetëm “zemra e pastër”. Kjo, sepse Allahu urdhëron: **“Ejani tek Unë me zemër të pastër!”**

Zemra e pastër është ajo zemër që ka punuar për të arritur pjekurinë e duhur për të dalë para Allahut të Madhëruar. Zemra e pastër është një zemër e brumosur me kriteret e Kuranit. Zemra e pastër është një zemër “e ngopur me përkujtimin e Allahut”. Zemër e pastër është një zemër që ka fituar disiplinën e të jetuarit sikur është duke e parë Allahun dhe një zemër që përçon tek të gjitha organet vetëdijen e kriterëve hyjnore. Kjo është zemra e një myslimani të mirë. Shpëtimi i madh, është të bëhesh mysliman i mirë. Lum ai që nxjerr para Zotit myslimanizmin e tij të mirë!

## Qershor 2016

VITI: X

NUMRI: 99

## BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

## DREJTOR

Albert Halili

## KRYEREDAKTOR

Alban Kali

## REDAKTOR

Zija Vukaj

## PËRKTHYES

Albert Halili

Artur Tagani

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

## DIZAJN

Bledar Xama

## ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

## MOBILE

+355 67 607 8484

## E-MAIL

rev.etika@gmail.com

## WEBSITE

www.progresibotime.com

## KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 44 11 9848

## MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

## ABONIMI VIJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



# Përmbajtja



16

Idnetiteti ynë mysliman  
dhe vëllazëria islame  
Halil Ibrahim Delen



Kaderi dhe nënshtrimi  
Osman Nuri Topbash

34



10



40

Të humbasësh, ndërkohë  
që pandeh se je duke fituar  
Ahmet Zijan

- 5 Të shpëtosh  
Ahmet Tashgetiren
- 8 Ramazani dhe agjërimi  
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 10 Ekuilibri  
Dr. Halis Demirxhan
- 12 Kurani dhe Ramazani  
Ali Byjyqçapar
- 13 Të ndjesh Ramazanin  
Nejla Gynaj
- 14 Umberto Eco dhe Zaha Hadid  
Prof. dr. Et'het Xhebexhiollu
- 18 Të jesh mirënjohës ndaj mirësive  
B. Xhahit Ezedemir
- 20 Fëmijët dhe bota e librave  
Nuredin Nazarko
- 24 Fitimi hallall dhe haram  
Irfan Ežtyrk



44

Subhanellahi ve bihamdih

Muhamed El-Gazali

Frika ndaj Allahut

Selma Çevikollu

Mrekullitë e Kuranit

Një Ajet - Një Hadith

Përgëzoji durimtarët

Sami Gëksyn

Rënia dëshmor, pozita më sublime pas profetësisë

Asc. prof. dr. Mustafa Karabaxhak

Marrëdhëniet religjion-shkencë

në procesin e iluminizmit të shekullit të 18-të

Ahmet Meral


Shqetësimet e kësaj bote dhe frika ndaj Allahut

M. Ali Eshmeli

Vlera e Natës së Kadrit

Ferit Piku


Të humbasësh në shqetësimet e kësaj bote  
Sami Byjyqçajnak



50

Mirësitë e agjërimin dhe urisë  
M. Sami Ramazanollu

58







# TË SHPËTOSH

— { Ahmet Tashgetiren } —

Të shpëtosh...

Është bukur të shpëtosh nëse të zë furtuna në det.

Bukur është të shpëtosh edhe kur ndodh ndonjë tërmet.

Po ashtu, bukur është të shpëtosh edhe kur hyn në provim.

Në agjendën e njeriut, bën pjesë edhe përpjekja për të shpëtuar gjatë gjithë jetës.

Kurani vendos para njeriut një agjendë “shpëtimi” të veçantë. Dhe atë shpëtim, e cilëson si shpëtimin e vërtetë. Nëse shprehemi me gjuhën e Kuranit, ky është **“shpëtimi i madh”**.

Të gjitha vështirësitë që përjetojnë në këtë botë, janë pika sprovash për një kohë të shkurtër. Ndërsa njeriu, në pikat e tilla të sprovave, shkon e vjen midis frikës dhe shpresës, gjë e cila mbaron së bashku me jetën e përkohshme të kësaj bote.

Kurani, “shpëtimin e madh”, e përkufizon si një shpëtim në botën tjetër. Dhe kjo, mund të shprehet me lumturinë e përjetshme, që është Xheneti dhe shikimi i bukurisë së Allahut.

Mirëpo, ka edhe “katastrofë të madhe”. E shprehur me gjuhën e Kuranit, ky është “dështimi”. Kjo është dalja e rrugës së njeriut drejt e në Xhehenem. **“Sa vendstrehim i keq është ai!”**

Sistemi Dynja-Ahiret që ka ndërtuar Allahu i Madhëruar dhe historia e njeriut brenda këtij sistemi, është historia e ecjes së njeriut drejt shpëtimit ose dështimit të përjetshëm.


Ose do të fitojmë, ose do të humbim!

Allahu i Madhëruar, ia tregon njeriut edhe rrugët e shpëtimit të përjetshëm edhe shkaqet e dështimit.

Sprova e njeriut është që më parë të vetëdijsohet ndaj këtij udhëtimi, ndaj marrëdhënies me Allahun e Madhëruar, ndaj kësaj bote dhe botës tjetër. Kjo, e vë njeriun përballë një përgjegjësie të madhe. Përgjegjësisë së vlerësimit të kësaj bote në atë mënyrë që të fitojë shpëtimin e përjetshëm.

Ka prej njerëzve që arrijnë ta kuptojnë këtë dhe e marrin seriozisht jetën e kësaj bote. Por ka prej atyre që siç shprehet edhe Kurani, **“e pandehin botën vetëm si lojë dhe argëtim”**. Ata e perceptojnë





botën si një vend ku do të qëndrohet përgjithmonë dhe, prej lumturive të kësaj bote, dëshirojnë të shkojnë drejt paqes së pafundme. Ndërsa prej hidhërimeve të kësaj bote, ngarkohen me vuajtje pambarim.

Profetët dhe të dashurit e Allahut, të cilët ndoqën gjurmët e tyre, e paralajmërojnë njeriun: *“Mos u mashtro prej kësaj bote!”* Ndërsa besimtarët e ndjeshëm që ua vënë veshin këtyre paralajmërimeve, në zemrat e tyre bartin vazhdimisht ndjenjën e frikës dhe shpresës, pra *“hauf dhe rexha”*.

Të japësh frymën e fundit me besim, të të rëndojnë sevapet në peshore, të dalësh para Zotit faqebardhë dhe të mund të kalosh Urën e Siratit, që është më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se shpata... Këto janë përgjegjësi të besimtarëve, të cilat ripërsëriten si kriza zemre. Një profet si Ibrahim (a.s.), lutet duke u strehuar në mëshirën e Mëshiruesit: *“Mos më turpëro në ditën kur do të ringjallen njerëzit...”* (Shuara, 88)

Në një tregim që i atribuohet Hasan Basriut (rahmetullahi alejhi), thuhet:

Një ditë kur ishte duke kaluar në rrugë, takohet me një njeri shumë të gëzuar e të qeshur dhe e pyet:

“O vëlla! Ke kaluar Siratin?” Njeriu i tha:

“Jo!” Kur dëgjoji këtë përgjigje, ai e pyet sërish:

“Mirë, po a do të shkosh në Xhenet apo në Xhe-

henem? A e di këtë?” Njeriu përsëri i përgjigjet:

“Jo!” Atëherë, Hasan Basriu i thotë atij njeriu:

“Allahu të dhëntë shëndet! Po pse qesh kaq shumë? Mos harro se Dita e Kiametit është shumë e ashpër!..”

Po, ajo ditë është një ditë e vështirë. Ajo është dita kur njeriu ikën prej vëllait, nënës, babait, gruas dhe fëmijëve të vet, dita kur të gjithë shikojnë hallin e vet. Ja pra, shpëtim do të thotë të kapërcesh atë potere dhe të dalësh në bregun e shpëtimit, duke arritur në një vend ku përshëndetesh nga melekët. Atje, shkohet prej këtu. Prej kësaj bote. Duke qenë mysliman në këtë botë.

Fakti që Profeti ynë (a.s.), në letrat që u dërgonte mbretërve, shkruante: *“Prano Islamin dhe shpëto”*, është një rezultat i paevitueshëm i sistemit Njeri-Dynja-Ahret, të cilin ka ndërtuar Krijuesi i Gjithëpushtetshëm.

Islami është shpëtim. Shpëtimi vjen me Islamin. Ky është sistemi i Allahut. Ata që tregojnë rrugë të tjera shpëtimi, duhet ta shpjegojnë në një formë tjetër njeriun dhe gjithësinë, krijimin e Allahut, rregullin që ka vendosur Ai dhe përfundimin me Kiamet. Por një shpjegim i tillë nuk është i mundur. Do s’do, njeriu gjendet brenda këtij rregulli dhe po udhëton në këtë aventurë.

Nëse do shpëtimin e përjetshëm, ai duhet të kuptojë sistemin e Krijuesit dhe t’i përshtatet atij. Pasi të kemi përvetësuar “agjendën e shpëtimit”, të





cilën Zoti ynë e ka vënë para nesh me anë të profetëve, ajo që duhet të bëjmë për të arritur “shpëtimin e madh”, është të njohim ato që kërkohen prej nesh dhe në bazë të tyre të sistemojmë “jetën e kësaj bote”.

Sistemi njerëzor që sollën të dërguarit e Allahut, është i gjithi një kuadër shpëtimi. Nëse e shohim nga ky këndvështrim, të gjitha kriteret që përmban Kurani Fisnik, e kapin njeriun përdore dhe e çojnë drejt “shpëtimit të madh”. Dhe, përderisa të ndiqen gjurmët e të Dërguarit të Allahut, i cili i dha jetë Kuranit, rruga e njeriut do të jetë shpëtimi i madh.

Allahu i Madhëruar, urdhëron:

**“O besimtarë! Binduni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!..”** (Enfal, 24)

Drejt thirrjes së Allahut dhe të Dërguarit të Tij, edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër... Për këtë arsye, ta konsiderosh Kuranin si një udhëzues shpëtimi, e ta mbash atë si një udhërrëfyes i rrugës së shpëtimit, është përgjegjësia jonë. Dhe për të arritur këtë duhet që edhe Kuranin, edhe Profetin (a.s.), që ishte një Kuran i gjallë, t’i lexojmë me kujdes të madh dhe me zemër të hapur.

Jemi të detyruar ta lexojmë, ta mësojmë dhe ta jetojmë. Kurani, i cili si një mesazh i fundit i shpëtimit që i ka ardhur njeriut prej Allahut, ka shpalosur para të gjithëve sprovën e kësaj bote për njeriun, që prej Ademit (a.s.), pra, prej njeriut të

parë. Në të gjitha tregimet që tregohen në të lidhur me njerëzimin, gjenden edhe shembujt e dështimit, edhe shenjat për rrugën e shpëtimit.

Për shembull:

Nëse e rikujtojmë shembullin e Ibrahimit (a.s.), i cili i përgjerohej Allahut të Madhëruar, duke i thënë: **“...Mos më turpëro ditën kur të ringjallen njerëzit!..”**, do të vërejmë se në vazhdim të asaj lutjeje, ai ka thënë: **“Ditën kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”** (Shuara, 88-89)

As pasuria, as fëmija, as fama, as madhëria dhe asnjë status i kësaj bote, nuk do të jenë shpëtuese atë ditë. Shpëtuese do të jetë vetëm “zemra e pastër”. Kjo, sepse Allahu urdhëron: **“Ejani tek Unë me zemër të pastër!”**

Zemra e pastër është ajo zemër që ka punuar për të arritur pjekurinë e duhur për të dalë para Allahut të Madhëruar. Zemra e pastër është një zemër e brumosur me kriteret e Kuranit. Zemra e pastër është një zemër “e ngopur me përkujtimin e Allahut”. Zemër e pastër është një zemër që ka fituar disiplinën e të jetuarit sikur është duke e parë Allahun dhe një zemër që përçon tek të gjitha organet vetëdijën e kriterëve hyjnore. Kjo është zemra e një myslimani të mirë. Shpëtimi i madh, është të bëhesh mysliman i mirë. Lum ai që nxjerr para Zotit myslimanizmin e tij të mirë!





# RAMAZANI DHE AGJËRIMI

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Ramazani është muaji i agjërimit, Kuranit dhe mëshirës. Ramazani ka një klimë të pasur, pasi është muaji kur ka nisur të shpallet Kurani dhe kur është bërë obligim agjërimi, si një nga pesë kushtet e islamit. Ajo që e bën Ramazanin muaj të madhërueshëm është Kurani dhe agjërimi. Agjërimi është një adhurim që Allahu i Madhëruar e ka lartësuar me fjalët “Agjërimi është për Mua. Shpërblimin ia jap vetëm Unë.” (Buhari, Savm, 2.) Ky hadith kudsî ka dy domethënie:

1. Agjërimi zë një vend të veçantë në mesin e adhurimeve. Ndryshe nga adhurimet e tjera, vetëm agjërimi është një adhurim që tjetri mund të mos e vërejë, për vetë karakteristikën e tij, që nuk është diçka që shfaqet. Agjërimi është adhurimi më afër statusit të *ihsan*-it (të adhurosh Allahun, sikur e sheh Atë).

2. Në agjërime manifestohet atributi “Samed” i Allahut. Ky atribut ka kuptimin që gjithçka dhe gjithkush ka nevojë për Allahun, ndërsa Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe askënd. Në sajë të agjërimit, tek njeriu manifestohet pikërisht atributi në fjalë, duke u shkëputur nga nevoja e të ngrënit dhe të pirit. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar u drejtohet “Shpërblimin ua jap vetëm Unë!”, atyre që veshin petkun e atributit dhe moralit të Tij.

Allahu premton për ata që bëjnë vepra të mira, që do t'i shpërblejë nga dhjetë deri në shtatëqind fish. Porse, për ata që bëjnë sabër, shpërblimin do ta kënë të pafund. (Kurani, Zumer, 10). Duke u nisur nga thënia profetike “Agjërimi është gjysma e durimit”, kuptojmë se agjërimi njëkohësisht është edhe një veprim prej durimi, andaj dhe shpërblimi

është i pamasë.

Agjërimi nuk është vetëm një veprimtari fizike që kufizohet me lënien mënjane të ushqimit. Për të arritur qëllimin e tij agjërimi, si edukues i vullnetit të njeriut, frenues i egos (nëfshit) dhe sistemues i mendimeve me qëndër ibadetin, duhet mbajtur edhe me këto organe:

**1. Syri** duhet ruajtur që të mos shohë të ndaluarat, të dyshuarat dhe të panevojshmet.

**2. Veshi** duhet ruajtur që të mos dëgjojë gjëra të ndaluara, gjëra që janë gjynah dhe që prishin natyrshmërinë e njeriut.

**3. Gjuha** duhet mbajtur larg fjalëve të kota, të panevojshme, thashethemeve dhe shpifjeve.

**4. Zemra** duhet mbushur me dashuri për Allahun dhe duhet pastruar nga mendimet e ndaluara dhe ambiciet e panevojshme.

**5. Dora** duhet mbajtur larg gjërave të ndaluara, të dyshuara dhe të shëmtuara.

**6. Këmba** ruhet duke mos ecur në udhën e diçkaje që nuk të është urdhëruar apo kërkuar nga Zoti.

Ebu Talib Mekki tërheq vëmendjen tek këto gjashtë pika dhe kujton se agjërimi, duke bërë kujdes këto organe, sjell virtyt tek agjëruesi. Agjërimi nuk është thjesht një adhurim që realizohet duke qëndruar pa ngrënë e pa pirë. Ka prej *evlijave* që mendojnë se edhe thashethemet prishin agjërimin, të paktën heqin shpërblimin shpirtëror të agjërimit. Qëllimi i agjërimit nuk është të qëndruarit pa ngrënë dhe pa pirë, por është të jetuarit pa gjynahe, ashtu sikurse qëllimi i namazit është të qëndruarit larg fjalëve





dhe sjelljeve të shëmtuara. Pa hequr dorë nga gënjeshtria dhe të vepruarit me të, Allahu nuk ka nevojë për qëndrimin tonë pa ngrënë e pa pirë.

Të agjërosh është të përpiqesh të kontrollosh nefsën dhe dëshirat e përkohshme dhe të prishura. Padyshim, edhe kjo ka kushtet e veta. Krahas ruajtjes së stomakut nga ngrënia dhe pirja, ruan organet e lartpërmendura dhe të gjithë trupin nga rënia në kundërshtim me sheriatin. Kësaj i thonë agjërimi me pesë shqisa.

Allahu e ka krijuar njeriun, si gjallesë që ka nevojë të marrë ushqim për të vazhduar jetën e tij. Mirëpo kjo nevojë, nuk duhet të bëhet objektivi i jetës së njeriut. Në këtë kontekst, nefs i duhet ruajtur nga lojrat dhe dëfrimet e padobishme, pra duhet qëndruar larg gjërave të ndaluara dhe të kota. Çdo vepër e atij që ruan veten nga gjynahet, ka vlerën e agjëritit.

Le të kujtojmë diskutimin e famshëm: “Bota ekziston për njeriun për t’a ushqyer apo për t’i dhënë mundësinë që të jetojë?” Njerëzit e Zotit rekomandojnë ushqim aq sa për të jetuar dhe për të pasur fuqi për të bërë ibadet. Ndërsa *ehlu’d-dunja* (njerëzit e dynjasë) preferojnë të jetojnë për të ngrënë. Njeriu që jeton me qendër ushqimin, nuk shpëton pa u kapur nga grepi i Iblisit. Sepse profesioni i Iblisit është t’ia bëjë sa më të dashur njeriut ngopjen.

Shkaku përse u nxor nga xheneti Hz. Ademi, ishte tamahu për ushqim, dëshira për të ngrënë frutin e ndaluar në Xhenet. Sikurse në çdo adhurim, edhe në agjërim, qëllimi i tij është sinqeriteti dhe devocioni. Besimtarët e mençur veprojnë me sinqeritet dhe bëjnë kujdes për të qëndruar larg dyfytërisë, e cila ua zhvlerëson veprat e mira.

Qëllimi i agjëritit është vendosja e ushqimit në vendin e tij të vërtetë, në rolin e nevojës sa për të jetuar, duke mundur nefsën dhe frenuar dëshirat. Kur ushqimi është në këtë status edhe mundësia për të bërë haram është më e paktë. Pasi, duke ngrënë haramin, veshi dëgjon gjëra të padobishme dhe gjuha afrohet më pranë gjynahut. Andaj dhe Allahu i Madhëruar thotë: **“Ata janë dëgjues të gënjeshtres dhe e hanë me kënaqësi të madhe atë që është e ndaluar.”** (Maide, 42)

Nëse agjëruesi, pasi çel yftarin, ka shenja pa-

vullneti për ibadete, ai menjëherë duhet kuruar.

Kura është shuarja e ushqimit përmes faljes së namazit, leximit të Kuranit, dhikrit, istigfarit dhe duave që ai do bëjë. Andaj dhe Profeti (a.s.), thotë: **“Shuani ushqimin përmes dhikrit.”** (*Keshfu’l khafa* I, 74, nga Evsati i Taberanit)

### LLOJET E AGJËRIMIT

Agjërimi kryesor dhe i obliguar është agjërimi i muajit të Ramazanit. Për t’u dhënë mundësinë besimtarëve që të arrijnë në shkallën e devocionit, ka edhe agjëtime të tjera përveç agjëritit të Ramazanit:

**1. Savmu’d-dehr:** agjërimi gjatë tërë vitit, pa shkëputje. Ky lloj agjërimi nuk është rekomanduar, madje konsiderohet mekruh.

**2. Agjërimi i Daudit (a.s.):** ky lloj agjërimi, ashtu sikur vepronte Daudi (a.s.), është një ditë të agjërosh e një ditë të mos agjërosh. Dita e agjëritit është një urë për tek *sabri* (durimi), ndërsa dita jo agjërueshëm është urë lidhëse me *shukrin* (mirënjohjen).

**3. Agjërimi i ditëve të bardha:** është agjërimi i ditëve 13, 14 dhe 15 të muajve hënorë. Thuhet se, kur zbriti në tokë Ademi, trupi i tij ishte bërë i zi nga gjynahu. Kur iu pranua pendimi i tij, Allahu i urdhëroi agjërimin e ditëve të bardha. Çdo ditë i zbardhej 1/3 e trupit të tij dhe në ditën e tretë, zbardhej i tëri. Për respekt të tij dhe për arsye të ndikimit që shkaktonte lëvizja e hënës mbi trupin e njeriut, është këshilluar të agjërohen këto ditë.

**4. Agjërimi i të hënave dhe të enjteve:** është një agjërim që është këshilluar për të kontrolluar nefsën dhe për të mos u bërë agjërimi rutinë.

**5. Agjërimi i muajit Shaban:** pas muajit të Ramazanit, muaji që Muhamedi (a.s.), agjëronte më së tepërmi, është ai i Shabanit. Gjysma e parë ose e dyta e muajit Shaban mund të agjërohet. Mund të agjërohet edhe më pak ose edhe më shumë se kaq.

**6. Agjërimi i muajit Sheval:** agjërimi i dhjetë ditëve të muajit Sheval, si përcjellës të muajit të Ramazanit.

**7. Agjërimi i muajve Dhulhixhxe dhe Muharrem:** është mustehab agjërimi i dhjetë ditëve të para të këtyre dy muajve. Veçanërisht agjërimi i ditës së dhjetë (Dita e Ashures) ose 9-10, apo 10-11 të muajit Muharrem.

Gjatë rrugëtimit tek Allahu, agjërimi luan një rol me rëndësi të veçantë për përgatitjen e devocionit. Besimtarët e mençur, kërkojnë mëshirë nga Allahu, duke pasuruar zemrat e tyre me agjërim edhe jashtë atmosferës së Ramazanit.





# Ekvilibri

Dr. Halis Demirxhan

Njerëzit, siç ndodh edhe sot, në çdo periudhë të historisë e kanë dashur natyrën, e kanë punuar tokën për të përfituar prej saj, kanë kultivuar pemë dhe kanë ushqyer kafshë. Por ja që këto sjellje të njerëzve nuk do të thonë se ata e pranojnë këtë rregull: “Çdo krijesë është një vlerë në vete në natyrë.” Ekologjia, domethënë, shkenca e ambientit nuk do të thotë “ambientalizëm”. Ekologjia mund të shpjegohet edhe si mbrojtje e llojeve të specieve, trajtim i kafshëve me mirësi dhe kundërshtim i çdo lloj aktiviteti që mund të shkaktojë ndotjen e ambientit.

Njeriu nuk është ai që e ka filluar jetën në sipërfaqen e tokës apo që e ka vendosur ekuilibrin ndërmjet krijesave, qofshin ato bimë apo kafshë. Madje, edhe vetë njeriu është vënë në ekzistencë brenda këtij ekuilibri. Atëherë, njeriu nuk ka të drejtë të zhdukë ndonjë specie apo ta prishë peshoren/ekuilibrin në asnjë lloj mënyre.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), i cili i ka dhënë mësim njerëzimit edhe në fushën e të drejtave të gjallesave, ka dhënë këtë shembull:

Dikur një Pejgamber kishte shkatërruar një fole milingonash për shkak se e kishte pickuar një milingonë. Nisur nga kjo, Allahu e dënoi këtë veprim të tij. Në këtë dënim të këtij veprimi atij Pejgamberi iu tha: “Si mund ta zhdukësh një umet nga umetet e gjallesave që vazhdimisht më bëjnë dhikër Mua, vetëm e vetëm se të pickoi një milingonë?!” (Përkthimi dhe Shpjegimi i Sahihu’l-Muslim, 5, Ahmed

Davudogllu Kreu i 36-të, 148.)

Ai Pejgamber duhet të ketë vendosur për të hedhur ndonjë ilaç aty duke menduar për njerëzit që mund të uleshin në atë vend pas tij. Por ja që Allahu i Lartësuar nuk e pranoi mendimin e njeriut për shfarosje. Në këtë mënyrë, urdhëroi për mëshirë duke ia bërë të ditur atij Pejgamberi se edhe ato gjallesa e madhëronin dhe e adhuronin Allahun Teala.

Edhe përgjigja, e cila mori Sulltan Sulejman Kanuni nga Ebu’s-Suud Efendi kur e pyeti për lejen e vrasjes së milingonave që dëmtojnë frutat e pemëve në bahçe, është shumë e njohur. Siç shprehet edhe Sejri në poezinë e tij:

“Poseduesi i pozitës e pyeti Ebu’s-Suudin:

Hoxhë, a është mëkat ta vrasësh milingonën në frut?

Dijetari i madh i tha: Nëse e vret, o sulltan,

Nesër do të vijë milingona dhe do ta marrë hakun nga Sulejmani...

Kjo cilësi ishte që e bëri padishahun sundues të botës,

Fati i Sulejmanit me këtë cilësi ishte madhështia.”

Çdo gjë është vënë nën urdhrin e njeriut, por edhe njeriu është i obliguar t’i respektojë rregullat për t’i qëndruar sa më larg shpërdorimit, padrejtësisë dhe egoizmit.

Nëse e shohim historinë e kulturës islame nga ky





këndvështrim, do të vihet re se mendimi: “Kjo natyrë është krijuar mbi një rregull, mbi një masë e mbi një sistem dhe se çdo gjë dëmtohet kur prishet ky ekuilibër.”, është vënë në pah me fenë islame në një mënyrë të vetëdijshme.

Në Kuranin Fisnik, krahas thesareve të pashtershme të gjithësisë, thuhet kështu duke bërë fjalë për ekuilibrin e bimëve dhe kufizimin e mundësive mbi sipërfaqen e tokës:

**“Dhe Tokën e kemi shtrirë e nëpër të kemi shpërndarë male të patundura. Ne kemi bërë që në tokë të rritet çdo gjë në përpjesëtim. E aty kemi bërë mjetet e jetesës për ju dhe për ata që nuk i mbani ju. Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar. Ne i dërgojmë erërat për pllenim dhe zbresim nga qielli ujë, prej të cilit ju japim të pini e të cilin nuk mund ta depozitoni dot.”** (Hixhr, 19-22)

Përfundimisht në gjithësi nuk ka prishje dhe anarki. Universi ka një ekuilibër, një rregull dhe një qëllim. Për këtë arsye, askush nuk ka të drejtë ta prishë këtë ekuilibër dhe rregull. Ndotja e ambientit apo mospastrimi i tij nga papastërtia është një mëkat i madh nga aspekti i sistemit hyjnor në gjithësi, por ja që njerëzimi, për shkak të pangopësisë, lakmisë për të fituar epërsi e superioritet kundrejt të tjerëve dhe agresivitetit që e nxjerrin në pah këto, e ka futur natyrën në një gjendje saqë kërcënon edhe ekzistencën e tij. Përsëri në Kuranin Fisnik thuhet kështu kur bë-

het fjalë për prishjen e tokës dhe të deteve për shkak të atyre që njerëzimi bën dhe vazhdon të bëjë:

**“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t’i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).”** (Rum, 41) Për këtë arsye, përgjegjësi i vetëm për rënien në këtë gjendje të ambientit është tipi i njeriut kapitalist, imperialist dhe kolonizues.

Këta njerëz që kanë mentalitet materialist, në të cilin interesat egoiste mbahen në plan të parë, po e shkatërrojnë ambientin dhe po i përdorin burimet e resurset pa vend e pa kriter duke i shpërdoruar në mënyrë të pavetëdijshme. A mund të ngopen me mundësitë e kufizuara të kësaj bote zemrat dhe sytë e atyre që nuk ngopen me besim e iman? Ngaqë natyra është një amanet që njerëzimit i është dhënë nga Allahu, xhel-le xhelaluhu, po ashtu, ngaqë njeriu është po ai që po e ndot dhe po e shkatërron këtë amanet, do të thotë se problemi i vërtetë rezulton në ndotjen e vetë njeriut.

Në botën që kanë ndërtuar njerëzit e privuar nga dashuria, ndërgjegjja e mëshira, njerëzit e pangopur dhe egoistë, sigurisht se nuk mund të flitet për sistem dhe harmoni. Prandaj, Allahu i Madhëruar na bëftë prej njerëzve që mjaftohen me atë që u ka dhënë, prej njerëzve besimtarë, prej njerëzve që nuk u janë ndotur sytë e zemra dhe prej njerëzve të devotshëm!

Amin!..



# Kurani dhe Ramazani

Ali Byjyçapar

Agjërimi i Ramazanit, i cili qëndron nën hijen e Kuranit Fisnik, i fal jetës sonë të përkohshme një freski përjetësie. As që mund të mendohet që njeriu, i cili është nderuar me ekzistencën, ta humbë këtë mirësi të madhe.

Në këtë jetë të vështirë, pa dashje në mendje të vjen pyetja, “a ka ndonjë vend lumturie?”. E ndër-sa njerëzit mundohen t’i japin kuptim ndodhive, Ramazani i fton në atmosferën e Kuranit.

Ramazani është muaji i Kuranit.

Libri i pashoq, i cili i tregon njerëzimit mënyrën për të arritur përjetësinë, këtë muaj mbush me dituri hojet e shpirtit. Pastaj me qëllim që t’i përvetësojmë ato (dituri), na vë përpara jetën.

Për të kuptuar jetën, për të thithur të vërtetat brenda kohës së një dite dhe për t’u pajisur me zemra që do të luftojnë me të keqen, kemi nevojë për zërin e Kuranit. Shpëtimi i njerëzve që janë futur në rrugë pa krye, mund të jepet vetëm me Kurantin. Islami, i cili konceptin teori-praktikë e ka shkrirë në enën e punëve të mira, i ka ndaluar edhe debatet e kota që të përziejnë stomakun dhe tërheq vëmendjen ndaj këtyre gabimeve.

Përveç Allahut, kush do të japë informacion më të besueshëm në lidhje me vdekjen, e cila konsumon jetën dhe na e vështirëson çdo ditë që kalon atë?

**Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon**

**këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër, le të agjërojë më vonë aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo t’jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimin dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimin), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë.** (Bekare, 185.)

Agjërimi është një urë vlerash. Nëse njeriu nuk largohet nga mirësitë e përkohshme, nuk mund të arrijë ato të përjetshmet. Nëse fëmija nuk ndërpret qumështin, nuk mund t’i shijojë ushqimet e ndryshme. Në agjërim gjenden shumë gëzime dhe mirësi materiale e shpirtërore, individuale e shoqërore, jetësore e morale.

Fjalët e Profetit tonë të dashur (a.s.), na mbushin me shpresë:

*“Agjërimi dhe Kurani do të jenë ndërmjetësues për robin në Ditën e Gjykimit. Agjërimi është gjysma e durimit. Heshtja e agjëruarit është dhikër, gjumi i tij është adhurim, duaja i pranohet, ndërsa shpërblimi i punës i shumëfishohet.”*

Çdo besimtar duhet ta shfrytëzojë këtë muaj, duke u larguar nga gjynahet dhe të këqijat, duke lexuar dhe dëgjuar Kuran, duke dëgjuar ligjëratat dhe duke falur namazet e teravisë. Nuk duhet ta kalojmë kohën me punë dhe fjalë të padobishme. Ramazani është pranvera e botës shpirtërore, prandaj le ta mbushim bahçen e kësaj bote me dhikër, Kuran dhe salavate për Profetin (a.s.) dhe ta ruajmë atë nga erërat e pakujdesisë.



# TË NDJESH RAMAZANIN

Nejla Gynaj

Edhe këtë vit, muaji i Ramazanit erdhi kur e prisnim dhe gëzoi gjithë rruzullin tokësor... na urdhëroi që të zbukurohem, që të shpëljajmë me mëshirën e tij shpirtat që rënkojnë nën peshën e gjynaheve dhe që të na përfshijë begatia e tij. Ardhja e tij qe gëzim i pastër për të rinjtë, eliksir rinie për të moshuarit.

Agjërimi është çelësi i falënderimit për Allahun që na solli në këtë botë nga asgjëja dhe që na pajisi me begati të panumërta. Ai është edukator i shkëlqyer që edukon shpirtat e besimtarëve. Ai nuk mjaftohet vetëm duke u kujtuar njerëzve se begatitë që zotërojnë nuk janë prona e tyre e përhershme, por i fton të pasurit të ndihmojnë të varfrit në mënyrë që dallimin ekonomik që ekziston ta zhdukë. Po të mos kishte ardhur muaji i agjërimit, atëherë si do ta kuptonin njerëzit që i kanë të gjitha të mirat, hallin e nevojtarëve? Për këtë arsye agjërimi u bë farz për të gjithë pa bërë dallim i varfër apo i pasur.

Besimtarët në muajin e Ramazanit ngjasojnë me një ushtri të rregullt. Të gatshëm nën urdhrin “Urdhëroni!” atëherë kur afron iftari si të ishin të ftuar në gostinë e Mbretit të Përrjetshëm. Zoti e ka pajisur rruzullin tokësor si një sofër të begatë dhe u ka treguar në këtë mënyrë robërve të Tij cilësitë, Rrahman dhe Rrahim.

Adhurimi i agjërimet e forcon lidhjen me Krijuesin dhe bën që fjalët dhe veprimet e manifestuara në ibadete të fitojnë vlera të vazhdueshme. Në të kundërt, atyre që nuk e përfillin aq shumë atë, u shndërrohen agjërimi në uri, mos harxhimi në koprraci dhe bujaria në shpenzim të kotë. Fjalët dhe veprimet e atyre që nuk kanë një lidhje të fortë me Zotin e tyre janë të parëndësishme, sepse jeta fiton vlerë prej saj.

Muaji i Ramazanit fsheh në vete një jetë të përrjetshme në botën e përkohshme. Ata që kalojnë tetëdhjetë vjet të jetës së tyre duke ndjerë frytet e

muajit të Ramazanit janë ata që ruajnë me kujdes brenda sëndukut të veprave, pasurinë e tyre për jetën tjetër. Ramazani është një panair hyjnor që mbulon çdo vend dhe ka vlerë fitimi të madh për biznesin e Ahiretit.

Vlera që e bën aq të rëndësishëm muajin e Ramazanit është Kurani. Për këtë arsye myslimani duhet të përpiket në muajin e Ramazanit të lexojë sa më shumë Kuran, të vërë sa më shumë rregull në jetën e tij shpirtërore, të pajiset sa më shumë me moralin e Kuranit dhe të vërë sa më shumë kufi për kërkesat e nefsit në krahasim me muajt e tjerë...

Duke pasur parasysh edhe paralajmërimin hyjnor të Allahut: **“A nuk mendojnë ata rreth Kuranit? Apo zemrat e tyre janë të kyçura?”** (Muhammed, 24) duhet që ta kuptojmë sa më shumë Kuranin që lexojmë dhe të përpiqemi t’i praktikojmë sa më shumë në jetë ato që lexojmë.

Duhet të përpiqemi që të mos e humbim sihariqin e Profetit tonë se **“Atij që agjëron muajin Ramazanit duke besuar tek savapet dhe begatia e këtij muaji, kanë për t’iu falur gjynahet.”** Nga agjërimi që nuk i bën shpirtat më të singertë, veprat më të drejta, fitimet më shumë hallall dhe moralin më të devotshëm, njeriu përjeton një rrudhje të brendshme.

Ata që e vlerësojnë muajin e Ramazanit që po kalojnë si të fundit në jetën e tyre dhe që përpiqen që të mbledhin sa më shumë trëndafila nga kopshti i lumturisë shpirtërore, inshallah do të jenë të ftuar në botën tjetër. Kur thoni “shpresa e vetme për muajin janë veprat e mia” dhe përpiqeni që të punoni me singritet sipas kësaj fjale, atëherë nuk do ta keni të vështirë që të arrini edhe bukuritë e përhershme të Ramazanit. Zoti na e bëftë të mundur të gjithëve të jetojmë një Ramazan, ashtu siç duhet. Mos na ndaftë nga rruga e Tij dhe mos na turpëroftë përpara Tij!





# Umberto Eco dhe

Edison Çeraj

Afërmendsh që bota zgjohet më e varfër kur ikën prej saj një njeri me vlera dhe kontribute. Dy të tillë ishin edhe Umberto Eco dhe Zaha Hadid, të cilët e lanë këtë botë pak kohë më parë. Tani jemi më pak të ndriçuar.

Nga ana tjetër, megjithatë, ata lanë një vepër nga pas, e cila e vijon rrezatimin pavarësisht pranisë së autorit. Fatmirësisht, si për vetë ata ashtu edhe për ne, nuk ishin prej atyre që, në çastin që ndërron jetë autori/autorja së toku me të mbetet pa jetë edhe vepra, pasi një soj i tillë autorësh përdorin mekanizma nga më të ndryshmit për t'i dhënë jetë e jehonë veprës së tyre, duke qenë se vepra si e tillë nuk ka një jetë të sajën të vetvetishme, të brendshme. Ato thjesht lindin të vdekura.

Pjesa dërrmuese e autorëve të ashtuquajtur ikonë apo figurë publike sot, veçmas në sferën e kulturës, të këtij takëmi janë.

Natyrisht që askush nuk mund të vërë dorën në zjarr për një autor që është akoma kësoane se cili do jetë fati i veprës së tij apo të saj, por, siç thuhet, “moti i mirë duket në mëngjes”.

Kam disa ditë që mendoj të hedh dy fjalë për Eco-n dhe Hadid-in, pa çërmuar mbi asnjë referencë, por shpengueshëm, duke iu falur vetëm asaj ç'më ofron kujtesa për ta.

Mendoj se Eco-ja është shumë më i vyer si mendimtar sesa si artist (romancier në rastin e tij), sidoqë për publikun njihet më shumë për romanet e tij.

Studime si *Të thuash gati të njëjtën gjë, Në kërkim të*

*gjuhës së përkryer në kulturën europiane, Për letërsinë e shumë të tjerë, më kanë dhënë shumëçka, sa mezi po pres që t'u rikthehem. Zaten, një nga shenjat që tregon për vlerën e një libri është pikërisht dëshira për ta rilexuar.*

Tekste si këta që cituam të përfshijnë me frymën poliglote, që ishte një veçori e Eco-s, për faktin se ai qe nga të rrallët historianë idesh dhe kulturologë të kësaj kohe.

*Në kërkim të gjuhës së përkryer në kulturën europiane të tërheq pasuria e ideve dhe mendimeve të cituara (edhe të interpretuara, kuptohet), si dhe fakti që vetë autori i këtij gjerdani nuk zgjedh asnjë syresh për ta na thënë se kjo është ajo që po kërkonim apo ajo që bën dallimin.*

Ai e mbyll këtë studim duke na kërkuar që t'i vështrojmë si pasuri gjuhët e ndryshme që përdorim<sup>1</sup>, siç na mëson Kurani - thotë ai, dhe jo si “mallkim për njeriun”, sikurse na ka mësuar rrëfimi/miti mbi Kullën e Babelit..

Në rrethet e studiuesve mbahet edhe si semiolog, i cili ka hedhur dritë mbi dhjetëra shenja, imazhe, gjurmë, simbole e kështu me radhë, duke na dhuruar kështu një hartë e cila na mungonte në këtë drejtim. Në njëfarë mënyre, romanet e tij janë vazhdim i kësaj dritëdhedhje përmes një forme tjetër, le të themi më të “lëngshme”, më “pop”, siç është romani në kulturën tonë.

1. Përtej çështjes fort të koklavitur se cila është protogjuha apo gjuha adamike.



# The Zaha Hadid

Ishte edhe një skrupuloz mbresëlënës, edhe koleksionues i fiksuar, në veçanti pas asaj që kish mbetur nga pasuria e rrallë e Mesjetës. Pa harruar bibliotekën e tij labirintike, një konservuese tipike e kujtesës së botës.<sup>2</sup>

Mund të themi se qe edhe një mjeshtër i ironisë. Ja një provë: “E rëndësishme është që vdekja të na gjejë gjallë.” Ose, kur e pyetën se “si shkruani?”, ai u gjegj “nga e majta në të djathtë”.

Nuk po rendis sasi në lidhje me trashëgiminë që la, të llojit që la prapa kaq apo aq studime, kaq apo aq ese, analiza, romane etj., pasi në radhë të parë do ishte acaruese për vetë Eco-n.

Eco-ja ishte edhe një bashkëbisedues që të merrte me vete nëpër terrene imagjinare nga më të papriuriturit, nga më të begatët për çka fshihnin, që ai i zbulonte pa derdhur asnjë pikë djersë (në dukje).

Le të kalojmë tani nga arkitekti i fjalës së shkruar te arkitektja Zaha Hadid. Pako gjë di për jetën dhe formimin e saj. Gjithsesi, hë për hë më mjaftojnë imazhet e ngrehinave gati të tejdukshme e likuide që ajo skicoi e projektoi me aq zhdërvjelltësi.

Pothuajse çdo herë që i kam parë, më ka përcjellë ndjesinë dhe idenë e rezistencës ndaj të ngurtës, të kabashmes, masives, ose e thënë ndryshe ndaj ekspansionit të atyre ndërtimeve që po mpiksin kujtesën e individit dhe të qyteteve, duke na dhënë një pamësi marsiane në Tokë, që e bën qenien të ndihet e huaj.

Pjesa më e madhe e punëve të saj, falë harlisjes që

2. La memoria del mondo.

i karakterizon, duken sikur mbijnë nga toka<sup>3</sup> (natyra) plot gjallëri e po aq të heshtura, - që të kujtojnë format që merr rëra në shkretëtirë - e më pas rikthehen ëmbël po në tokë.

Zaha Hadid i kthen natyrës atë që është e saj, duke ia dhënë me butësi, si një gjethe që bie gjithnjë në vendin e vet, pa u sforcuar aspak për ta stilizuar në emër të së resë apo të së ardhmes.

Kështu, me ikjen e saj, bota dhe natyra ka një rojtare më pak. “Ti do një jetë të lehtë, prandaj mos u bëj arkitekt”, thotë Hadid.

Një prej shqetësimeve të saj ishte se i mungonte jeta në botën arabe, ndër të tjera gjuha. “Ka një qetësi në këto qytete me lumenj të mëdhenj, qoftë Kajroja apo Bagdadi. Ulesh pranë një lumi të tillë dhe mendon se ky lumë rrjedh prej mijëra vjetësh. Ka çaste magjike në këto vende.”

E si jo... Mjafton të lexosh *Njëmijë e një netët*.

Prandaj ajo mendote se arkitektura nuk është vetëm çështje strehe. Arkitektura duhet ta miklojë dhe qetësojë njeriun, dhe mbi të gjitha t'i nxisë mendimin.

Në fakt, mënyra më e mirë për të njohur një autor/e është të reflektosh përballë veprës së tij apo të saj. Ajo çfarë mund të jetë thënë e shkruar për të mund të na ndihë, por në shumë raste bëhet pengesë, për të mos thënë tkurrje apo tjetërsim i mesazhit.

Artistët nuk kanë nevojë për ndërmjetës.

Faleminderit, Umberto Eco! Faleminderit, Zaha Hadid!

3. Pavarësisht se si një bimë të cilën sikur nuk e kemi e parë më parë.





# Identiteti ynë mysliman dhe vëllazëria islame

Halil Ibrahim Delen

Njerëzit njihen me identitete të ndryshme. Ata njihen nga prejardhja etnike, ose nga niveli i arsimimit ose nga xhemati i tyre... Shkurtimisht, njihen me cilësi të ndryshme, por cilësia më e rëndësishme nga të gjitha, më përfshirësja dhe e cila na siguron lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër është “identiteti mysliman”. Të kesh identitet mysliman nuk është diçka edhe aq e thjeshtë. Për ta poseduar këtë identitet, duhet të kryejmë detyra dhe obligime të ndryshme. Njëra ndër këto detyra është “vëllazëria Islame”. Domethënë, të bëhemi vëllezër për hir të Allahut të Lartësuar. Individët që i besojnë Allahut të Madhëruar, që i besojnë të njëjtës fe dhe që mbarin identitetin mysliman, janë njerëz që Allahu Teala i ka bërë vëllezër.

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

**“O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu siç i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”** (Al’ Imran, 102) Domethënë, bëni kujdes dhe mos vdisni duke mos e pasur cilësinë e të qenët mysliman.

Pra, vdisni vetëm duke qenë myslimanë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na njofton se çdo fëmijë lind me natyrshmërinë e Islamit. (Buhari, Xhenaiz, 92; Ebu Davud, Sunne, 17; Tirmidhi, Kader, 5.) Domethënë, të gjithë vijmë si myslimanë në këtë botë. Kështu që Allahu Teala dëshiron që ta vazhdojmë jetën në këtë gjendje, të jetojmë në këtë gjendje dhe ta përfundojmë jetën po në këtë gjendje.

Nëse mendohemi do të shohim se lindja dhe vdekja janë çështje individuale. Njeriu lind i vetëm dhe vdes përsëri i vetëm. Atëherë, përse në ajet thuhet: “Vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”? Përse përdoret urdhri në shumës? Sepse ne kemi shumë nevojë për njëri-tjetrin, në mënyrë që të jetojmë dhe të vdesim si myslimanë. Nëse ne bëhemi vëllezër dhe bashkohemi, atëherë mund ta perceptojmë identitetin Islam, mund të jetojmë si myslimanë dhe mund të ndërrojmë jetë si myslimanë. Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:





*“Besimtarët janë si një trup i vetëm në dashuri, mëshirë dhe dhembshuri ndaj njëri-tjetrit. Kështu që kur sëmuret një organ, pjesët e tjera të trupit i thërrasin njëra-tjetrës (për t’u bërë bashkë me organin e sëmurë) në pagjumësi dhe temperaturë.” (Muslim, Birr, 66.)*

Islami na urdhëron që çdo lloj ibadeti ta bëjmë me vetëdijen e vëllazërisë. Adhurimet na japin frymën e vëllazërisë. Për shembull, adhurimet si infaku, sadakaja dhe zekati nuk mund të bëhen në mënyrë individuale. Për adhurimet si namazi, agjërimi dhe kurbandi, edhe nëse mund të kryhen në mënyrë individuale, Islami na njofton se ato duhet të bëhen me xhemat

dhe duke i ndarë me të tjerët, sepse kjo është më e virtutshme. Madje, falja e namazit të Xhumasë me xhemat dhe përkrah njëri-tjetrit një herë në javë në xhami, mbart një rëndësi të veçantë.

Njëri prej dëmeve të kohës moderne është shkatërrimi i vëllazërisë sonë. Tashmë nuk interesohemi më për gjendjen e njëri-tjetrit, nuk e vizitojmë njëri-tjetrin për hir të Allahut të Lartësuar. Kemi harruar se çfarë është fqinjësia. Tashmë jemi bërë robër të televizorit dhe internetit që kemi në shtëpi... Ndërkohë që nuk është e lejuar që myslimani të rrijë më shumë se tri ditë i zemëruar me myslimanin (Buhari, Isti’zan, 9.), pothuajse jemi bërë sikur jemi zemëruar me njerëzit që banojmë në të njëjtin pallat apo lagje dhe nuk flasim e nuk interesohemi për njëri-tjetrin sikur të ishim armiq. Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), tregon këtë ngjarje që e bën të qartë se vëllazëria myslimane është shkak për fitimin e dashurisë së Allahut Teala dhe se sa mirësi sublime është ajo:

*“Dikush mori rrugën për të vizituar vëllain e tij (në fe) i cili banonte në një fshat tjetër. Allahu Teala dërgoi një engjëll (në formë njeriu) në rrugë për ta sprovuar atë burrë. Kur burri arriti afër engjëllit, engjëlli i tha:*

*“Ku po shkon?” Burri iu përgjigj:*

*“Në këtë fshat kam një vëlla në fe. Po shkoj ta vizitoj.”*

*Engjëlli përsëri e pyeti:*

*“A ke ndonjë interes nga vëllai yt?” Burri ia ktheu:*

*“Jo, unë e dua atë vetëm për hir të Allahut. Prandaj po shkoj ta vizitoj.” Nisur nga kjo, engjëlli i tha:*

*“Siç e do ti atë, edhe Allahu ashtu të do ty. Unë jam dërguar nga Allahu Teala për të të dhënë këtë përgëzim.” (Muslim, Birr, 38; Ahmed, II, 292.)*

Kur myslimanët e humbin ndjenjën e vëllazërisë, në pah dalin vese të këqija të nefsit si smira dhe mungesa e durimit ndaj të tjerëve. Këto e shkatërrojnë entuziazmin për ta zbatuar fenë. Domethënë, e shkatërrojnë identitetin tonë mysliman. Kur t’u hedhim një vështrim kurtheve dhe lojërave që bëhen kundër myslimanëve, vëmë re se janë hedhur farërat e hipokrizisë që i japin fund vëllazërisë myslimane. Ja pra, edhe njëra prej këtyre farërave të hipokrizisë është shpëputja e marrëdhënieve ndërmjet fqinjëve. Njerëzit tashmë nuk mund ta vizitojnë njëri-tjetrin. Njëri prej shkaqeve më kryesore që i ka frenuar këto vizita është shpenzimi që bëhet përgjatë këtyre vizitave. Si rezultat, vizitat janë bërë më të vështira.

Kur të shkojmë për vizitë, nuk duhet të shkojmë me duar bosh. Disa ditë para se të shkojmë, duhet t’i lajmërojmë, sepse do të bëhen përgatitje, do të bëhen shpenzime, etj, etj... Por çfarë ndodh kur veprojmë në këtë mënyrë? Askush nuk dëshiron të shkojë te të tjerët apo askush nuk do t’i pranojë të tjerët për mysafirë... Por ja që njerëzit nuk kanë nevojë për ushqimin e njëri-tjetrit. Ata kanë nevojë thjeshtë për bisedën që bëhet me gjithë zemër, për fytyrë të qeshur dhe për vëllazëri...

Shembulli që tregon një person nga selefu’s-salihin / paraardhësit e devotshëm është një mësim frytdhënës për ne. Ky burrë nga selefu’s-salihin thotë:

*“Allahu ma ka mundësuar që të punoj me të gjithë ajetet e Kuranit Fisnik, përveç një ajeti.”*

Pastaj shtoi:

*“Ai është ky ajete: **“O ju që keni besuar! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje e pa i përshëndetur banuesit e tyre. Kjo është më e mira për ju. Ndoshta do t’ia vini veshin! Nëse atje nuk gjeni askënd, mos hyni derisa t’ju lejohet e, në qoftë se ju thuhet “Kthehuni”, atëherë kthehuni! Kjo është më e mirë për ju. Allahu e di se çfarë bëni ju.”** (Nur, 28)*

Për ta zbatuar edhe këtë ajete, gjithmonë kam trokitur nëpër dyer në kohët më të papërshtatshme dhe në mes të natës, ashtu që të më thoshin “nuk jemi të lirë”, në mënyrë që të kthehesha plotësisht i qetë ngaqë do të veproja sipas ajetit, por pas asnjë dere në të cilën trokita, asnjë nuk më tha: “Nuk jemi të lirë!”, por gjithmonë më ftuan brenda.





# Të jesh mirënjohës ndaj mirësive

B. Xhahit Eëzdemir

Që nga koha e Ademit, (a.s.), shpirti i Kabilit, i cili përfaqëson injorancën, ka ekzistuar gjithmonë dhe është shfaqur në grada të caktuara sipas kushteve. Civilizimi i famshëm i cili u përhap me ndihmën e fesë islame, e cila iu zbrit Hatemu'l-Enbija, (a.s.), i shqeu errësirat e injorancës në formën me influencuese dhe e shpiu këtë botë për shekuj me radhë te oqeani i drejtësisë dhe paqes.

Në shekujt e fundit, shpirti i Kabilit ka rifituar fuqi. Si rezultat i kësaj, shtetet kolonizuese e ndaluan perandorinë osmane, të cilën e shikonin si pengesë përpara ambicieve egoiste të tyre që nuk perceptohen dot nga asnjë logjikë, dhe pasi e detyruan të tërhiqej nga skena e historisë, u bënë sunduesit e ecurisë së kësaj bote. Kjo periudhë, në të cilën po vihen në praktikë planet më të pandërgjegjshme për hir të orekëve që s'dinë të ngopen, emërtohet si "in-joranca moderne" nga dijetari egjiptian Muhamed Kutub. Në këtë periudhë, e cila mund të cilësohet si "brutalitet i përgjithshëm", me mundësitë që ka sjellë edhe teknologjia, bota njerëzore bashkë me pasuritë e saj natyrore po pëson shkatërrimin më të madh.

Të urtët thonë: "Njeriu ha për të jetuar, nuk jeton për të ngrënë." Por njeriu "modern" i kohës sonë që e ka harruar Ahiretin, bën çdo gjë me ambicien për ta ngopur neftin e tij si njerëzit e shturur të Romës së vjetër. Shpërndarja e të ardhurave në botë është aq e çekuilibruar, sa që në vendet e prapambetura me miliona njerëz vdesin nga uria. Ndërsa të pasurit, ndërkohë që i shfrytëzojnë këta të varfrit duke i kolonizuar, po vdesin prej sëmundjeve që sjell

mbingopja. Në ajetin fisnik thuhet: "**Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen** (në përmirësim)." (Rum, 41) Ekuilibri natyror është shkatërruar duke i shfrytëzuar në mënyrë barbare pasuritë natyrore, të cilat i kemi amanet, thjesht për të fituar sa më shumë. Shumë specie bimësh dhe kafshësh janë zhdukur. Për shkak se njeriu, i cili është krijesa më e bukur, e ka kthyer në gërmadhë këtë botë, e cila është më e bukura në gjithësi, njerëzia sot po ndeshet me tragjeditë natyrore. Në një hadith fisnik që ka lidhje me neftin e njeriut, e cila nuk di se çfarë është të mjaftuarit me atë që posedon, thuhet:

"Sikur njeriu të kishte një luginë plot me florinj, do të dëshironte të kishte dy lugina plot me florinj. Sikur të kishte dy lugina plot me florinj, patjetër do të dëshironte të kishte edhe një luginë të tretë plot me florinj. Dëshirat e njeriut nuk kanë të mbaruar. Syrin e tij e ngop vetëm dheu." (Buhari, Muslim.)

Aliu (r.a.), ka thënë:

"Të varfrit ngelin të uritur aq sa të pasurit e shpërdorojnë pasurinë e tyre." Ndërkohë që ka shumë njerëz që përpëliten për shkak të skamllëkut, shpërdorimi i pasurisë nga njeriu dhe të qenët koprrac duke menduar vetëm për vete, është prej sjelljeve më të këqija që nuk përputhen me ndershmërinë e tij. Në Kuranin Fisnik thuhet:

"**O ju që keni besuar! Jepni nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobe-**

**simtarët janë keqbërësit e vërtetë.**” (Bakara, 254) Përdorimi i mirësive, të cilat Allahu, xhelle xhelaluhu, ia ka dhuruar njeriut, me vetëdijen e të dhënit për hir të Allahut dhe altruizmit dhe në përputhje me pëlqimin e Atij, është lumturia më e madhe. Kjo është prej veprave që njeriut do t'i japë përgëzime në Ahiret. Në lidhje me këtë çështje shënohet kështu një sjellje e shkëlqyer e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili është “shembulli më i mirë” nga çdo aspekt për të gjithë:

I Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-selam, e pyeti Aishen, radijallahu anha: “Çfarë ke bërë me delen që u ther në shtëpi?” Ajo iu përgjigj: “E kam ndarë të tërën përveç një kocke shpatulle.” Pasi Pejgamberi mori një përgjigje të tillë, e shprehu kështu gëzimin e tij:

*“E gjitha qenka bërë e jona, përveç një kocke shpatulle.”*

Edhe robërit e devotshëm, të cilët janë miq të Allahut Teala, janë përpjekur ta mbartin këtë ndjeshmëri profetike.

Njëra prej shenjave të disa sëmundjeve psikologjike është harxhimi i parave në mënyrë të pandërgjegjshme dhe në vende jo të duhura. Në kohën tonë, shumë prej njerëzve që nuk e kanë këtë ndjeshmëri sociale, janë shndërruar në maniakë që bëjnë shpenzime të pallogaritshme. Ndërkohë që shoqëria nuk i zgjat këmbët aq sa ka jorganin dhe po zhytet në batakun e borxhit, është mbushur plot me shembuj negativë duke mos toleruar nga pasionet e pamatura si ndryshimi i mobilieve të shtëpisë brenda disa viteve, zgjedhja e mobilieve më të shtrenjta me ambicien për të blerë gjëra prej markave të famshme, të ngrënë, të pirët dhe argëtimi i pakufishëm, etj... Faktor tjetër i rëndësishëm në lidhje me këtë çështje është shfrytëzimi i njerëzve në emër të “modës” për hir të fitimit të disa firmave të caktuara që e nxisin konsumin. Këtë mashtrim të tmerrshëm e shprehin me këtë gazmore:

“Moda është kaq e shëmtuar saqë ndryshohet një herë në gjashtë muaj ngaqë nuk pëlqehet edhe nga vetë stilistët e modës.”

Imam Azami, Ebu Hanife (r.h.a.), thotë:

“Për ta kuptuar se nga ka ardhur një pasuri, duhet të shikojmë se ku shpenzohet.” Kjo çështje është ana tjetër, nga aspekti i paqes shoqërore, e gjendjes së frikshme të cilën po e shtjellojmë dhe e cila shkakton disa tragjedi dhe fatkeqësi familjare.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë për atë që do të vuaj në Ahiret, ndërkohë që u ka lënë pasardhësve

të tij pasuri të madhe, por të fituar me haram:

*“Turp, turp për atë njeri që u lë familjarëve të tij pasuri, ndërkohë që vetë do të dalë në audiencën e Zotit (xh.sh.), me të keqen (barrën e llogarisë së pasurisë që ka fituar).” (Sujuti, el-Xhamiu's-Sagir, nr: 9693.)*

Allahu Teala i ka dhuruar njeriut, të cilin e ka bërë mëkëmbës të Tij në sipërfaqen e tokës, mirësi të pallogaritshme në përputhje me këtë fisnikëri që i ka falur, por sa ia di vlerën njeriu kësaj fisnikërie? Në Kuranin Fisnik thuhet:

**“Allahu e ka bërë natën që ju të pushoni, ndërsa ditën e ka bërë të ndritshme për të parë. Vërtet, Allahu është Dhurues i madh ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës.”** (Gafir, 61) Ndërkohë

që shumë njerëz janë të privuar nga mirësia për ta falënderuar Allahun Teala për mirësitë që u ka dhënë, vlen të theksojmë edhe çështjen e mënyrave të respektimit të edukatës së falënderimit të atyre që e kryejnë këtë obligim. Njerëzit e devotshëm thonë:

“Njeriu duhet ta falënderojë Allahun e Lartësuar dy herë për çdo frymëmarrje. Një herë kur të marrë frymë dhe një herë tjetër kur ta japë atë.”

Gjërat që sot hidhen në koshat e mbeturinave kanë përmasa aq të mëdha saqë nëse do të përdoreshin për bamirësi mund ta parandalonin problemin e mungesës së ushqimit në vendet e varfra. Pra, koshat e mbeturinave janë të mbushur plot e përplot me mirësi të shpërdoruara. Tashmë kanë filluar të pakësohen ndjeshëm njerëzit që nuk e shkelin bukën që e shohin në tokë, por që e marrin me respekt dhe e vendosin në një vend. Kështu që po shtohen njerëzit që nuk e njohin mungesën e ushqimit dhe që e konsiderojnë si modë lënien e disa kafshatave ushqim në pjatë dhe lënien e një gisht lëngu në gotën e tyre.

Në hadithin fisnik thuhet:

*“Ditën e Kiametit, njeriu nuk do të largohet dot nga audienca e Zotit pa dhënë llogari se “si i ka përdorur mirësitë që i ishin dhënë amanet...” (Tirmidhi, Sifatu'l-Kijame, 1.)*

Ndërkohë që mund të lartësohemi në gradën e një robi të devotshëm me virtytin e falënderimit të Zotit (xh.sh.), për mirësitë që na ka dhënë, rruqa që duhet të ndjekim për të mos u bërë fatkeq në të dy botët me humbjen e mosmirënjohjes ndaj mirësive, është marrja për shembull e jetës së bekuar të Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili përshkruhet si një “Kuran i gjallë” dhe “Shembulli më i shkëlqyer dhe Mëshirë për Botët”.





# FËMIJËT dhe BOTA e LIBRAVE

.....  
Nuredin Nazarko

Lidhja me librat në ditët e sotme është një nga të paktat gjëra të mira, që mund të ketë njeriu në jetën e tij. Duam apo nuk duam ne, me apo pa dëshirën tonë, shumë syresh janë larguar paqshëm nga të kredhurit mes rreshtave të librave. Është një ngjarje e cila, edhe pse duhej shmangur, vazhdon të rëndohet gjithmonë e më tepër. E megjithatë, për fat të mirë kemi ende njerëz që lidhjen me librin nuk e braktisin as në këto kohë, kur të lexuarit mund të konsiderohet deri edhe marrëzi.

Kjo pjesë meriton të vlerësohet për kurajon që tregon përkundrejt, magjisë së teknologjisë, duke mos lejuar vjedhjen e kohës nga kjo e fundit.

Në mos herët vonë, secili do të mbërrijë në një moment të jetës, ku i duhet të ketë mbi supe jo thjesht përgjegjësinë mbi vetveten, por edhe përgjegjësi të tjera që lidhen me formimin e familjes. Këto përgjegjësi janë të pashmangshme dhe si të tilla duhen përmbushur e realizuar me seriozitet.

Ardhja në jetë e pasardhësve nuk është thjesht pjesë e kënaqësive që njeriu merr nga jeta. Ardhja e pasardhësve është një sfidë e madhe dhe një përgjegjësi, e cila nuk mund të reduktohet vetëm me plotësimin e nevojave bazë jetësore nga pikëpamja biologjike. Edukimi i tyre është dhe mbetet përgjegjësia kryesore e një familje.

Nëse do të ndaleshim në ditët që jetojmë për të soditur sesi edukohet sot një fëmijë, natyrisht që nuk do të kishim një panoramë shpresdhënëse, nuk do të kishim një panoramë të asaj që do të donim të ishte realisht në realizimin e kësaj përgjegjësie të madhe. Por, pavarësisht se kjo përgjegjësi realizohet jo me seriozitetin e duhur, koha rrjedh dhe në qoftë se pasardhësit nuk do të jenë edukuar që nga vogëlia me frymën e së vërtetës, rreziku i deformimit të tyre nga vorbullat e zhvillimeve shoqërore do të jetë mëse i pranishëm.

Por a mund të jemi gjithmonë të sigurt se, nëse u ofrojmë një model që frymon sipas parimeve të së vërtetës, do të jenë të sigurt nga mosprekja nga vorbullat e zhvillimeve shoqërore?

Në këtë jetë nuk mund të jesh asnjëherë i sigurt në mënyrë përfundimtare mbi përfundimin e çështjeve, dhe rrjedhimisht nuk mund të jesh i sigurt, edhe për faktin që përtej edukimit që mund t'u japësh pasardhësve, ata do të jenë të sigurt nga mosprekja e vorbullave shoqërore. Detyra jonë themelore është që nën frymën e së vërtetës, t'u dëftojmë horizontin ku duhet të mbërrijnë si dhe shenjat që i dërgojnë tek ky horizont, sepse ne nuk mund të jemi mbizotërues të fatit tonë.

Dhe për ta realizuar këtë përgjegjësi, ata që janë prindër si dhe ata që do të jenë prindër, duhet të bëjnë të mundur, sipas mundësive dhe rrethanave ku ndodhen, që pasardhësit e tyre të kenë një kontakt të hershëm me librin, pavarësisht se janë në moshë të

vogël e nuk mund të lexojnë. Kjo nuk do të thotë që të mjaftohemi me faktin që fëmija thjesht të prekë apo të mbajë në dorë ndonjë libër. Kjo do të thotë që vetë prindi duhet të gjejë kohë për t'i lexuar fëmijës libra, sepse fëmijët janë dëgjues shumë të mirë, si dhe kuptues të mirë, pavarësisht se të rriturit e shohin me dyshim, për të mos thënë të pamundur, aftësinë dëgjuese dhe kuptuese të fëmijëve.

Nëse do të ankohehim se nuk kemi kohë t'u lexojmë fëmijëve para gjumit disa faqe libër, atëherë si e gjejmë kohën për të parë një film, ndeshje sporti, telenovelë, madje së bashku me fëmijët? Koha nuk mungon, as librat e mirë nuk mungojnë. Ajo çfarë na mungon është moskuptimi i duhur i përgjegjësisë së të paturit pasardhës.

Nuk mund të tolerojmë që të sillemi më fëmijët si shumë syresh që thonë se le të bëhet siç bëhen të gjithë. Ne nuk duhet t'i nënshtrohemi kësaj mendësie, pasi dihet fare mirë se në anën e kujt gjërave ka qënë historikisht shoqëria njerëzore. A mund të pranojmë të shkrihemi e të përnjështohemi me masën, me turmën?

Për të mos u përfshirë nga ky rrezik, nevojitet punë e vazhdueshme me fëmijën qysh kur është ende i vogël, pikërisht duke i lexuar çdo natë disa faqe libër. Argëtimi, shoqëria nuk mund të jenë më të rëndësishëm se fëmija yt.

Natyrisht që jo çdo libër do të ishte i përshtatshëm për t'ia lexuar. Librat që janë bazikë, tërheqës për veshin dhe botën e fëmijës, libra që përcjellin mësimet morale, libra që rrëfejnë për heronj që marrin vendime të rëndësishme në çaste të caktuara të jetës, do të ishin disa nga dritaret prej nga ku ne duam që drita e diellit të hyjë në zemrën e fëmijës. Natyrisht që këtu nuk duhet harruar as libri i librave, madje ai është më i rëndësishmi mbi të njohurit e frymës së mënyrës të të jetuarit. Të mos ankohet asnjë prind për mungesë kohe, për t'u angazhaur me fëmijën e tij në këtë sferë, pasi që ky është një investim, frytet e të cilit do të vilen shumë kohë më pas dhe askujt nuk do t'i vinte mirë që të vilte fryte të hidhura.

Po kështu prindi duhet të kujdeset që të rrenjosë tek fëmija dashurinë për librin edhe nëpërmjet krijimit të një biblioteke, qoftë edhe të vogël, në mjediset shtëpiake, edhe nëpërmjet mirëmbajtjes së librave që mund të ketë një familje.

Leximi i vazhdueshëm për fëmijën, krijimi i bibliotekës dhe farkëtimi i lidhjes së përhershme me librin, çdo ditë nga pak, janë detyra dhe përgjegjësi themelore për çdokënd që është apo do të jetë prind. Ky do të jetë një nga shërbimet e mëdha që do të kryejmë për pasardhësit, duke mos harruar që vazhdimisht të kërkojmë t'u dhurohet ajo çfarë është më e mirë dhe më e lartë, si dhe ajo çfarë është më e mirë për mënyrën e tyre të të jetuarit.



# Feja dhe shkenca në shekullin XXI, një qasje e të kuptuarit

*"Feja dhe shkenca në parim nuk kundërshtohen, madje shkenca në fakt çon drejt besimit. Shumë dijetarë me famë botërore theksojnë se feja dhe shkenca në parim pajtohen, por gjysmëfeja dhe gjysmëshkenca mund të sjellin kokëçarje"*

*Nexhat Ibrahimi*

Mesazhi bazë të cilin e përmban feja është paqja dhe stabiliteti në tokë, ku pikë qendrore ka njeriun dhe fatin e tij, në rrugën drejt realizimit të qëllimeve të tij. Njeriu i ardhur prej botës së urdhrit apo botëve të larta erdhi në tokë për ta mishëruar paqen hyjnore. Ademi (a.s.), njeri dhe pejgamber i parë është prototip dhe mishërim i këtij urdhri. Jo vetëm Ademi (a.s.), por të gjithë pejgamberët kanë pasur qëllimin e kthyerjes nga forma drejt origjinës, duke i shfrytëzuar aftësitë intelektuale dhe shpirtërore që ia ka dhuruar Zoti. Sipas kësaj, në esencën e të gjitha feve hyjnore por edhe të atyre të cilat mendohet se kanë pasur pejgamber gjendet ky qëllim.

Njeriu përveç këtij dimensionit ka edhe dimensionin e lirisë së zgjedhjes. Ai posedon dije dhe aftësi për t'i dhënë jetë tokës dhe për ta zhvilluar atë. Ademi (a.s.), iu mësuan *emrat e çdo gjëje* (Bekare, 31) apo dijet esenciale të gjërave të cilat në fjalorin tonë i njohim si "shkencë" dhe lirisht mundë të thuhet se nga Ademi (a.s.), është hapi i parë drejt zhvillimit të veprimtarisë shkencore apo bazat e themelimit të *shkencës*. Kemi të bëjmë me një njeri fetar dhe shkencor në të njëjtën kohë. Ademia (a.s.), mund të konsiderohet Pejgamberi i parë, por edhe shkencëtari i pari i cili i ka elaboruar dijet zanafillore të gjërave.

Pejgamberia e Ademit (a.s.), e dhuruar nga Zoti është simbol i përgjegjësisë hyjnore që bart gjinia

njerëzore, kurse dija e dhuruar përsëri nga Zoti i shërben fetarisë, madje shkon paralel me të. Në këtë binom fe-shkencë, ilustruar në shembullin kuranor në lidhje me Ademin (a.s.), kemi kurorëzimin me "xhenet", pra lumturinë hyjnore. Vlen të themi se lidhja e fesë dhe shkencës njeriut i siguron lumturi në këtë botë, por edhe në tjetrën:

***Ne i thamë: "O Adem, ti dhe bashkëshortja juaj banoni në Xhenet dhe hani lirisht nga frutat e tij nga të doni..."*** (Bekare, 36)

Njeriu derisa të ndjekë binarët e tij fetarë dhe shkencorë mund të kalojë edhe sferat e melaikeve për të cilët dija është e kufizuar. Njeriu i posedon esencat e krijimit dhe mund të arrijë piedestalet më të larta hyjnore. Prandaj shkenca moderne është mahnitëse, sepse ka arritur zhvillime marramendëse si në fushën e komunikimit edhe në fushat tjera, cilësi të cilat për botën e melaikeve kanë qenë të njohura, por jo edhe për njeriun. Njeriu i shekullit XXI, i ka arritur edhe këto gradë. Për superioritetin e njeriut kundrejt melaikeve na njofton Kurani ku thotë:

***(Zoti) Tha: "O Adem, njoftoji ata (engjëjt) me emrat e atyre (sendeve)!" E kur u rrëfeu atyre për emrat e tyre, (Zoti) tha: "A nuk u kam thënë juve se Unë, më së miri e di fshehtësinë e qiejve e të tokës dhe më së miri e di atë, që ju e publikoni dhe atë që e mbani fshehtë?!"*** (Bekare, 31-33)

Por në momentin kur gjërat ndryshojnë vëndet e tyre si entitete të caktuara nga Zoti, atëherë kur shkenca fillon të marrë timonin pa marrë parasysh fetarinë dhe elementin hyjnor, kemi devijimin e njeriut nga vendi i tij. Këtë e gjejmë në Kuran kur Ademi dhe Havaja (a.s.), nën cytjen e shejtanit, si pikë orientuese morën prirjet e veta logjike kundrejt anës ndërgjegjëso-re fetare. Në këtë moment Allahu (xh. sh.), urdhëron të zbresin nga bota e lartë drejt asaj të ultës. Shembulli i paraprirjes së shkencës ndaj fesë njeriun e hedh në greminë të thella morale dhe shpirtërore, sikurse thekson ajeti:

**Ne u thamë: “Zbritni (dilni), jeni armik i njeri-tjetrit, e ju deri në një kohë në tokë keni vendbanim dhe dëfrim.”** (Bekare, 36)

Ngrënja e pemës së ndaluar në mesin e mufesirëve, por edhe të filozofëve është biseduar shumë. E rëndësishme është se ajo simbolizon dëshirën e tyre për përjetësi, sikurse e gjejmë cytjen e shejtanit në këtë drejtim:

**“Po djalli i bëri që ata të dy të mashtrohen në atë (pemë ose Xhenetin) dhe i nxori ata nga ajo (e mirë) që ishin në të.”** (Bekare, 36)

Tema më e madhe dhe më komplekse e ekspozuar në ngjarjen e babait të njerëzimit është pikërisht kërkimi i përjetësisë dhe largimi nga ankthi i vdekjes përmes të arriturave shkencore dhe intelektuale, duke iu qasur burimeve të dijes dhe jo shpalljes. Që nga lindja njeriun e kaplon ndjenja e vdekjes dhe tërë jetën e kalon nën presionin e saj. Varësisht nga segmenti i të shikuarit të saj njeriu arrin ta menaxhojë atë ose e kundërta. Nëse përdoret si masë morale, ajo merr një kahje pozitive dhe bëhet faktor shumë i fuqishëm në jetën e njeriut. Njeriun modern e ka sunduar ndjenja e frikës nga vdekja dhe si pasojë e saj kemi një shthurje morale të cilën mundohet ta shërojë shkenca. Qëllimi kryesor i shkencës moderne është largimi nga të menduarit (ankthi) e vdekjes dhe kërkimi i pavdekshmërisë dhe formimi i një bote të improvizuar si ajo “hyjnore” në të cilën do të sundojë “Njeriu” dhe jo “Zoti”. Pikërisht për të bërë një dallim mes kësaj dhe botës tjetër Pejgamberi (a.s.), thotë: *Kjo botë është xhenet për jobesimtarin dhe ferr për besimtarin*, pra kjo lumturi është relative në krahasim me atë të botës tjetër.

Por pyetja e cila parashtrohet është: A arriti shkenca ta zgjidhë ankthin e vdekjes?

Shkenca moderne në pamundësi për t'i dalë ballë këtij përbindëshi të pakompromis sikurse vdekja, mori drejtimin e kamuflimit dhe të mbulimit të saj, thënë ndryshe shpiku mjete dhe aktivitete të ndryshme shoqërore në të cilat njeriu e harron vdekjen. Në një mënyrë gjeti rehati shumë të izoluar shpirtërore. Në orvatje për të mbajtur të qetë temperamentin e njeriut Epikuri thotë: “Çfarë është vdekja? - Në fakt,

kur ne jemi (në ekzistencë) ajo nuk është dhe kur ajo vjen ne nuk jemi. Prandaj le të ruajmë qetësinë, nuk ka nevojë për frikë.”

Si e zgjidh feja problemin e vdekjes? - Feja i mëson njeriut se kjo botë dhe bota tjetër janë si anët e kundërta të medaljes. Çdo veprim fizik ka edhe natyrën metafizike në të cilën merren llogaritë. Sipas saj, për njeriun religjioz bota e ahiretit është e njohur ashtu sikurse thotë Mulla Sadra: *“Berzahu (jeta e varrit), është shumë më real se kjo botë, sepse gjendet në një pikë më të lartë të qenies”*. Pra konsiderohet madje më reale se sa kjo botë, sepse simbolizon afërsinë kuptimore me Qenien. Njeriut fetar vdekja nuk i shkakton ankth, përkundrazi shndërrohet në motivim për punë dhe angazhim. Çdo veprim shkencor dhe fizik është njëkohësisht edhe veprim moral dhe fetar. Në këtë frymë shkenca dhe feja në shek. XXI mund të gjejnë gjuhën e përbashkët.

Në fund të shekullit XX dhe fillim të shek. XXI, kemi shenja të “Rikthimit të Zotit” në qendër. Meqenëse problemet e botës së brendshme të njeriut nuk arriti t'i zgjidhë shkenca empirike, kemi disa tentativa të një kthimi drejt fesë. Përmes kthimit të fesë konkretisht Zotit në qendër, duke mos anashkaluar edhe shkencën, artin dhe filozofinë arrihet mishërimi simbolik i botës hyjnore brenda asaj tokësore, kjo edhe është qëllimi final i pejgamberëve dhe fesë që sjellin ata. Në këtë relacion, duke balancuar fenë dhe shkencën Pejgamberi (a.s.), thotë: *“Punoni për këtë botë sikur nuk do të vdisni kurrë dhe punoni për ahiretin sikur do të vdisni nesër”*.

Studiuesi Italian Graziano thekson se pas shekullarizmit shekujt në vazhdim (shekulli XXI dhe pas) do të jenë sfidë mes materializmit dhe fesë. Gjithashtu ai thotë se po vjen koha që feja të jetë në arenën politike. Në emrin e “revanshit të Zotit” ai numëron disa shkaktarë të cilët tregojnë zëra drejt këndelljes së fesë, si revolucionet e ndryshme brenda shteteve islame dhe shpallja e tyre si “shariat”, si rasti i Iranit, Pakistanit, Malajzisë etj. Gjithashtu ai përmend edhe revolucionarët e ndryshëm myslimanë, katolikë por edhe budistë dhe të feve të tjera, si dhe konferencat ndër-fetare të quajtura “Aleancë e Shenjtë”, të cilat luftojnë kundër “Luftës së shenjtë”, pra luftës nacionale dhe ndërkulturore<sup>1</sup>.

Mbetet të shihemi në shekujt në vazhdim se a do të kemi veshje simbolike të shkencës me petkun e fetarisë, kombinim ky i cili do të sillte zgjidhjen e shumë problemeve etike, sociale dhe kulturore. Madje do të sillte edhe përmirësimin e historisë shekullore, e cila në themel ka gabuar duke vënë në vend të fesë diçka tjetër.

1. Të shihet libri “Lufta e shenjtë dhe e shenjta Aleancë” (Fetë dhe trazira ndërkombëtare në shekullin XXI), fq 53-67, SH.B. “Saras”, Tiranë 2015.





# Fitimi hallall dhe haram

Irfan Ēztyrk

Një pjesë e atyre që janë haram, janë haram bizatihi, domethënë, shkaku që janë bërë haram, janë vetë ato. Për shembull: Kamata, bixhozi, alkooli, droga, shitja e heroinës, përdorimi dhe futja e këtyre me shiringë në trup, gjaku, qelbi, ngordhësira, mish i kafshëve të egra dhe gjëra të tjera të ngjashme me këto.

Ka edhe disa haramë të tjera që në vetvete janë të pastra, por që bëhen haram nisur nga mënyra e fitimit të tyre. Për shembull: Të hash bukë është hallall, por nëse buka fitohet duke e vjedhur, bëhet haram.

I tillë është edhe fitimi që arrihet duke e përzier të keqen në tregti me mënyrat si mashtrimi, dredhia, falsifikimi, hilja etj. Madje, në një fitim të tillë, siç gjendet pjesa e haramit, gjendet edhe mëkati që lind nga shkelja i të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, fitimi që arrihet nga shitblerja në kohën e namazit të Xhumasë duke e lënë namazin, është haram (edhe për marrësin, edhe për shitësin). Përveç të tjerash, lojërat e fatit, lotaria kombëtare, llotot e llojeve të tjera, garat e kuajve, fitimi që arrihet me vjedhje, me gjetje dhe me bast, fitimi që arrihet me anë të dredhisë dhe mashtrimit, fitimi që arrihet nëpërmjet gënjeshtërisë, fitimi që arrihet duke vjedhur pasurinë shtetërore, fitimi që arrihet me anë të rryshfetit, fitimi që arrihet me anë të uzurpimit dhe fitimi që arrihet me anë të rrëmbimit janë pasuri haram.

Bizantët u mposhtën nga Sasanitët. Politeistët mekas u gëzuan ngaqë ehli kitabi u mposhtën nga adhuruesit e zjarrit.

Ndërsa në katër ajetet e para të sures Rum, Allahu i Lartësuar njoftoi se pas pak kohësh Bizantët do të fitojnë. Nisur nga kjo, Ebu Bekri, (r.a.), u tha politeistëve të gëzuar:

“Allahu nuk do t’ju gëzojë. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka sjellë lajm për këtë. Beto hem se romakët

do t’i mposhtin persët brenda disa viteve.

Sikundër kësaj, mushriku Ubej ibn Halefi i tha Ebu Bekrit, (r.a.):

“Po gënjen. Eja, cakto një kohë dhe të vëmë bast.” Të dy palët vendosën bast me dhjetë deve dhe cakatuan një kohë prej tri vjetësh.

Ebu Bekri, (r.a.), i tregoi për këtë gjë të Dërguarit të Allahut (a.s.). I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Fjala Bid’ e cila (përmendet në ajet), është nga tre deri në nëntë. Shtojë masën dhe zgjate kohën!”

Pas takimit me të Dërguarin e Allahut (a.s.), kur Ebu Bekri, (r.a.), u takua me Ubejin, Ubeji i tha:

“Më duket se qenke bërë pishman.”

Ebu Bekri, (r.a.), i tha:

“Jo. Andaj eja ta shtojmë bastin dhe ta zgjasim kohën. Tashmë zgjate kohën nëntë vjet dhe bëje bastin njëqind deve!”

Ai ia ktheu:

“Në rregull, pranoj.”

Sipas transmetimit të Tirmidhiut, Ditën e Bedrit, bizantët i mposhtën persët.

Ebu Bekri, (r.a.), e mori bastin nga trashëgimtarët e Ubejit dhe ia çoi Pejgamberit.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Fale këtë!” (Hak Dini, Kur’an Dili, 6/237.)

Ndërsa shtojcën: “Kjo që ke marrë është haram, andaj fale!”, Bejhakiu e transmeton nga Ibn Abbasi në Delailu’n-Nubuvve. (Ihja, 2/326) (Abdullah Sevinç, Lutjet tona nuk po pranohen, përse? 76-81.)

O vëlla! Siç e shikon, zbatimi i Islamit me devotshmëri arrihet duke i lënë haramet dhe gjërat e dyshimta dhe duke ndjekur rrugën e vendosmërisë. Nëse edhe ti do të përpiqesh në këtë rrugë, Allahu do të të fusë edhe ty në grupin e të devotshmëve dhe do të të çojë në Xhenet.

# Subhanellahi ve bihamdihî

Muhamed El-Gazali

Me vete po thosha: “Sikur unë të jem njëqind milje larg planetit të tokës, çfarë do të shikoja dhe çfarë do të dëgjoja?”

A do të shihja retë e tymit dhe të pluhurit, të cilat kanë ndotur atmosferën dhe kanë turbulluar tejdukshmërinë e saj?

A do të dëgjoja stuhitë e zhurmshme, që lindin prej mjeteve të transportit dhe të fabrikave, zhurmat e të cilave kanë mbuluar çdo gjë?

E di se ky planet e ka një exhel (afat) të përcaktuar, por a po e përshpejton dhe po e kërkon shkatërrimin e tij me duart e veta?

Pastaj, çfarë jemi ne në këtë univers të madh?

Kam lexuar se shkencëtarët e hapësirës kanë zbuluar, një vrimë të zezë në një galaktikë të largët, njëqind herë më të madhe se çdo vrimë e zezë që është zbuluar më parë! Radio «Zëri i Amerikës» tregon se shkencëtarët besojnë se kjo vrimë gjigante përfshin një miliard yje! Dhe se tubimi i yjeve dhe i materieve të tjera në të formon një qendër të dendur graviteti, që arrin atë fuqi, sa nuk shpëton asgjë prej saj, madje as edhe drita!

Thashë: Nëse kjo vrimë është në një pjesë të universit, atëherë çfarë është universi vetë? Duket se ajo që është mes qiejve e tokës është edhe më e mahnitshme se këto të dyja!

Përpara meje u hap një horizont i gjerë i mbushur me argumente për madhësinë e Allahut dhe çështjen e Tij të lartë: «**Allahu është Ai, i Cili ngriti qiejt pa shtylla që mund t'i shihni, pastaj u lartësua mbi Arsh. Nënshtrou diellin dhe hënë, secili udhëton për një exhel (afat) të përcaktuar. E drejton çështjen dhe i shkoqit argumentet, që ndoshta ju, për takimin me Zotin tuaj, të bindeni**». (Rrad, 2)

Ndoshta, rreth vetes mund të shoh turma të pafund njerëzish, e ndoshta shoh kufijtë e tokës, ndërkohë që unë jam brenda një sateliti artificial, por puna nuk është shikimi i njeriut në mesin e miliarda njerëzve.

Në të vërtetë ky njeri i vetëm është një univers i vogël! Në lëkurën e tij ka njëqind mijë pemë, dua të them njëqind mijë gime, rriten dhe qëmtohen për t'u kthyer në vendin e tyre të tjera si këto! Ndoshta qimja është më e thjeshta tek njeriu, kështu që le të shikojmë mijëra e mijëra rruaza të gjakut, që notojnë në damarët e tij. Ato janë rruaza rinovuese, kanë fabrikat e tyre që i ndërtojnë dhe i dërgojnë sipas nevojës. E, le të shikojmë rrjetën e nervave të përhapur në trup. Ato marrin urdhrat, natë-ditë prej trurit, për të cilin njeriu është i paaftë të njohë labirintet e tij të ndërlikuara dhe punët e tij të rëndësishme. Që nga agimi njerëzor, deri më tani dhe deri sa Allahu ta trashëgojë tokën e çfarë gjendet në të, Zoti ynë e drejton punën e këtyre trupave dhe çfarë ekspozohen prej vështirësive dhe kënaqësive: «**Dhe, tek Zoti yt është përfundimi. Dhe Ai, Vetë Ai bën për të qeshur e për të qarë. Dhe Ai, Vetë Ai vdes dhe ngjall!**» (Nexhm, 42-44)

Universi është i madh, siç e ka zbuluar shkenca, por Allahu është më i madh, siç duhet ta ndiejnë shkencëtarët.

Në shoqërinë tonë, ne njerëzit i shikojmë politikanët e mëdhenj, për shembull të zënë me çështje të mëdha, të pavëmendshëm ndaj vogëlsirave, por Zotin e botëve, asnjë punë nuk e zë ndaj një pune tjetër. Ai dëgjon frymëmarrjen e macës së ndëshkuar dhe e fut atë që e ka ndëshkuar në zjarr, ashtu siç dëgjon lutjet e njerëzve të vuajtur dhe i dënon zullumqarët për shkak të asaj që kanë punuar. Ai dëgjon rënien e gjetheve nga pemët dhe shikon mpiksjet e gjakut në damarë, ashtu siç shikon dhe dëgjon shkrepimën e vetëtimës në qiell dhe perëndimin e yllit në hapësirë! «Subhanellahi ve bihamdihî, sa numri i krijesave të Tij, sa të kënaqet Vetë Ai, sa pesha e Arshit të Tij dhe sa boja e fjalëve të Tij».

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja



# FRIKA NDAJ ALLAHUT

Selma Çevikollu

“Frika ndaj Allahut është koka e të gjitha urtësive.”

Allahu i Lartësuar, mëshira dhe drejtësia e të Cilit ka përfshirë të dy botët, i Cili e ka ndaluar njeriun që ta adhurojë e që t'i bëhet rob njeriut dhe i Cili i ka ndriçuar besimtarët me dritën e besimit dhe ibadetit, në Kuranin Famëlartë, të cilin na e ka dërguar si një mirësi hyjnore thotë:

**“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”** (Al Imran, 102) Gjithashtu na urdhëron:

**“O njerëz, frikësojuni Zotit tuaj, sepse dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe!”** (Haxh, 1) Nga këto ajete fisnike kuptohet se Allahu i Madhëruar kërkon nga ne që të kemi frikë prej Tij.

Një gjë duhet ta dimë se jeta e besimit fillon me frikën ndaj Allahut, xhelle xhelaluhu. Rruga e fesë është rruga e atyre që kanë frikë nga Allahu, azze ve xhelle. Të fshehtat e jetës së ahiretit arrihen vetëm me frikën ndaj Allahut, xhelle xhelaluhu. Përderisa zemrat të mos mbushen me frikë ndaj Allahut Teala, jeta ngelet një vend në të cilin përjetohen halle dhe vështirësi të mëdha. Frika ndaj Allahut, xhelle xhelaluhu, e bën njeriun ta marrë në llogari veten, të llogarisë sjelljet e tij dhe t'i bëjë mirë llogaritjet në lidhje me të dyja jetët. Sa ndjenjë sublime që është frika nga Allahu Teala dhe të kuptuarit se në çdo moment jemi nën kontrollin (vëzhgimin) e Atij në çdo aspekt të jetës sonë! Në një zemër e cila është e privuar nga kjo ndjenjë e lartë, padrejtësia zë vendin e mëshirës, urrejtja zë vendin e butësisë, mashtrimi zë vendin e ndershmërisë dhe

armiqësia zë vendin e dashurisë. Për shkak të kësaj ndodhin të gjitha ngjarjet negative, imorale dhe të tmerrshme, siç ndodhin edhe sot. Vetëdija e frikës ndaj Allahut Teala, i siguron njeriut disiplinën e tij të brendshme. Për të jetuar si një njeri i vërtetë në ditët e sotme, për të mos rënë në gabime dhe për të qëndruar gjithmonë te e vërteta, çdo njeri ka nevojë për këtë disiplinë të brendshme. Nisur nga fakti se çdo njeriu nuk mund t'i vendosim te koka një polic, në mënyrë që njerëzit të mos bien në gjëra të palejuara dhe që t'i bëjnë punët siç duhet, atëherë e kemi kusht që njerëzve t'ua japim patjetër “ndjenjën e frikës ndaj Allahut Teala”, e cila pothuajse kryen funksionin e policit vëzhgues të brendshëm.

Të jetuarit brenda kornizës së dispozitave që ka vendosur Allahu i Madhëruar në këtë botë, e shndërron jetën e besimtarit në parajsë që në këtë dynja. Faktori më influencues në një jetë të tillë është të jetuarit më vetëdijen e “frikës ndaj Allahut”. Njeriu që përgatitet për botën e përhershme është njeriu më fitimtar. Frika ndaj Allahut Teala është fitimi më i madh për atë që e kupton. Në jetën e ahiretit, e cila është një e vërtetë që nuk mund t'i mohohet ekzistenca, përsëri është ndjenja e “frikës ndaj Allahut” ajo që do t'i shpëtojë trupat nga djegia, ajo që do t'i bëjë lëkurat të padjegshme nga zjarri i xhehenemit, ajo që do t'i shpëtojë besimtarët dhe që do t'i bëjë miq të Allahut Teala në kopshtet e xhenetit. Allahu i Lartësuar e tregon në Kuranin Fisnik këtë të vërtetë, për të cilën folëm më lart, duke thënë:

**“Për atë që i frikësohet paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte!”** (Rahman, 46)

Të gjithë besimtarët e pjekur dhe të devotshëm duke filluar me në krye pejgamberët, përgjatë gjithë jetës së tyre janë dridhur nga frika ndaj Allahut Teala. Sahabi i nderuar, Abdullah bin Shihhiri (r.a.), thotë:

“Një ditë shkova te i Dërguari i Allahut (a.s.). Ai po falte namaz duke qarë aq shumë sa nga kraharori i tij vinte një zë si i kazanit që valon.” (Përkthimi i Rijazu's-Salihin, vëll. 1, fq. 486.)

Enesi, radijallahu anh, transmeton se i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka thënë:

“O umeti i Muhamedit! Sikur t'i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë.” (Buhari, Muslim, Bejhaki, Muhtasar Shuabu'l-Iman, fq. 21.) Nisur nga kjo, sahabët e mbuluan fytyrën me duart e tyre dhe filluan të qanin me dënësë.

Një ditë, kur Umeri, radijallahu anh, po kalonte

me devenë e tij pranë një çadre, u rrëzua nga deveja prej emocionit dhe frikës kur dëgjoi nga brenda dikë që po lexonte ajetet e ndëshkimit. Përsëri një ditë, kur i thanë:

“A nuk ke frikë nga Allahu, o Umer?”, menjëherë zbriti nga kafsha e tij, bëri sexhde duke e vënë fytyrën në tokë, ngjyra e fytyrës i ndryshoi, u zverdh dhe tha duke iu marrë zëri:

“Kush është Umeri që të mos ketë frikë nga Allahu?..”

Ja, kështu kanë qenë ata.

“Frika ndaj Allahut” ishte aq thellësisht prezente te i Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-selam dhe te shokët e tij, saqë kishte prej atyre që nuk dilnin me ditë të tëra nga shtëpia e tyre dhe që qanin derisa u plasnin mushkëritë prej frikës nëse u shikonte syri ndonjë haram. Kjo çështje zgjaste derisa i Dërguari i Allahut (a.s.), të pyeste për atë dhe t'i tregonin për gjendjen. Sapo Pejgamberi (a.s.), ta dëgjonte këtë, pa humbur aspak kohë shkonte dhe e vizitonte atë sahab që i digjej zemra. Ndërsa sahabi e përqaftonte të Dërguarin e Allahut, alejhi's-selam dhe jepte shpirt duke qarë nga frika prej Allahut Teala. Ja, kështu kishin frikë sahabët nga Allahu i Madhëruar.

Po, edhe nëse ne nuk bëhemi dot si ata, prapë se prapë do të kemi frikë dhe duhet të kemi frikë nga Allahu Teala.

Nëse nuk do të kemi frikë nga Ai, atëherë, nga kush do të kemi frikë?

Kush është më i madhi? Kush është më i lartësuar? Kush është më fisniku? Kush është poseduesi absolut i gjithësisë?

A nuk e jehon Atë, të Fuqishmin absolut, çdo përgjigje? Le ta dimë mirë se çdo derë të shpie tek Ai. Ai është vega më e fortë dhe litari i pakëputshëm. A nuk thotë Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik:

**“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë gremenës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.”** (Al Imran, 103) Një njeri që i frikësohet Allahut Teala, nuk ka frikë nga asgjë tjetër dhe nuk i bëhet rob rob. Ndërsa njeriu që nuk ka frikë siç duhet nga Allahu, ka frikë nga çdo gjë tjetër. Përveç të tjerash, ai që nuk ka frikë nga Allahu, i bën lehtë të gjitha



veprat e shëmtuara, ligësitë dhe mëkatet. Për këtë arsye thuhet:

“Ki frikë nga ai që nuk ka frikë nga Allahu!” Sepse njerëzit e tillë mund t’i bëjnë lehtë të gjitha llojet e ligësive, ngaqë nuk njohin asnjë lloj rregulli. Andaj, Allahu na mbroftë prej të keqes së atyre dhe na mbajttë larg prej njerëzve të atillë!

Vallë çfarë mund të themi nëse na bëjnë këtë pyetje: “Si mund të kemi frikë ashtu siç duhet nga Allahu Teala?” Atëherë, le të gjejmë një përgjigje për këtë pyetje:

Për të pasur frikë nga Krijuesi ynë i Lartë, ashtu siç dëshiron Ai, para së gjithash duhet të njohim nefsin, domethënë, veten tonë, sepse njeriu, i cili formohet nga mish dhe kockat, është nderuar me pozitën më të lartë prej të gjitha krijesave. Këtë pozitë më fisnike prej të gjitha krijesave e ka arritur në sajë të mendjes dhe logjikës. Kështu që, ai i cili ndodhet në këtë pozitë, sigurisht se nuk kaplohet nga dëshirat vetjake dhe nuk mashtrohet nga dredhitë e shejtanit aq sa u bindet urdhrave të edukuesit të tij, aq sa e njih Zotin e tij dhe aq sa e do Atë. Së fundi, njeriu mund të lartësohet në pozitën më të lartë duke pasur frikë dhe turp nga Krijuesi i Lartësuar. Sikundër kësaj, mund të bjerë edhe në esfelin safilin, domethënë, në më të poshtmit e të poshtmeve. Këtu nuk mund të lëmë pa përmendur një strofë nga poezia e Junusit të famshëm:

“Dije do të thotë të mësosh.

Dije do të thotë të njohësh veten.

Nëse ti nuk e njih veten tënde,

Çfarë dobie ka e gjithë ajo dije?

Domethënë, “ai që njih veten, njih Zotin.” Apo jo?

Një kusht tjetër për të pasur frikë nga Allahu Teala është se ne duhet ta njohim Atë, Krijuesin e Lartë. Ne duhet ta njohim Allahun, azze ve xhelle, në mënyrë që ta kemi frikë siç e meriton dhe ta duam Atë. Njeriu e do atë që e njih dhe nuk e do atë që nuk e njih. Andaj duhet ta njohim Zotin (xh.sh.), në më-

nyrë që ta duam. Kur ta duam Atë, gjithmonë do të digjemi me dëshirën për ta kënaqur Atë dhe për t’i zbatuar të gjitha urdhrat e Tij. Nisur nga parimi: “Ai që do nuk e mërzi atë që e do, nuk e lëndon dhe bën çdo gjë që i thotë.”, edhe ne si robër do të bëjmë me këtë vetëdije çdo gjë që na thotë Zotëruesi i Vetëm i Gjithësisë, Zoti ynë (xh.sh.) dhe do të kemi frikë, do të hezitojmë dhe nuk do të tentojmë t’i bëjmë ato që na urdhëron të mos i bëjmë. Sigurisht se kjo frikë mund të jetë për veten tonë, por mund të jetë edhe për dikë tjetër. Kështu që le ta duam Atë, në mënyrë që ta kemi edhe frikë. Atë le ta duam më shumë se çdo gjë tjetër. Ai, Allahu Teala është krijuesi ynë. Atij i kemi borxh shumë gjëra. Dashuritë më të sinqerta i dedikohen Atij. A nuk është ajo dashuri që e bën çdo krijesë në kohën e seherit (agimit) që të jehojë me zërin: “Allah!.. Allah!..”

Në sajë të atij zëri këndojnë bilbilat dhe bletët bëjnë mjaltë në zgjoin e tyre. Përsëri ai zë i bën dallgët e detit të thonë me gjuhën e tyre: “Ja Xhelil!.. Ja Xhelil. Fryrja e erërave dhe reshjet e dëborës janë thirrjet e të njëjtit zë në këtë botë... Çdo gjë është e dhënë pas dashurisë për Atë. Pastaj, kjo ndjenjë e thellë sjell frikësimin nga madhështia, sublimja dhe lartësia e ekzistuesit absolut. Frika që besimtari ka nga Allahu Teala është ajo ndjenja që e djeg dhe e përvëlton zemrën, në mënyrë që të mos bëjë diçka që nuk e do Ai.

Krahas të gjithave, frika ndaj Allahut të Lartësuar vjen nga dija, gjendja dhe veprat. Dijen këtu mund ta vlerësojmë si: “Të dish shkakun që të zvarrit për te gjëja që nuk e do.” Të diturit e shkaqeve të rrezikut që mund të ndodhë në të ardhmen, bëhet shkak që zemra të digjet dhe të brengoset. Ja pra, frika nga Allahu është një zjarr i tillë i brendshëm. Njerëzit nganjëherë kanë frikë nga Allahut i Lartësuar dhe nganjëherë kanë frikë nga mëkatet e tyre. Frika e të gjithëve mund të ndryshojë sipas asaj që kanë frikë. Për shembull, kur ndonjë besimtar ka frikë se mos prish pendimin që ka bërë, në mos nuk i zbaton siç duhet detyrat që ka ndaj Allahut të Madhëruar dhe në mos i nxihet e ngurtësohet

*“Shenja  
e frikës ndaj Allahut  
shihet qartë në shtatë  
gjëra. Ato janë: Gjuha,  
zemra, sytë, stomaku,  
duart, këmbët dhe  
bindja.” Nëse myslimani  
i përdor siç duhet këto që  
thamë më lart,  
largohet nga mëkatet  
dhe nga gjërat  
e dyshimta.*

zemra, dikush tjetër mund të frikësohet se mos bie pre e epsheve që ka pas ndjekur më parë, mund të frikësohet se mos bie në ndonjë gjendje të keqe në të ardhmen dhe në mos vdesë me ndonjë përfundim të keq, mund të frikësohet prej përcaktimit që i është shkruar në pafillimësi, mund të frikësohet në mos nuk do të falet për mëkatet që i ka bërë në të kaluarën apo mund të frikësohet nga fryma e fundit. Ja pra, kjo frikë ia mundëson njeriut që të bëjë një jetë më të rregullt dhe të disiplinuar.

Besimtarët janë të detyruar ta zotërojnë këtë dijë, që të frikësohen në kuptim të vërtetë nga Allahu i Lartësuar. Nisur nga kjo, Ebu Lejsi thotë:

“Shenja e frikës ndaj Allahut shihet qartë në shtatë gjëra. Ato janë: Gjuha, zemra, sytë, stomaku, duart, këmbët dhe bindja.” Nëse myslimani i përdor siç duhet këto që thamë më lart, largohet nga mëkatet dhe nga gjërat e dyshimta. Kjo quhet “vera”. Nëse frika shtohet më shumë dhe formohet gjendja që e largon njeriun edhe nga gjërat më të dyshimta, kjo quhet “takva / devotshmëri”. Nëse devotshmërisë i shtohet edhe shërbimi ndaj fesë dhe ndaj të tjerëve, njeriu arrin në gradën e të “sinqertit”. Të mëdhenjtë kanë thënë: “Në një vend ku gjendet sinqeriteti, gjendet edhe devotshmëria. Në një vend ku gjendet devotshmëria, gjendet edhe veraja. Në një vend ku gjendet veraja, gjendet edhe nderi.” Sa fjalë e vërtetë!

Ndërkohë që e vërteta është e tillë, ata të cilët e kanë arritur lumturinë në këtë botë vetëm duke parë realitetet e jashtme të jetës, duket qartë se nesër në vendin e mahsherit / tubimit të madh në ahiret, do të jenë prej atyre që janë mashtruar, sepse, ato për të cilat jemi njoftuar në Kuranin Fisnik, do të ndodhin një nga një. Ahireti është i vërtetë. Kur nesër të bjerë suri i thirrjes: “Ngrihuni!”, të gjithë do të shkojnë në vendin e mahsherit me këmbë të zbatuara. Vendi i mahsherit është një fushë e sheshtë dhe pa fund... Aty nuk ka asnjë gungë pas së cilës mund të fshihet njeriu apo asnjë gropë në të cilin mund të dëshirojë për të hyrë. Për këtë arsye, nëse njeriu jeton në këtë botë duke e pasur frikë Allahun, duke shpresuar mirësitë e ahiretit dhe duke i zbatuar urdhrat e Allahut të Madhëruar, do të thotë se ka bërë një punë pro vetes së tij, sepse nesër, në atë ditë të madhe në të cilën do të pyetemi për llogarinë e çdo gjëje, engjëjt, toka dhe qielli do të dëshmojnë për mirësitë dhe gjynahet që ka bërë njeriu. Madje, edhe gjymtyrët tona do të dëshmojnë për veprat që kemi bërë. Për këtë arsye, nuk ka arratisje nga “fundi absolut”.

Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë:

**“Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime.”** (Dharijat, 15) Nëse nuk duam që fundi ynë të jetë humbje, në këtë botë duhet të jetojmë duke pasur frikë nga Allahu dhe t'i zbatojmë urdhrat e Tij, sepse, Ai thotë:

**“O ju që keni besuar! Frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!”** (Hashr, 18)

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, thotë: “Koka e urtësisë është frika ndaj Allahut.” (Bejhaki, Dejlemi, Keshfu'l-Hafa, vëll. 1, fq. 421, Hadithi nr: 1350.) Në këtë hadith bëhet fjalë për besimtarin që e ka frikë Allahun Teala dhe që merr mësim prej ngjarjeve. Përsa i përket frikës, këshillohemi që kjo frikë ndaj Allahut gjithmonë të jetë ndërmjet “Haufit” dhe “Rexhasë”, domethënë, “Frikës” dhe “Shpresës”. Feja jonë nuk është feja e pesimizmit dhe dëshpërimit.

A nuk janë gjithmonë shfaqjet e asaj fuqie hyjnore që mund t'i shndërrojë në grimca të vogla shtëpitë dhe pallatet më të forta, që mund të shpërthejë ujë të vluar nga toka dhe që mund të nxjerrë të vdekurin nga i gjalli e të gjallin nga i vdekuri? A nuk janë shenja të fuqisë hyjnore që na kujtojnë “frikën ndaj Allahut” vullkanet, furtunat, tërmetet, lumenjtë që dalin nga shtrati me tërbim, cunamet, rrufetë dhe bubullimat të cilat i shkatërrojnë dhe i fshijnë nga faqja e dheut malet madhështore dhe qytetet e lashta? Sa i saktë mund të jetë konsiderimi i këtyre si ngjarje natyrore të zakonshme? Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se në këtë botë nuk kemi ardhur pa ndonjë qëllim dhe se çdo moment jemi nën vëzhgimin hyjnor. Andaj, duhet t'i rregullojmë sjelljet dhe gjendjen tonë dhe t'i shikojmë ngjarjet nga dritarja e besimit duke marrë mësim prej tyre.

Të gjitha rrugët që zgjaten drejt botës së përherëshme të ahiretit pa frikën dhe shpresën ndaj Allahut Teala, janë qorrsokakë. Ato rrugë janë të rrezikshme dhe të mbushura plot me vështirësi. Ai që e njeh Allahun e Madhëruar, frikësohet prej Tij ashtu siç e meriton. Në sajë të kësaj, e percepton edhe ligësinë e nefsit / vetes së tij. Prandaj, gjithmonë strehohet te mbrojtja e Allahut duke thënë: “Nefsi mund të më çojë në humbje.” Frika ndaj Allahut është koka e të gjitha mirësive.

Zoti (xh.sh.), na bëftë ne, të gjithë besimtarët dhe të gjithë njerëzit prej robërve që mbartin “frikën ndaj Allahut” në zemrat e tyre! Amin!...



# MREKULLITË E Kuranit

## “BETOHEM NË QIELLIN PLOT RRUGË.” (DHARIJAT 7)

Në univers ndodhen rreth 200 miliardë galaktika dhe secila prej tyre përmban rreth 200 miliardë yje.

Pjesa më e madhe e këtyre yjeve kanë planete dhe pjesa më e madhe e këtyre planetëve kanë satelitë. Këta trupa gjigandë lëvizin në orbita të caktuara, sipas një lëvizjeje të përlogaritur në mënyrë precize. Për miliona vite me radhë, të gjithë këta trupa “notojnë” në orbitën e tyre në një harmoni dhe rregull të përkryer. Për më tepër, një numër i madh kometash lëvizin në orbitat e përcaktuara për to. Orbitat në univers nuk janë karakteristike vetëm e trupave qiellorë. Edhe vetë galaktikat udhëtojnë me një shpejtësi marramendëse në orbita të projektuara për to. Gjatë kësaj lëvizjeje, asnjë prej trupave qiellorë nuk i zë rrugën, apo përplasen me të tjerët. Sigurisht që në kohën e shpalljes së Kuranit njerëzimi nuk zotëronte teleskopë elektronikë apo teknologjinë e avancuar të vëzhgimit të trupave miliona kilometra në hapësirë, ashtu siç nuk dispononte njohuritë e sotme të fizikës apo astronomisë. Ndaj në atë kohë nuk ishte e mundur të zbulohesh në mënyrë shkencore se hapësira është “plot me rrugë dhe orbita”, siç është shpallur në ajetin kuranor...



## NE E KEMI ZBRITUR HEKURIN, NË TË CILIN KA FORCË TË MADHE DHE DOBI PËR NJERËZIT..., (HADID 25)

Fjala "zbritëm poshtë" e përdorur veçanërisht për hekurin në këtë ajet, mund të mendohet se ka një

kuptim metaforik që do të thotë se hekuri është dhuruar për të mirën e njerëzimit. Por nëse ne do të merrim në

konsideratë kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, e cila është "i zbritur fizikisht nga qielli", do të kuptojmë se në

këtë ajet gjendet një mrekulli shkencore mjaft domethënëse. Në sajë të kërkimeve astronomike është zbuluar se hekuri i gjendur në rruzullin tokësor ka ardhur prej yjeve gjigande të hapësirës. Metalet e rënda në univers janë krijuar në bërthamën e yjeve të mëdha. Gjithsesi, Sistemi ynë Diellor nuk zotëron një strukturë të përshtatshme që të prodhojë vetë hekur. Hekuri mund të prodhohet në yje shumë më të mëdhenj se Dielli, te të cilët temperatura arrin disa qindra miliona gradë. Kur sasia e hekurit në një yll tejkalon një nivel të caktuar, ylli nuk mund ta mbajë atë më gjatë dhe si rezultat ai shpërthen në një shpërthim të quajtur "nova" ose "supernova". Si rezultat i këtij shpërthimi, meteorët që përmbajnë hekur shpërndahen nëpër univers

dhe lëvizin nëpër hapësirë, derisa të tërhiqen prej forcës gravitacionale të ndonjë trupi qiellor. E gjithë kjo na bën të qartë se hekuri nuk është formuar në Tokë, por është mbartur nëpërmjet meteorëve pas shpërthimit të yjeve në hapësirë, pra, ai **"ka zbritur në tokë"** në të njëjtën mënyrë siç është shpallur në ajetin kuranor. Është e qartë se ky fakt nuk njihet shkencërisht në shekullin VII, në kohën e shpalljes së Kuranit.



*"O ju që besuat! Agjërimi u është bërë obligim siç ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."*

(Bekare, 83)

## Një Ajet

Agjërimi është një adhurim, obliguar për çdo mysliman, ashtu siç ka qenë detyrim edhe për të gjithë popujt e tjerë para islamit. Si çdo adhurim tjetër edhe agjërimi ka dobi të shumta individuale dhe shoqërore. Përveç se është adhurim që shpreh nënshtrimin e plotë ndaj vullnetit të Allahut, agjërimi njëkohësisht luan një rol të rëndësishëm, duke kontribuar në procesin e ndryshimit të vetvetes dhe ripërtëritjen shpirtërore. Ai ka ndikime të mëdha në përmirësimin e sjelljeve të njeriut dhe, për pasojë edhe përmirësimin e sjelljes kolektive. Agjërimi ka qëllime dhe përfitime me interes, jo vetëm për vetë agjëruesin, por edhe qëllime e përfitime që shkojnë në interes të të gjithë shoqërisë islame.

Agjërimi nuk është thjesht privim nga ngrënia dhe pija, por më tepër është privim i përkohshëm i së lejuarës, për të lehtësuar ndalimin e përhershëm të së ndaluarës. Së pari, ramazani sjell ndryshime në mënyrën e të ushqyerit dhe, në këtë mënyrë, jep shenjën e parë për ndryshime rrënjësore që duhet të ndodhin gjatë muajit të agjërimin në qenien e njeriut. Ndryshimit të kohës dhe mënyrës së të ushqyerit, i shtohet ekstra edhe namazi i teravive, mbas namazit të jacisë. Kështu, fiziku i përshtatet këtij ndryshimi, duke u hapur rrugë ndryshimeve shpirtërore. Të gjitha këto ndryshime horizontale që sjell agjërimi, pasohen me një sërë ndryshimesh

vertikale, si privimi i plotë nga çdo ndjenjë negative, duke shprehur mirësjellje, dashuri dhe respekt ndaj njëri-tjetrit. Në këtë fazë, çdo organ merr përsipër detyrën dhe përgjegjësitë e veta. Kështu, goja nuk privohet vetëm nga ushqimi, por edhe nga fjalët e pahijshme. Në të njëjtën kohë, agjëron edhe zemra, duke iu drejtuar Allahut me sinqeritet të plotë. Ky është muaji i ndryshimit edhe për faktin se është muaji, në të cilin ka zbritur Kurani Famëlartë, nëpërmjet të cilit ndryshoi e gjithë historia e njerëzimit. Muaji i ramazanit thërret në solidaritet dhe e nxit njeriun për bamirësi. Për këtë arsye, në muajin e ramazanit kemi edhe institucionin e sadekatu-l-fitrit, i cili u jepet të varfërve dhe kjo tregon se muaji i ramazanit është muaji i solidaritetit dhe i bamirësisë.

Të gjitha këto ndryshime që sjell agjërimi, janë në funksion të qëllimit të tij kryesor, i cili është devotshmëria. Sepse devotshmëria është faktori kryesor që motivon njeriun në kryerjen e veprave të pëlqyera nga Allahu teala dhe largimin prej veprimeve që janë të urryera nga Ai. Devotshmëria e mban besimtarin larg çdo mëkati, sado i vogël qoftë. Besimtarët që janë të vetëdijshëm për rëndësinë e devotshmërisë, e shohin si një qëllim që duhet arritur me një dëshirë të zjarrtë. Dhe agjërimi na shfaqet si rrugë, si mjet për të arritur këtë qëllim fisnik.

Ebu Hurejra, (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

*"Kush agjëron muajin e Ramazanit, duke qenë besimtar dhe duke shpresuar shpërblimin prej Allahut, atij do t'i falen të gjitha mëkatet e shkuara."*

(Buhari)

Pranimi i veprave dhe ibadeteve nga ana e Allahut, bëhet i mundur vetëm me plotësimin e dy kushteve: besimit dhe sinqeritetit, siç shprehet qartë në hadithin e mësipërm me shprehjet duke "qenë besimtarë dhe duke shpresuar shpërblimin prej Allahut". Nga këto që thamë, mund të na vijë ndërmend pyetja se si mundet një njeri të shfaqë vepra besimtari, pa qenë besimtar? Por fatkeqësisht, realiteti me të cilin përballemi, është me të vërtetë jo i këndshëm.

Shumë njerëz, megjithëse jobesimtarë, për arsye nga më të ndryshmet kryejnë një sërë ibadetesh. Nuk janë të pakta rastet, kur individë të ndryshëm besojnë se puna që kryejnë është obligim nga ana e Allahut teala, por, kur bëhet fjalë për zbatimin e saj, e përziejnë me hipokrizi, duke e kryer për shkaqe nga më të ndryshmet.

Këto lloj veprash, sado të duken si ibadete, nuk e arrijnë gradën e vlefshmërisë. Dhe konkretisht, hadithi në fjalë tërheq vëmendjen për këtë anë të rëndësishme të ibadeteve, duke i përgëzuar ata që i plotësojnë këto kushte në agjërimin e tyre se do t'u falen të gjitha mëkatet e kaluara.

Shprehjen "falen mëkatet", dijetarët e kanë komentuar si mëkate të vogla dhe, në rastet kur nuk ka mëkate të vogla, një agjërim i kryer sipas përshkrimit të hadithit, lehtëson mëkatet e mëdha.

Përsëri duke u bazuar te hadithi, dijetarët kanë arritur në konkluzionin se, edhe nëse një person, për shkaqe të arsyeshme nuk arrin ta plotësojë muajin e ramazanit, futet në grupin e të përgëzuarve në hadith për sinqeritetin në qëllim.

Në hadith nuk përfshihen vetëm njerëzit që kanë mëkate, por edhe ata që nuk kanë mëkate për t'u falur, të cilët me anë të agjërimit arrijnë pozita më të larta tek Allahu teala.

Vetëm nëpërmjet mënyrës së agjërimit, sipas përshkrimit të hadithit, agjërimi i ramazanit mund të luajë rolin e vet në ndryshimin dhe ngritjen shpirtërore të njeriut. Ramazani është epiqendër për përforcimin e fuqive shpirtërore, psikike e morale në jetën e popullit apo të individit.

Myslimani, i cili agjëron me vullnet të lirë e bindje të plotë, për hir të Zotit e afrimit ndaj Tij, merr pjesë aktive në rindërtimin e vlerave fisnike.

### **Mësimet që nxjerrim nga hadithi:**

1. Kush beson në obligueshmërinë e ramazanit dhe shpërblimin e pret vetëm prej Allahut, atij do t'i falen gjynahet e shkuara.
2. Besimi tek Allahu dhe shpresa e shpërblimit vetëm tek Ai, është kusht për vlefshmërinë e ibadeteve.





# KADERI DHE NËNSHTRIMI

## FSHEHTËSIA E KADERIT

Kaderi është njëri prej kushteve të besimit tonë. Ne nuk mund ta perceptojmë dhe ta shpjegojmë me mendje fshehtësinë e kaderit, i cili është domosdoshmëri e pafundësisë së dijes dhe fuqisë së Allahut të Lartësuar. Në lidhje me këtë çështje njeriu duhet të perceptojë dobësinë dhe të qenët asgjë, në mënyrë që të arrijë qetësinë e besimit duke u zhytur në prehjen e nënshtimit ndaj Zotit (xh.sh.).

Kaderi është një fshehtësi e panjohur për ne. Por ja që njeriu është i obliguar me detyra. Ai është i obliguar të bëjë atë që është e drejtë, e bukur dhe e mirë dhe ta kalojë jetën duke iu bindur urdhrave hyjnore.

Nëse njeriu e lë detyrën e tij, preokupohet me kaderin dhe shqetësohet për të ardhmen e tij, do të thotë se është larguar nga detyra e tij dhe po merret me punë që s'mund t'ia dalë mbanë.

Mevlana jep një shembull të bukur në lidhje me këtë përpjekje boshe me anë të kësaj historie në Mesnevinë e tij:

“Një burrë shkoi te Musai (a.s.) dhe i tha:

“O Kelimullah! Më mëso gjuhët e kafshëve! Sepse dua t'i kuptoj fjalët e tyre, ashtu që të marr mësim nga gjendjet e tyre. Në këtë mënyrë, dua të

perceptoj madhësinë hyjnore!..”

Musai i tha:

“Hiq dorë nga kjo dëshirë dhe mos tento t'i mësosh ato gjëra për të cilat nuk ke fuqi! Nëse një milingonë përpiket të pijë ujë mbi sipërfaqen e një liqeni, mbytet dhe shkatërrohet. Domethënë, mos u merr me dijen që nuk të është dhënë, sepse kjo ka shumë rreziqe!

Ti përpiku të marrësh mësim nga sundimi hyjnor në gjithësi me aq sa mund të të perceptojë mendja! Drejtoja zemrën Allahut Teala! Dije se të fshehtat e shfaqjeve hyjnore zbresin në një zemër të pastër!”

Nisur nga kjo, burri i tha:

“Të paktën më mëso gjuhën e qenit që shtrihet para dere për të bërë rojë dhe të shpendëve në kotec!

Pasi Musai (a.s.), e kuptoi se s'po e bënte dot të hiqte dorë sado që u mundua, e pranoi kërkesën e fundit të tij, por edhe e paralajmëroi:

“Thirri mendjes dhe mos u mbyt në oqeanin e kësaj fshehtësie!”

Burri në mëngjes u ul te pragu i derës dhe po priste duke thënë me vete: “Me të vërtetë, të shoh nëse e kam mësuar gjuhën e këtyre kafshëve.”

Ndërkohë që në ato momente gruaja shërbëto



po shkundte mbulesën e sofrës, një copë bukë e thatë ra në tokë. Gjeli, i cili gjendej aty, menjëherë e mori këtë copë buke.

Qeni i tha:

“Ti më bëre padrejtësi mua, sepse ti mund të hash edhe kokrra gruri. Ndërsa unë nuk mund t’i ha ato! Përse e more këtë copë buke e cila është kështu im?”

Ndërsa gjeli i tha qenit:

“Mos u bëj merak! Nesër do të ngordhë kali i të zotit të shtëpisë, kështu që edhe ti do të hash derisa të ngopesh!”

Kur i zoti i shtëpisë, i cili pandehi se gjeli po jepte lajm nga gajbi, i dëgjoi këto fjalë, e shiti menjëherë kalin e tij. Ndërsa gjeli u ndje i turpëruar kundrejt qenit.

Kjo grindje për interes e gjelit me qenin vazhdoi për tri ditë njëra pas tjetrës. I zoti i shtëpisë, i cili e dëgjoi nga të folurit e gjelit se ditën e parë do të ngordhte kali, ditën e dytë do të ngordhte mushka dhe ditën e tretë do të vdiste skllavi i tij, siç e shiti kalin para se të ngordhte, i nxori duarsh edhe mushkën dhe skllavin duke i shitur dhe duke menduar se po shfaqte zgjuarsin. Në këtë mënyrë, qeni nuk e arriti asnjërën prej atyre që shpresonte. Në këtë mënyrë, gjeli u duk sikur e kishte mashtruar qenin për çdo herë. Gjeli, i cili u ndje i turpëruar tri herë për shkak të atyre që ndodhën, së fundi, ditën e katërt i tha qenit:

“E vërteta është kjo se, i zoti i shtëpisë që e mban veten për të zgjuar, pandeh se ia hodhi, por këtë

do ta pësojë vetë. Tashmë nesër do të vdesë vetë ai! Trashëgimtarët e tij do të vajtojnë për të. Do të theret një ka dhe të gjithë do të hanë nga ai. Madje, edhe ne, edhe ti!..

Ngordhja e kalit, ngordhja e mushkës dhe vdekja e skllavit ishin mburojë për të keqen që do t’i ndodhte këtij burri të papjekur, por ai nuk pranoi t’i ndodhte ndonjë dëm në pasurinë e tij dhe e pësoi vetë.”

Burri i papjekur i dëgjoi këto fjalë të gjelit. Kur e dëgjoi këtë të vërtetë, iu zverdh e gjithë fytyra. Atë e kaploi një frikë e madhe nga brenda. Kështu që menjëherë shkoi te Musai dhe iu përgjërua:

“O Kelimullah! Ma dëgjo hallin dhe ma ndalo dhimbjen që kam!

Musai (a.s.), i tha:

“Ti i ke hyrë një punë që s’mund t’ia dalësh mbanë. Andaj, tashmë po ecën nëpër qorrsokakë. Mos vallë pandehe se do të fitoje duke i shitur ato kafshë? Unë të pata thënë me insistim që të mos luash me të fshehtën e kaderit dhe kadasë.

Njeriut të mençur i shfaqet që në fillim ajo që do t’i ndodhë në fund, ndërsa budallait i shfaqet në fund!.. Por ja që çdo gjë ka marrë fund. Meqë u bëre mjeshtër në punën e tregtisë dhe shitjes, tashmë shite edhe shpirtin tënd dhe shpëto!”

Ngaqë burri iu përgjërua me një pendim të madh, Musai (a.s.), i tha:

“Tashmë shigjeta ka dalë nga harku! Andaj është

*Kaderi është një fshehtësi e panjohur për ne. Por ja që njeriu është i obliguar me detyra. Ai është i obliguar të bëjë atë që është e drejtë, e bukur dhe e mirë dhe ta kalojë jetën duke iu bindur urdhrave hyjnore.*



e pamundur që të kthehet pas. Por i lutem Allahut të Gjithëmëshirshëm që të shkosh me besim kur të vdesësh!”

Musai (a.s.), iu lut Allahut të Madhëruar. Në këtë mënyrë, begatia e lutjes së Kelimullahut ndikoi që burri të shpërngulej me besim në botën tjetër. Përveç të tjerash, Allahu Teala i tha Musait:

“O Musa! Nëse dëshiron, mund ta ringjall atë.” Musai i tha:

“O Zot! falënderimet dhe lavdërimet e pafundme qofshin për Ty! Atë ringjalle në botën tjetër, në botën e ndriçuar dhe sublime! Sepse ajo është e përhershme dhe është vendi në të cilin del në pah e fshehta e kadasë dhe kaderit!”

Në këtë histori, njeriu që përpiket të mësojë të fshehtat e ngjarjeve duke mësuar gjuhën e kafshëve përfaqëson njerëzit e apasionuar pas kësaj bote.

Njerëzit e dhënë pas kësaj bote nuk e dinë se kaderi është diçka e fshehtë. Për këtë arsye, fakti që e ardhmja është e panjohur për njeriu, është mëshirë për të.

### NËNSHTRIMI

Ka kader kul-li / të përgjithshëm dhe kader khuz'i / të pjesshëm.

Kader kul-li është një e fshehtë hyjnore. Por në Xhenet, një pjesë e banorëve të Xhenetit do ta arrijnë atë. Ndërsa neve na takon që vullnetin tonë të pjesshëm ta përdorim në rrugën e Allahut Teala, në mënyrë që të bëhemi robër dhe miq të afërt me Zotin (xh.xh.).

Domethënë, ne nuk kemi asnjë mundësi ndërhyrjeje te kaderi kul-li. Kështu, ne nuk e kemi caktuar nënën dhe babain nga i cili kemi lindur dhe vendin në të cilin jetojmë, por në këtë kader kulli, Allahu i Lartësuar na ka dhënë vullnet të pjesshëm. Ja, pikërisht këtu është përgjegjësia jonë. Edhe përgjegjësia është sipas mundësisë së secilit.

Aftësia njerëzore është e pamjaftueshme për ta perceptuar kaderin kul-li në kushtet e kësaj bote.

Për këtë arsye, prehja dhe rehatia e mendjes është në raport me nënshtrimin ndaj kaderit kul-li. Ky nënshtrim mjafton për ta mbushur zemrën dhe mendjen me qetësi. Çfarëdo që robi të bëjë përtej nënshtrimit, nuk është gjë tjetër përveçse një përpjekje boshe.

Fshehtësia e kaderit, i cili është shumë larg perceptimit njerëzor, do t'u zbulohet vetëm në Xhenet një pjesë prej banorëve të Xhenetit që gjenden në shkallët e larta.

Një ditë Isa (a.s.), u bë shok rruge me dikë. Ndërkohë që po ecnin bashkë, ky personi pa disa kocka në një vend dhe iu përgjërua Isait (a.s.):

“Të përgjërhem, o Isa! Ma mëso edhe mua “ismu'l-e'adham”, në mënyrë që t'i ringjall këto kocka dhe t'i ngre në këmbë.”

Isai (a.s.) iu përgjigj:

“Ajo punë nuk është për ty. Për ta thënë “ismu'l-e'adhamin” për ringjalljen e të vdekurit, duhet të kesh një nefsi më të pastër se shiu dhe në adhurim duhet të jesh më i aftë se engjëjt. “Ismu'l-e'adham” do një gjuhë të dëlirë dhe një zemër të pastër. Domethënë, duhet të jesh një njeri që ke nefsi të pa ndyrë me haram dhe të dëlirë nga gjynahu dhe mëkati si engjëjt. Sepse, nëse dikush e ka nefsin e dëlirë, atij njeriu i pranohet lutja. Në këtë mënyrë, Allahu i Madhëruar e bën atë rojë të thesareve të tij.

Për shembull, le ta supozojmë se ti mund ta mbash në dorë shkopin e Musait, por a e ke ti fuqinë e Musait që ta bësh atë gjarpër dhe pastaj ta zaptosh?! Madje, edhe vetë Musai u tremb kur shkopi i tij u bë gjarpër dhe Allahu Teala i tha:

“**Mos ki frikë, o Musa!**” (Neml, 10)

Prandaj, çfarë dobie mund të kesh nga leximi dhe mësimi përmendësh i “ismu'l-e'adhamit” nëse ti nuk ke nefsin e Musait?”

Por ky njeriu i shkujdesur përsëri nuk ndaloi dhe i tha:

*Një besimtar i devotshëm duhet ta dijë se ajo që i ka caktuar Zoti (xh.sh.), është më e mirë për të dhe nuk duhet ta kalojë cakun. Në vend se të dëshpërohet dhe të ankohet për ato që nuk i ka arritur dot, duhet ta falënderojë Allahun e Lartësuar dhe të jetë i lumtur për ato që posedon.*

“O Isa! Nëse unë nuk e kam këtë aftësi, të paktën thuajua ti “ismu’l-e’adhamin” këtyre kockave!”

Isai e shprehu mahnitjen e tij ndaj këtyre fjalëve të këtij injoranti duke thënë:

“O Zot! Cila është urtësia e kësaj të fshehte? Përse ky injorant është aq shumë i dhënë pas debatit? Ndërkohë që zemrën e vet e ka të vdekur, përpiqet të ringjallë trupin e dikujt tjetër. Ndërsa ai ka për detyrë që të ngjallë veten e tij që në të vërtetë është e vdekur. Në vend se të bëjë dua për të ngjallur veten e tij, përpiqet për të ringjallur të tjerët. Ç’është kjo shkujdesje e tillë!”

Një tablo tjetër e kësaj kontradikte është shfaqur në këtë histori:

Një ditë Nexhmedin Kubra, i cili gjithmonë njihej me gjendjen e tij të brengosur dhe të shqetësuar për Ahiretin, mori pjesë në varrimin e një xhenazeje bashkë me nxënësit e tij. Kur imami po i thoshte telkinin të vdekurit, ky mik i Allahut bëri diçka që nuk e kishte bërë asnjëherë, qeshi. Njëri prej nxënësve të tij, i cili u habit nga kjo sjellje, mori guximin për ta pyetur dhe i tha:

“I nderuar! Asnjëherë nuk na ka rastisur që të të shohim duke qeshur. Cili është shkaku që qeshët në këtë xhenaze?”

Nexhmeddin Kubra buzëqeshi dhe bëri këtë shpjegim:

“Bir, i gjalli po i thotë telkinin të vdekurit sipas rregullit, por këtu po ndodh e kundërta. Ai që po thotë telkinin ka një zemër të shkujdesur ndaj Zotit (xh.sh.), ndërsa i vdekuri që po hyn në varr ka një zemër plotësisht të gjallë. Kështu që u habita ngaqë një njeri me zemër të shkujdesur i thotë telkinin dikujt që e ka zemrën e gjallë.”

Mësimi që mund të nxjerrim nga këto histori duhet t’ia tërheqin vëmendjen zemrës...

Mesazhi është i qartë: Lëre atë që nuk të intereson dhe preokupohu me punë që ta mbajnë zemrën të gjallë, sepse ky është qëllimi i krijimit.

Nëse mund ta përmbledhim atë që shprehëm

më sipër, mund të themi:

Një besimtar i devotshëm duhet ta dijë se ajo që i ka caktuar Zoti (xh.sh.), është më e mirë për të dhe nuk duhet ta kalojë cakun. Në vend se të dëshpërohet dhe të ankohet për ato që nuk i ka arritur dot, duhet ta falënderojë Allahun e Lartësuar dhe të jetë i lumtur për ato që posedon. Ai, as nuk duhet të mashtrohet nga joshjet e jetës provizore dhe as nuk duhet të përvëlohet me mallin e atyre gjërave që nuk i arrin dot. Ai duhet t’i kërkojë mbrojtje Allahut të Madhëruar nga një idiotësi e tillë (e dhënies pas kësaj bote), domethënë, të mos pandehë se ky mjerim është lumturi. Kështu që duhet ta ruajë qetësinë e tij shpirtërore duke e gjetur lumturinë e fshehur në vështirësi dhe mirësinë e fshehur në vuajtje.

### TË KËRKOSH FËMIJË EDHE NËSE NUK BËN...

Disa njerëz përpëliten për të pasur fëmijë me hir apo me pahir. Ata as që duan t’ia dinë nëse ky fëmijë do të jetë mirësi për ata apo do të jetë dëshpërim dhe fat i keq. Gjithashtu nuk duan t’ia dinë nëse është e mundur diçka e tillë apo jo. Për ata rëndësi ka vetëm fëmija. Ndërsa gjërat e tjera janë dytësore. Në këtë mënyrë, gjërat që i konsiderojnë si dytësore, i shohin me syrin e lehtë.

Sigurisht se përpjekjet për të pasur fëmijë janë të pranueshme, por kundërshtimi i vullnetit hyjnorë, këmbëngulja e shkujdesur duke mos e pranuar kaderin dhe mosbindja ndaj dispozitave të Allahut Teala, e shpie njeriun në humbje dhe shkatërrim.

Ndërkohë edukata që i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka mësuar në lidhje me këtë çështje është pranimi i rezultatit vetëm sipas kaderit dhe mirësisë. Siç dihet, i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk pati fëmijë nga nëna jonë, Hatixhja edhe pse dëshironte shumë. Edhe pse ajo ishte nëna jonë më e afërt ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), pas Hatixhes, Pejgamberi nuk bënte dua me këmbëngulje që të kishte patjetër një fëmijë prej saj. Edhe nga nëna jonë, Aishja nuk është shfaqur ndonjë shqetësim





që i kalonte kufijtë e vullnetit hyjnor në lidhje me këtë çështje.

Ata të cilët shqetësohen tej mase për të pasur fëmijë me patjetër edhe krahas këtyre shembujve, do të shkatërrohen në kthesat e dhimbshme të kaderit hyjnor dhe do të shndërrohen në gërma-dha shpirtërore si mësim për të tjerët ngaqë do të vuajnë nga rezultatet e privimit prej mirësisë.

Ndërkohë zgjidhja është te nënshtrimi dhe pranimi me edukatë i vullnetit hyjnor, ashtu siç bëri edhe i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe nëna jonë, Aishja. Pasi të veprohet në këtë mënyrë, në pah del një prehje shpirtërore te bota e jashtme dhe e brendshme e njeriut.

### KURANI NUK DUHET NEGLIZHUAR!

Por për fat të keq, shumë prindër e lënë pas dore mësimin e Kuranit Fisnik. Përveç të tjerash, justifikohen duke thënë:

“Le të fitojë fëmija të ardhmen e tij dhe ta ndërtojë atë në mënyrë sa më të fortë!”

Si rezultat, i çojnë ata nëpër kurse dhe universitete duke bërë shpenzime të pallogaritshme. Këtë veprim e konsiderojnë si çdo gjë që mund të bëjnë për të ardhmen. Andaj nuk bëjnë kujdes se çfarë bëjnë dhe se si jetojnë fëmijët e tyre. Krahas kësaj, pothuajse i mbyllin sytë ndaj zvarritjes së fëmijëve të tyre drejt batakut duke u shprehur:

“Çfarë të bëjë fëmija. Nuk ka zgjidhje tjetër. Duhet të sigurojë të ardhmen!” Pastaj përballen me fatkeqësi të mëdha. Ngaqë nuk gjejnë dot zgjidhje dhe janë të dobët përballë këtyre problemeve, i sheh duke shkuar te të tjerët dhe duke u thënë:

“Birit / bijës sime i ka ndodhur kështu e ashtu. Ju lutemi bëni sa më shumë dua që të rregullohet!”

Ata asnjëherë nuk e marrin veten në llogari duke e pyetur:

“Çfarë ka urdhëruar Allahu i Madhëruar dhe çfarë kam bërë unë?”

Sa e kam edukuar fëmijën tim në rrugë të Allahut Teala? Si e kam edukuar? A me një lutje të thatë do ta kthej në mirësi rezultatit e tmerrshëm që doli si shkak i të mos bërit asgjë në kohën e saj?

Andaj, o ju prindër! Hapeni dhe lexojeni Kurandin! A nuk e shpreh Allahu i Lartësuar kështu të fshehtën e krijimit:

“Të më njohin dhe të më adhurojnë me sinqeritet të plotë!”

Çfarë keni bërë ju, ndërkohë që edukimin e fëmijëve duhej ta sistemonit sipas qëllimit të mësipërm duke e mbajtur këtë edukim mbi gjithçka? Përse i keni dhënë më shumë përparësi edukimit për këtë botë provizore? Përse nuk i keni dhënë rëndësi edukimit për botën e përhershme? Si ka mundësi që edukimin e zakonshëm e pandehët sikur të ishte gjithçka?

A nuk e di një besimtar se lumturinë dhe të ardhmen mund ta japë vetëm Allahu Teala?

A nuk i lutemi Zotit (xh. sh.), në çdo rekat të namazit duke thënë:

“O Zot! Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”

Përfundimisht, e gjithë çështja është devotshmëria.

Robi nuk përjeton fatkeqësi të tilla vetëm kur të kapet pas devotshmërisë, sepse Allahu i Lartësuar thotë kështu për Librin e Shenjtë (Kurandin), në mënyrë që ta perceptojmë mësimin e Kuranit:

“(Kurani) është udhëzim për të devotshmit...”

Domethënë, Kurani Fisnik është i vetmi udhëzues në çështjen e edukimit. Për kë? Për njerëzit me zemër të devotshme.

Të gjithë duhet ta dimë se të ardhmen e jep vetëm Allahu Teala.

Për këtë arsye, asnjë prind nuk duhet të shqetësohet për të ardhmen e përkohshme të fëmijëve duke e neglizhuar të ardhmen e përhershme dhe sipas perceptimit të tij të thjeshtë e të paaftë;

*“Fëmija im le të jetë më rehat se unë! Unë kam hequr keq, kështu që fëmija im të mos heqë! Ai le të jetojë një jetë të pamundimshme! Gjërat që ia prishin psikologjinë le të mos kenë vend në jetën e tij! Mjedisin që e rrethon dhe besimin ndaj vetes le ta ketë siç duhet! Le të mos i prishet qejfi! Le të mos bjerë në vështirësi! Le të jetojë në bollëk!”*

## TË MOS GUXOJË PËR TË CAKTUAR KADERIN E FËMIJËVE TË TIJ!

Sepse kjo është e pamundur.

Edhe pse është e pamundur, shumë prej prindërve kaplohen pas gënjeshtreve si: “Fëmija im le të jetë më rehat se unë! Unë kam hequr keq, kështu që fëmija im të mos heqë! Ai le të jetojë një jetë të pamundimshme! Gjërat që ia prishin psikologjinë le të mos kenë vend në jetën e tij! Mjedisin që e rrethon dhe besimin ndaj vetes le ta ketë siç duhet! Le të mos i prishet qejfi! Le të mos bjerë në vështirësi! Le të jetojë në bollëk!”, dhe guxojnë pothuajse t’i caktojnë kaderin fëmijëve të tyre në këtë drejtim.

Më së fundi, shkatërrojnë edhe veten, edhe fëmijët e tyre.

Sepse zgjidhja nuk është te përpjekja për të larguar sprovat të cilat janë ligje të kaderit hyjnor, por te përgatitja për t’ia dalë mbanë me to dhe për të fituar pëlqimin e Allahut Teala.

Të vërtetën që mund t’u përplasit në fytyrë atyre që tentojnë ta nëpërkëmbin kaderin, Nexhip Fazëll Kësakyreku e shpreh kështu nga gjuha e Hysrevit si simbol i veprës “Të krijosh një njeri”:

“Të krijosh një njeri... T’i përshtatësh atij një kokë, një palë sy, një hundë dhe një gojë. Të bësh një tru për atë dhe t’i vendosësh një zemër brenda në kraharonin e tij. Pra, një zemër që të punojë si sahat dhe që t’ia çojë gjakun në të gjithë trupin. Një zemër, a e kupton? Gjoja një vend që ndjen dhe që mbart dhimbjet e gëzimet. Një zemër. A mbaroi? A mund të mbarojë?”

Këtë njeriu duhet t’i caktosh edhe kaderin. Ky njeri do të jetojë, do të ecë, do të shëtisë dhe do të përrjetojë shumë gjëra. Ky njeri, për shembull, duhet të ketë një baba. Ai baba do të gjendet i varur në degën e një fiku. Pastaj edhe ai... Eee?

A bën që të matem me pafundësinë? A mund

të garojnë numrat, milionat, miliardat me pafundësinë?

Unë tentova për të krijuar një njeri. Tashmë më duhet t’i jap një fytyrë dhe një kader... Nga t’i marr? Edhe vetë mua m’i ka dhënë dikush tjetër. Njeriu pa fytyrë dhe pa kader, u acarua. E këputi zinxhirin dhe më iku nga duart. Unë jam njeri. Andaj, më goditi pas shpine. Njeriu pa fytyrë dhe pa kader, mori fytyrën time. Veshi pamjen time dhe hyri në kaderin tim.

Unë u rrëzova nga shkëmbi në të cilin desha të ngjitesha. Ja që e paskam tepruar shumë dhe paskam hyrë në vend të ndaluar.

Ndërkohë që po ecja me sytë e verbër, shkela mbi disa te fshehta sikur të ishin një fole e dyzetkëmbëshit. Ato ishin rojet e botës së gajbit. Andaj u trembën dhe më lënduan.

Hija tashmë e njohu artistin, pra artin hyjnor. Unë tani, në këtë moment e njoh Allahun e Lartësuar. Mendja po më ikën kundrejt dijes dhe artit të Tij. Mendja po më shpërthen dhe po bëhet hi si një depo municioni.”

Përfundimisht, kaderi është një e fshehtë hyjnore. Ajo që na takon të bëjmë ne si robër është nënshtrimi ndaj Allahut të Madhëruar.

Zoti ynë, Allahu Teala na ka dhënë mendje aq sa na mjafton për t’iu bërë robër Atij. Ai e ka fshehur të ardhmen prej nesh. Vetëm Ai e di gajbin. Detyra që të gjithëve na takon të bëjmë është që të arrijmë te Ai në atë drejtim që ka caktuar vetë Ai dhe jo në atë drejtim që mund të caktojmë ne. Çdo gjë tjetër përveç kësaj është e përkohshme!

O Zoti ynë! Të lutemi që të mos na ndodh ndonjë gjë tjetër përveç asaj që ke shkruar Ti! Na e shkruaj që të të falënderojmë për mirësitë që na ke dhuruar dhe të durojmë kundrejt sprovave! Na jep mirësi në të dy botët!.. Na jep mëshirë nga ana Jote dhe na e lehtëso shpëtimin dhe udhëzimin në çdo gjendje që mund të kemi!.. Amin!..





# Të humbasësh, ndërkohë që pandeh se je duke fituar

Ahmet Zijlan

Çdo njeri dëshiron të jetë i pasur. Çdo njeri dëshiron të ketë para, prona, famë dhe pozitë, sepse njeriu ka një nefs që nuk di të ngopet asnjëherë.

Para do të thotë mundësi. Para do të thotë një jetë më e rehatshme dhe një e ardhme më e sigurt. Para do të thotë një shtëpi, në të cilën mund hysh brenda dhe të qëndrosh i sigurt dhe një makinë, në të cilën mund të hipësh.

Pastaj pasuri do të thotë fuqi. Do të thotë që të mos kesh nevojë për njeriun e keq. Do të thotë që t'u dalësh për zot bashkëshortes, mikut, familjes dhe të afërmeve të tu. Do të thotë t'u shërbesh më fuqishëm idealeve të tua. Përfundimisht, para do të thotë shumë gjëra, por jo çdo gjë.

Pasuria apo zgjerimi i mundësive materiale kanë edhe efektet anësore. Siç mund të ketë efekte anësore një ilaç që shëron, edhe pasuria ka dëmet e saj që vijnë njëkohësisht me të.

Në të vërtetë, njeriu nuk mund të bëhet i pasur thjesht ngaqë dëshiron. Sado punëtor, i aftë, i ndershëm, i mençur dhe ekonomist që të jetë njeriu, e ka të pamundur të bëhet i pasur nëse nuk do Zoti (xh.xh.). Pasuria është çështje fati.

Allahu i madhëruar të gjithë i sprovon me diçka. Atyre që u ka dhënë pasuri, i ka urdhëruar që t'u japin edhe të varfërve dhe të vobektëve. Të pasurit duhet të japin zekatin e pasurisë së tyre, duhet të shpenzojnë për hir të Allahut Teala dhe duhet të përkujdesen për skamnorët. Nëse të pasurit i realizojnë këto detyra, marrin sevape.

Por nëse njerëzit e harrojnë se ato që ua ka dhënë

Allahu janë amanet dhe thonë: "I kemi fituar vetë. Kemi vënë mendjen në punë dhe i kemi fituar. Andaj jemi bërë të pasur.", ndoshta në këtë botë mund të jetojnë në luks, por ahireti i tyre është në rrezik serioz. Nëse njerëzit e humbin sprovën dhe zhyten në harame, nesër në mahsher do të thonë: "Ah sikur të mos ishim të pasur!"

Nëse e përmbledhim atë që shpjeguam deri tani, mund të themi se pasuria i zgjeron mundësitë. Për këtë arsye, shumë gabime njerëzit i bëjnë me para. Bixhozi, alkooli, prostitucioni dhe argëtimi i shfrenuar bëhen me para. Njeriu që s'ka para, ndoshta mbrohet nga këto të këqija vetëm ngaqë nuk ka para. Ndërsa për të pasurit këto gjëra janë më të lehta. Nëse ai që ka para fillon të formojë një mjedis i cili e nxit për të bërë të tilla gjërash, do të thotë se tashmë kanë filluar të bien kambanat e rrezikut.

Edhe nëse njeriu mbrohet nga dëfrimi i shfrenuar, atë e pret një rrezik tjetër: luksi dhe shpërdorimi i pasurisë... Ndërkohë që rriten mundësitë, njerëzit dëshirojnë të banojnë në mjedise më të pasura. Sapo të ndodhë kjo, ndryshojnë edhe njerëzit të cilët i rrethojnë. Nëse fëmijët, veçanërisht gratë, fillojnë t'i përshtaten mjedisit të ri që i rrethon, pasuria ia shkatërron të gjithë jetën njeriut. Nëse mjedisi përbëhet nga njerëz të pasur dhe të llashtuar, njeriu tashmë fillon ta harrojë vendin nga i cili ka ardhur, të kaplohet nga mendjemadhësia



e mburrja dhe ta shohë veten më lart se të tjerët. Gjithashtu i prishet edhe morali. Sigurisht që ka edhe raste specifike, andaj të gjithë nuk bëhen kë-shtu, por shumica e njerëzve përfundojnë të tillë. Për këtë arsye, duhet të bëjmë tepër kujdes.

Njerëzit e tillë e humbin ahiretin, ndërkohë që përpiqen për të fituar këtë botë.

Ata mund të blejnë vila, por humbin fëmijët e tyre.

Ata mund të hapin biznese të mëdha, por e humbin hallallëkun.

Shumë njerëz që kanë marrë rrugën me mendimin për të fituar para dhe për t'u bërë të pasur, në mënyrë që të bëhen të dobishëm për atdheun, popullin, fenë dhe shoqërinë e tyre, kanë rënë në këto fatkeqësi të pasurisë.

Gjyshërit tanë kanë thënë:

“Nuk mund të ketë shumë fjalë pa gabime dhe shumë para pa haram.”

Në të kaluarën, këtë e kam parë edhe vetë dhe e kam përjetuar shqetësimin që të shkakton.

Po mendonim për ta mbartur punën në Stamboll. Ishte viti 1970.

Bashkë me bashkëshorten planifikuam të udhëtonim në Bursa, Jallova dhe Stamboll. Në këtë mënyrë, do të shikonim nëse mund të vendoseshim në Stamboll dhe nëse do të na pëlqente apo jo. Siç

edhe e menduam, shkuam në terminalin e Jallovës dhe kaluam në Stamboll. Neve na këshilluan:

“Shikojeni një herë edhe Ishullin e Madh, sepse është shumë i bukur!” Edhe ne shkuam te Ishulli i Madh. Po shëtisnim. Me të vërtetë kishte një bukurri të mahnitshme. Deti blu, anijet që shkonin e vinin, çdo vend ishte i mbuluar me gjelbërim, rrugët e mira, shtëpi të bukura... Çdo gjë ishte shumë bukur.

Mjete motorike për transport nuk kishte. Aty funksiononin vetëm pajtonet.

Njerëzit kishin rroba mjaft cilësore. Andaj dukej qartë se ishin të pasur.

Por ja që gratë ishin shumë të zbuluara... Aty ishte një botë plotësisht tjetër. Pasi shëtitëm pak sa andej e këtej, na mori uria. Lokale kishte sa të duash, ama vende të tilla në të cilat qëndronin bashkë burra e gra dhe me alkool, nuk ishin të përshtatshme për ne.

Çfarë të bëjmë? Kështu menduam: “Le të marrin pak domate, specë, djathë dhe bukë nga dyqani dhe të bëjmë piknik nën hijen e pemëve. Ndërkohë që shohim detin, hamë edhe ushqimin. I morëm të gjitha që na duheshin, por kishim harruar kripën. Përbalë nesh gjendej një dyqan që shiste mushkëri. Me vete thashë: “Aty duhet të ketë kripë. Prandaj le të shkojmë dhe t'i kërkojmë.”

Shitësit i dhashë selam dhe i thashë:

“Desha pak kripë...” Shitësi i mushkërive po grin-te disa mushkëri për një grua kliente. Më tha:



“Nëse prisni dy-tri minuta, do t’jua jap.” Unë prita. Pasi e përcolli klienten, ma dha kripën dhe më tha:

“Ju kërkoj ndjesë! Të lash me qëllim për të pritur. U bënë shumë kohë që në këto anë nuk kam parë grua të mbuluar që pret jashtë. U emocionova dhe u përmallova. Për këtë arsye të lashë të prisje disa minuta.”

Shitësit po i digjej zemra... Pasi gjeti një mik për ta qarë hallin, filloi të tregonte:

“Ne jemi shpërngulur nga Trakia perëndimore dhe kemi ardhur këtu. Edhe nëna ime ka qenë e mbuluar me shami. Gjithashtu edhe gjyshja bashkë me tezen time. Të gjitha të afërmet e mia kanë qenë të mbuluara. Islamin e njihnim deri diku. Pastaj ata njerëz ikën... Pandehja se nuk kanë ngelur më gra të mbuluara... Kur ju pashë, u habita. Akoma paska gra të mbuluara në këtë botë? - thashë me vete.

Unë nuk mund të dal jashtë nga Ishulli i Madh. Andaj të gjithë njerëzit i pandehja se ishin si këta këtu.

Kur kam ardhur këtu, pata filluar si çirak në dyqan. Kam tri vajza dhe një djalë. Të gjitha vajzat e mia i kanë gjetur vetë bashkëshortët e tyre. Ndërsa djali nuk e ka gjendjen edhe aq mirë. Nusja është pak më e mirë se sa vajzat e mia.

Për bajramin e fundit na erdhën dhëndurrët. Sigurisht që edhe vajzat. Në mëngjes u thashë dhëndurëve:

“Çohuni të shkojmë në namazin e bajramit!” Ata ma kthyen:

“Çfarë?! A akoma je në botën e vjetër ti? Ç’është ky namaz?”

Për këtë arsye, nuk u kënaqa aspak nga festa. A këto janë vajzat e mia? Këta janë dhëndurrët e mi? Ashtu ë? Çfarë ditësh që kanë ardhur!..

U bënë shumë kohë që i kam marrë këto dyqane. Këto janë pasuria ime, por kam humbur çdo gjë tjetër. Ndërkohë që fitoja këtë botë, humba fëmijët e mi.

Të lashë të prisje ngaqë desha ta qaja këtë hall me ty. Ndërsa kripa ishte thjeshtë një justifikim.

Mund të ta jepja në moment.” Edhe unë e dëgjova, e mora kripën dhe pastaj dola.

Falënderimet i takojnë Allahut të Lartësuar që në vendin ku banoj, gjithmonë më del përpara nga një haxhi. Elhamdulillah! Fqinjët në pallat dhe mjedisi përreth është i mbushur me njerëz pozitivë dhe fetarë. Në këtë mënyrë, kemi arritur t’i mbrojmë fëmijët tanë. Gjithashtu jemi përpjekur t’u japim edhe mësimë shpirtërore.

Ne jemi përpjekur, ndërsa Allahu Teala i ka mbrojtur. Por ja që në vendin tonë ka shumë shembuj si ai i shitësit të mushkërive. Njerëzit kaplohen nga mjedisi dhe humbin çdo gjë. Ata shkatërrohen dhe bëhen copë e çikë nën kthetrat e erërave të modave. Pastaj habiten edhe vetë me gjendjen e tyre. Kjo gjendje i gllabëron ata si një dallgë apo batak. Kur njeriu ta kuptojë këtë, është shumë vonë për të.

Për këtë arsye, dy gjëra janë të rëndësishme:

Familja është shumë e rëndësishme.

Mjedisi që na rrethon është shumë i rëndësishëm.

Më në krye vjen familja...

Më në fillim, një besimtar duhet ta zgjedhë bashkëshorten e tij me të njëjtat mendime për jetën si edhe vetë ai dhe nga një familje e cila mendon dhe ndjen se lumturia e ahiretit duhet të vlerësohet më shumë se kjo botë, sepse bashkëshortja është ajo që e drejton më së shumti burrin. Edhe nëse ky besim dhe mendim ka filluar të prishet apo të zbehet, ai duhet të përpiqet që ta mbajë atë në vijën e duhur.

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i ka përjetuar vështirësitë e varfërisë. Por ja që erdhi një ditë dhe u bë kryetar shtetit Pasi u shtuan mundësitë, edhe familja e të Dërguarit të Allahut (a.s.), mund t’i kërkonte këto, por ai e ndaloi këtë. Shikoni se si e urdhëroi bashkëshorten e tij:

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i ka përjetuar vështirësitë e varfërisë. Por ja që erdhi një ditë dhe u bë kryetar shtetit Pasi u shtuan mundësitë, edhe familja e të Dërguarit të Allahut (a.s.), mund t’i kërkonte këto, por ai e ndaloi këtë. Shikoni se si e urdhëroi bashkëshorten e tij:

“*(O Aishe!) Nëse dëshiron të jesh me mua (në xhennet), në këtë botë duhet të mjaftohesh me ushqimin e një udhëtari.*”

*Asnjëherë mos u shoqëro me bisedat e të pasurve (ambiciozë që janë zhytur në këtë botë)! Kurrë mos*



*e konsidero të vjetër një rrobë nëse nuk ka ndonjë arnë!” (Tirmidhi, Libas, 38/1780.)*

Umer ibn Abdulazizi, rahmetullahi alejh, është shumë i njohur. Kur u bë kalif, i tha bashkëshortes së tij:

“Hiqi stolitë e tua, sepse do t’ia çoj bejtu’l-malit (thesarit të shtetit)!” Domethënë, ai dëshironte që bashkëshortja e tij të mos pandehte se do të jetonin në luks dhe dëfrim ngaqë kishte kaluar në udhëheqje. Përkundrazi, ai i bënte të gjithë pjesëtarët e familjes së tij që ta ndjenin se kishin hyrë nën një përgjegjësi të rëndë. Bashkëshortja e tij shprehet:

“Kalifi shqetësohej aq shumë (për çështjet e umetit), saqë thosha: ‘Ah sikur të mos na ishte dhënë neve udhëheqja.’”

Pastaj mjedisi që na rrethon...

Çfarëdo qëllimi që të ketë besimtari, ashtu duhet ta zgjedhë edhe mjedisin që e rrethon. Andaj, asnjëherë nuk duhet të banojë nëpër mjedise që nuk përputhen me besimin, traditën dhe zakonet e tij duke thënë: Tashmë më është lartësuar pozita ekonomike. Kur ta çojë fëmijën për ta edukuar, edhe shkollën duhet ta zgjedhë sipas kësaj.

Dijetarët thonë se ky është një hixhret në shkallën e tij. Bërja e zgjedhjeve duke marrë parasysh besimin dhe vendosja nëpër vende ku kushtet e mundësojnë zbatimin e besimit në mënyrë sa më efikase, është hixhret. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salatu ve’s-selam, ka thënë:

*“Muhaxhir është ai që i lë gjërat të cilat i ka ndaluar Allahu.” (Buhari, Iman, 4.)*

Andaj, besimtari nuk duhet të banojë në një mjedis ku gjërat që i ka ndaluar Allahu Teala bëhen haptazi. Ai asnjëherë nuk duhet të shoqërohet me shokë të atillë. Gjithashtu, duhet ta mbrojë edhe familjen e tij nga këto.

Përsëri gjyshërit tanë kanë thënë:

“Mos bli shtëpinë, por fqinj!”

Ky është helm!

Cili është kundërhelmi?

Formimi i një mjedisi me njerëz të devotshëm. Për këtë arsye, besimtari duhet të ketë një xhemat që e frekuenton dhe shokë që e inkurajojnë për mirësi dhe që i tregojnë të vërtetën për hir të Allahut të Madhëruar. Ai duhet të ketë kuvende në të cilat zhvillohen ligjëratat fetare dhe të cilat i frekuenton një herë në javë apo një herë në muaj. Duhet të ketë shokë me të cilët i fal në xhami pesë kohët e namazit. Edhe fëmijët e tij duhet të bëhen shokë me fëmijët e shokëve të tij të sjellshëm dhe të edukuar. Ata duhet të shkojnë në të njëjtën shkollë. Besimtari duhet të shëtisë dhe të bëjë piknik me shokë të tillë...

Nëse besimtari i zbaton këto kushte, nuk e harron të kaluarën dhe e planifikon në një formë të saktë të ardhmen e tij, atëherë pasuria nuk mund t’i bëjë asnjë dëm.

Varfëria është një sprovë, edhe pasuria gjithashtu...

Lum për atë që mund t’i kalojë të dyja këto sprova si një rob i devotshëm që i zbaton dispozitat e vendosura nga Allahu me durim dhe falënderim!..

Edhe falënderimi i Zotit (xh.sh.), për pasurinë është i mbushur me durim. Pra, durimi për të mos i harxhuar në vende të gabuara mundësitë që i sjell pasuria. Durimi ndaj thirrjes që e fton besimtarin në shturje, gjëra luksoze, shpërdorime dhe kaplim nga mendjemadhësia... Ja pra, falënderimi i Zotit për pasurinë që ka dhënë duhet të bëhet me këtë durim.

Le ta përfundojmë shkrimin tonë me një hadith fisnik të të Dërguarit të Allahut (a.s.):

*“Unë me të vërtetë mahnitem nga besimtari, puna e të cilit është e gjitha mirësi!.. Këtë nuk e ka asnjë tjetër përveç besimtarit.*

*Kur i jepet ndonjë mirësi, falënderon. Kjo është e mirë për të.*

*Ndërsa kur i ndodh ndonjë fatkeqësi, bën durim. Edhe kjo është e mirë për të.” (Muslim, Zuhd, 64)*

I lutemi Allahut Teala që shejtani të mos na mashtrorë me pasuri, epsh dhe famë! Zoti (xh.sh.), mos na ndaftë nga rruga e drejtë dhe na dhëntë një fund të mirë! Amin!..







# PËRGËZOJI DURIMTARËT

— Sami Gëksyn —

Allahu, xhelle xhelaluhu, u jep sprova të ndryshme robërve të Tij në jetën e kësaj bote. Disave u jep fatkeqësi e vështirësi, ndërsa disa të tjerë i zhyt në pasuri dhe mirësi. Ndërkohë njeriu mërzhitet prej njëres dhe gëzohet prej tjetres. Por ai shpeshherë nuk e kupton dot se cila është më e mirë për të. Për këtë arsye, gjërat që na duket si të mira, mund të jenë të këqija dhe gjërat që na duket si të këqija mund të jenë të mira. Me çfarëdo gjendjeje që të përballemi, rezultatit duhet ta shndërrojmë në mirësi duke vepuar me durim.

Durimi është urdhër i Allahut të Lartësuar që ua ka dhënë robërve të Tij, në mënyrë që ta përdorin kur të jetë i nevojshëm. Durimi është i vështirë, por aq sa është i vështirë, është edhe një vepër e mirë me shumë virtyte. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar thotë kështu në Kuranin Fisnik, duke u premtuar shumë shpërblime besimtarëve që bëjnë durim:

**Thujaj: “O robër besimtarë (të Allahut), frikësouni Zotit tuaj! Ata që bëjnë mirë në këtë jetë, do të kenë të mira. Toka e Allahut është e gjerë. Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë.”** (Zumer, 10)

Shpërblimi pa masë, që do t’u jepet besimtarëve durimtarë tregon se sa i rëndësishëm është durimi.

Sikur durimi i shfaqur përballë fatkeqësive të mos ishte një cilësi sublimë, nuk do të pretohej shpërblim pa masë për të.

Durimi është një vepër e frytshme që na duhet në çdo çështje. Siç është namazi mbreti i adhurimeve, edhe durimi është koka e të gjitha sjelljeve morale. Ata që bëjnë durim, i arrijnë shumicën e dëshirave që kanë në zemër. Myslimani i arrin qëllimet që synon dhe i kalon vështirësitë e mëdha duke e mbajtur vazhdimisht përpara dritën e durimit.

Allahu Teala e shpreh kështu këtë të vërtetë në suren Asr:

**“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”** (Asr, 1-3)

Surja Asr, e cila njofton se do të shpëtojnë nga humbja dhe dëmi ata të cilët i këshillojnë njëri-tjetrit durimin, tregon se ndihma më e mirë që mund t’i bëhet një myslimani është këshillimi i tij për durim.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpreh kështu këtë të vërtetë:

**“...Namazi është një nur, lëmosha është një argument, ndërsa durimi është dritë...”** (Muslim, Taharet, 1.)

Fakti që i Dërguari i Allahut (a.s.), thotë se durimi është dritë dhe namazi është nur, tregon se durimi përfshin dhe ndriçon çdo gjë në jetën e njeriut, sepse durimi dhe namazi zgjidhin çdo çështje. Atëherë, ne duhet të mos dorëzohemi menjëherë përballë vështirësive, fatkeqësive e vuajtjeve dhe duhet të bëhemi robër prej të cilëve është i kënaqur Allahu dhe i Dërguari i Tij duke u përpjekur, në mënyrë që të dalë në pah e drejta dhe e vërteta. Atij që përpiket duke shfaqur durim, Allahu Teala i jep shpërblim. Këtë e vërteton edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili shprehet:

*“...Këtë dijeni mirë se, kushdo që dëshiron ta mbrojë nderin, Allahu e bën të ndershëm. Kushdo që përpiket për të bërë durim, Allahu i dhuron durim. Kushdo që dëshiron të bëhet i pavarur nga njerëzit, Allahu e bën të pavarur nga njerëzit. Juve nuk ju është dhënë ndonjë mirësi më e frytshme dhe më e madhe se durimi!”* (Buhari, Rikak, 20.)

Besimtari mund ta shdërrojë në mirësi çdo lloj vështirësie, fatkeqësie dhe tragjedi duke e përballuar atë me durim dhe vendosmëri. Siç i shton mirësitë falënderimi i Zotit për to, edhe durimi ndaj vështirësive e fatkeqësive bëhet shkak që ato të shndërrohen në mirësi.

Enes ibn Maliku, radijallahu anh, transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), po kalonte pranë një gruaje që po bërtiste me të madhe në krye të varrit të fëmijës së saj që i kishte vdekur. Asaj i tha:

*“Ki frikë nga Allahu dhe bëj durim!”*

Ndërsa gruaje ia ktheu:

*“Hiqmu nga sytë! Fatkeqësia që më ka ndodhur mua, nuk të ka ngjarë ty.”*

Gruaja nuk e pati njohur të Dërguarin e Allahut (a.s.). Asaj i thanë se ai që ia tha këtë fjalë ishte i Dërguari i Allahut, (a.s.). Sapo gruaje e dëgjoi këtë, shkoi me vrap te shtëpia e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe i tha Hz. Pejgamberit për t'i kërkuar ndjesë:

-O i Dërguari i Allahut! Unë nuk ju njoha.”

Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha:

*“Durimi është në çastin e parë kur të përballësh me fatkeqësinë (ta përballosh atë me vendosmëri dhe largpamësi).”* (Ebu Davud, Xhenaiz, 32.)

I Nderuari i të Dy Botëve, (a.s.), menjëherë aty ia përkufizoi asaj dhe umetit të tij nëpërmjet saj se çfarë është durimi.

Në të vërtetë, koha është ilaçi i çdo gjëje. Pasi të kalojnë disa ditë dhe të ecë koha, njeriu fillon dhe ushtrohet me ngjarjen që i ka ndodhur. E rëndësishme është që të rezistojmë në momentin e parë kur të përballemi me ndonjë vështirësi apo fatkeqësi. Kjo, në një lloj mënyre, tregon pjekurinë e besimit tonë.

Nëse besimtari mund të veprojë me mendimin se durimi është zgjidhja e vërtetë e të gjitha vështirësive, do të arrijë shumë shpërblime të Allahut të Madhëruar në këtë botë dhe në botën tjetër.

Durimi ndaj zhdukjes apo shkatërrimit të gjërave të vlefshme dhe dorëzimi i plotë ndaj Allahut Teala, e bën njeriun të arrijë gjëra edhe më të vleshme.

Sa bukur i shpjegon ky shembull këto ngjarje dhe të tjera të ngjashme me to:

Një ditë, një grua shtatmadhe dhe esmere shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha:

*“Mua më kapin krizat e epilepsisë dhe më hapen rrobat. Lutjuni Allahut që të shërohem!”*

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha asaj:

*“Nëse përpiqesh të durosh, do të shpërblehesh me xhenet. Por nëse ti do, unë i lutem Allahut që të të japë shërim.”*

Nisur nga kjo, gruaje i tha:

*“Unë bëj durim ndaj sëmundjes sime, por ju lutuni që të mos më hapen rrobat kur të më kapin krizat e epilepsisë.”* I Dërguari i Allahut (a.s.), u lut për gruan në fjalë. (Buhari, Merda, 6; Muslim, Birr, 54.)

Durimi ndaj vështirësive dhe fatkeqësive në këtë botë e bën njeriun të fitojë xhenetin në botën tjetër.

Ai që e ka përdorur në mënyrën më efikase durimin është i Dërguari i Allahut, (a.s.). Ai është përballur me vështirësi aq të mëdha në luftën për Islamimin që ka bërë me politeistët e Mekës, sa që duke falur namaz i kanë vënë mbi kokën plëncin e devesë me gjithë papastërtinë që kishte brenda. Ata i vendosën bojkote atij. Në Taif e gjuajtën me gurë dhe ia gjakosën të tërë trupin. Në luftën e Uhudit i thyen dhëmbin. Krahas këtyre, dhimbjet më të mëdha i përjetoi me vdekjen e gjashtë fëmijëve të tij prej shtatë fëmijëve që kishte. Ai ngeli ballë për ballë edhe me shumë vështirësi të tjera. Por sproven e të gjithave e kaloi në mënyrën me të mirë duke iu nënshtruar plotësisht Allahut Teala.

Prandaj, ne duhet t'i lexojmë dhe t'i kuptojmë mirë sprovat e durimit që ka kaluar i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe kur të përballemi me sprovat të ngjashme, duhet të bëjmë durim dhe të jemi të fortë si ai duke e pasuar traditën e lartë profetike të tij. Gjithashtu, duhet ta dimë se për çdo provë që kalohet me sukses, ka shpërblime në këtë botë dhe në ahiret. Ja, pikërisht atëherë do ta arrijmë prehjen shpirtërore.

Allahu i Lartësuar mos na lëntë ballë për ballë me sprovat që nuk mund t'i kalojmë me sukses dhe nuk mund t'i përballojmë! Gjithashtu, na e mundësoftë që t'i kalojmë me durim të gjitha sprovat me të cilat do na lërë ballë për ballë dhe të na bëjë prej atyre që do të arrijnë shpërblimet për të cilat bëhet fjalë në ajetin: “Përgëzoji durimtarët!” Amin!..



# Rënia dëshmor

## pozita më sublime pas profecisë

Asc. prof. dr. Mustafa Karabaxhak

Kuptimi leksikor i fjalës shehadet është: të dëshmosh, të gjendesh në audiencë, të perceptosh, të njoftosh, të marrësh lajm dhe të mësosh. Ndërsa kuptimi terminologjik fetar i kësaj fjale është përkufizuar kështu: Pozita që arrihet si rezultat i përpjekjes në rrugë të Allahut Teala për ta lartësuar fenë e Tij.

Atyre që e arrijnë gradën e shehadetit / rënies dëshmor, u thuhet shehidë / dëshmorë. Allahu i lartësuar nuk dëshiron që të themi se ata janë të vdekur. Kjo shprehet qartë në ajetin fisnik të mëposhtëm:

**“Dhe mos thoni për ata që vriten në rrugën e Allahut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndjeni!”** (Bakara, 154) Kur sahabët e pyetën të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në lidhje me këtë ajet, ai u përgjigj:

*“Shpirtrat e atyre (dëshmorëve) janë brenda te zogjtë e gjelbër. Këta zogj kanë kandila të varur në Arsh. Ata fluturojnë dhe shëtisin nëpër xhenet si të dëshirojnë, pastaj kthehen dhe futen në kandilët e tyre. Zoti i shikon ata dhe u thotë:*

*“A dëshironi ndonjë gjë?*

*Shehidët i thonë:*

*“Çfarë mund të duam më shumë! Në xhenet po hamë dhe po shëtisim si të dëshirojmë dhe po bëjmë një jetë shumë të bukur.”* (Muslim, Imaret, 121.)

Çdo njeri që do të hyjë në xhenet, do të bëjë një jetë të kënaqshme. Ndërsa dëshmorët do të duan të kthehen përsëri në këtë botë dhe të bien dëshmorë. Kjo tregohet qartë në këtë hadith fisnik:

*“Çdo njeri që do të hyjë në xhenet, nuk dëshiron të kthehet më në këtë botë. Çdo gjë që gjendet në tokë,*

*gjendet edhe atje. Ndërsa dëshmori, kur të shikojë shkallën e lartë të rënies dëshmor, do të dëshirojë të kthehet dhjetë herë në këtë botë dhe të vritet e të bjerë dëshmorë në secilën herë.”* (Buhari, Xhihad, 21; Muslim, Imaret, 108, 109.)

Grada e dëshmorëve është grada më e lartë pas gradës së profetëve. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë në hadithin fisnik:

*“Dëshmorët ndryshojnë nga pejgamberët vetëm prej gradës së profecisë.”* (Darimi, Xhihad, 20.)

Një njeri që kërkon të bjerë dëshmor me gjithë shpirt, do të jetë dëshmor edhe nëse ndërron jetë në shtratin e tij:

*“Atë, që i kërkon Allahut me nijet të pastër që të bjerë dëshmor, Allahu do ta lartësojë në gradën e dëshmorëve edhe nëse do të vdesë në shtratin e tij.”* (Darimi, Xhihad, 16.)

### KUSH JANË DËSHMORË

1. Ata që konsiderohen dëshmorë të vërtetë, domethënë, që konsiderohen dëshmorë nga dispozitat e kësaj bote dhe ahiretit:

Këta janë myslimanët që vdesin për lartësimin e fesë së Allahut Teala dhe për mbrojtjen e atdheut. Të tillët nuk lahen, nuk qefinosen, u falet namazi i xhenazes dhe varrosen me rrobat e tyre.

2. Ata që konsiderohen dëshmorë nga dispozitat e kësaj bote:

Të tillët janë hipokritët, që vdesin duke luftuar ndërmjet rreshtave të myslimanëve. Edhe këta nuk lahen, nuk qefinosen dhe varrosen me rrobat e tyre duke iu falur namazi i xhenazes si dëshmorët e vërtetë. Ngaqë këta nuk janë myslimanë, nuk mund ta marrin sevapin e të rënit dëshmor në ahiret, sepse grada

e të rënit dëshmor u përket vetëm myslimanëve.

3. Ata që konsiderohen dëshmorë nga dispozitat e ahiretit:

Të tillët janë dëshmorët që lahen dhe qefinosen për shkak se nuk e mbartin njërin prej kushteve të dëshmorëve të vërtetë. Këta janë ata të cilët vdesin në mbrojtje të fesë, jetës, pasurisë dhe nderit të tyre. (Ebu Davud, Sunne, 29; Tirmidhi, Dijat, 21.); ata të cilët vdesin nga sëmundje epidemike, nga dhimbja e barkut, nga mbytja dhe nga shembja e dheut. (Buhari, Xhihad, 30.); ata që vdesin nga djegia, nga shtat-zënia, nga lehonja dhe ata që vriten padrejtësisht. (Nesai, Xhenaiz, 14, 112, Tahrimu'd-Dem, 25.)

### A KA VEPRAT TË TJERA TË BARABARTA ME SEVAPIN E RËNIES DËSHMOR?

Ka disa prej adhurimeve që kanë sevap sa sevapi i atyre që vdesin në rrugë të Allahut Teala. Nëse dikush vdes duke i kryer ato, merr sevapin e dëshmorit. Në hadithin fisnik thuhet:

*“Ai që vjen në xhaminë time duke mos pasur asnjë qëllim tjetër përveçse për të mësuar diçka apo për t’u dhënë mësim të tjerëve, është në gradën e luftëtarit që lufton në rrugë të Allahut. Ndërsa ai që vjen në xhaminë time me ndonjë qëllim tjetër përveç këtij, është në gradën e atij që ruan ndonjë gjë të dikujt.”* (Ibn Maxhe, Mukaddime, 17.) Vlerësimi i sevapit të atij që mëson dije dhe që ua mëson të tjerëve si i sevapit të muxhahidit që lufton, ka lidhje me inkurajimin dhe qëllimin e mirë, sepse në një hadith tjetër thuhet:

*“Qëllimi i besimtarit është më i mirë se vepra e tij.”* (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, IX, 176.)

Përsëri në lidhje me qëllimin, ai që dëshiron të bjerë dëshmor me gjithë zemër, është dëshmor edhe nëse vdes në shtratin e tij:

*“Atij që i kërkon Allahut sinqerisht që të bjerë dëshmor, Allahu ia jep gradën e dëshmorit edhe nëse vdes në shtratin e tij.”* (Muslim, Imare, 157.)

Veçanërisht:

*“Atij që kapet pas sunetit tim në kohën e trazirave të umetit, do t’i jepet sevapi i njëqind dëshmorëve.”* (Ebu Nuajm el-Isfahani, Hiljetu'l-Evljia, VIII, 200.)

Allahu i Lartësuar, përveç mobilizimit të përgjithshëm, nuk e sheh të përshtatshme që të gjithë myslimanët të dalin në luftë:

*“Nuk është mirë që besimtarët të shkojnë në luftë të gjithë njëherësh, por prej çdo bashkësie, një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t’i frikësohet Allahut.”* (Teube, 122)

Kur besimtarët të kenë një ushtri që do të luftojë, ata të cilët nuk janë në ushtri duhet të ushtrojnë profesionet e tyre. Nëse është doktor, duhet të ushtrojë detyrën e mjekut, nëse është mësues, duhet të ushtrojë detyrën e mësuesit, nëse është student,

duhet të studiojë mësimet, nëse është tregtar, duhet të vazhdojë tregtinë dhe nëse është bujk, duhet të merret me bujqësinë. Nëse të gjithë e ushtrojnë profesionin e tyre në formën më të mirë dhe e kanë qëllimin për të arritur kënaqësinë e Allahut Teala duke u shërbyer myslimanëve, do të kenë dobi të mëdha si në këtë botë dhe në botën tjetër për ato që kanë bërë. Individidët e një shoqërie të tillë, gjithmonë janë të lumtur. Për këtë arsye, nuk ka asnjë shkak që kjo shoqëri të mos përparojë. Madje, në lidhje me këtë që thamë më lart, nuk do të ishte gabim nëse shprehem kështu: Nëse një student, i cili studion në çfarëdo shkolle, ka si qëllim të sigurojë të ardhurat e familjes së tij dhe t’i shërbejë atdheut, popullit e fesë së tij, ky student merr sevap adhurimi për sa kohë që të studiojë, ngaqë ka nijetin e mirë. Gjithashtu, nëse vdes në këtë rrugë, merr sevapin e dëshmorit, Inshallah.

### GJËRAT QË U PREMTOHEN DËSHMORËVE

Allahu Teala ka përgatitur mirësitë më të bukura për robërit që luftojnë dhe përpiqen në rrugën për të fituar kënaqësinë e Tij. Gradat e atyre të Allahut i Lartësuar do të jenë bashkë me pejgamberët dhe të sinqertët.

**“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”** (Nisa, 69)

**“Kur të përballeni në luftë me mohuesit, goditini në qafë, derisa t’i rraskapitni e t’i shkatërroni ata dhe pastaj lidhni fort. Mandej ose i lironi me zemërgjerësi, ose me shpërblim, derisa të bëhet armëpushimi. Kështu bëni! Sikur të donte Allahu, do t’i shkatërronte ata, por Ai dëshiron t’ju sprovtojë juve me njëri-tjetrin. Ai nuk ua humb veprat atyre që vdesin në rrugën e Allahut. Ai do t’i udhëzojë ata, do t’ua përmirësojë gjendjen dhe do t’i shpjerë në Xhenet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë.”** (Muhammed, 4-6)

**“Kurrësi mos i quani të vdekur ata që janë vranë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.”** (Al Imran, 169)

**“...Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni një-lloj (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrata e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.”** (Al Imran, 195)

Ajo që kemi për detyrë të bëjmë është përpjekja për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe ta shndërrojmë veten tonë në një njeri ideal, brezin tonë në një brez ideal dhe shoqërinë tonë në një shoqëri ideale. Kjo realizohet vetëm nëse përpiqemi ashtu siç duhet.



# MARRËDHËNIET RELIGJION-SHKENCË NË PROCESIN E ILUMINIZMIT TË SHEKULLIT TË 18-TË

Ahmet Meral

## POHIMET E POZITIVISTËVE

Pozitivistët, të cilët pohojnë se shkenca i ka lëkundur themelet e vlerave fetare, gjithashtu kanë pohuar se zbulimet në astronomi dhe disa zbulime në mjekësi i kanë nxjerrë të pabaza pohimet e teksteve të shenjta dhe se religjioni është mposhtur nga shkenca. Ky pohim nuk është gjë tjetër përveçse një aktivitet propagandistik i një ideologjie të qëllimtë, që disa grupe politike e kanë vënë në funksion në Evropë për të thyer fuqinë e klerikëve, të cilët mund të ngrinin popujt për kryengritje dhe për të marrë në dorë pushtetin.

Për marrjen në qendër të tezës së “kundërshtimit të religjionit me shkencën”, para së gjithash, një rol të madh ka gjikimi i Galileut nga Kisha, në kohën kur

po përjetohej përplasje mes modelit gjeocentrik dhe atij heliocentrik. Ndërsa kur shohim botën islame, është e pamundur të gjendet një ngjarje që i përngjan “Çështjes Galileo”. Shfaqja e Islamit dhe zhvillimi i shkencës në lindje kanë ndodhur paralelisht. Dome thënë, vendimi i gabuar në lidhje me çështjen “Galileo”, aq sa është padrejtësi t’ua mëshosh të gjitha feve, po aq është edhe i pasaktë.

Kepleri, Koperniku dhe Galileo, të cilët ishin astronomë të mëdhenj dhe teoricienë, edhe pse kanë pasur kontradikta në disa çështje me Kishën, nuk kanë shfaqur asnjë kundërshtim në drejtim të Zotit apo të shkrimeve të shenjta. Galileo e ka dërguar vazhën e tij në manastir dhe ka pasur marrëdhënie me Kishën deri në fund të jetës së tij. Kepleri ishte



një i krishterë i singertë dhe qëndroi besnik ndaj vlerave të kishës derisa ndërroi jetë. Njutoni, i cili thoshte: “Zoti njihet nëpërmjet veprave të Tij”, ishte një shkencëtar i lidhur me gjithë zemër ndaj Zotit. Edhe pse Darvini e ka kundërshtuar Kishën në shumë drejtime, tezat e tij në lidhje me biologjinë nuk i mbron me synim për të kundërshtuar tezat fetare. Madje, ai e kundërshtoi me këto fjalë shtjellimin e këtij problemi në këtë atmosferë: “Një njeri mund t’i besojë edhe Zotit, edhe mendimit të evolucionit. Dyshimi në këtë çështje më duket budallallëk me brirë.”<sup>1</sup>

Sipas filozofit dhe matematicienit Rene Dekart, i cili konsiderohet si themeluesi i filozofisë moderne, sikur mendimi për Zotin të mos gjendej qartazi në mendje, nuk do të kishte asnjë rrugë për ta njohur Atë nga aspekti i njeriut. Ndërkohë që Dekart përpiqet të gjejë se nga vjen mendimi për Zotin dhe pasi thotë se ky mendim nuk mund të arrihet nëpërmjet shqisave, se përveç të tjerash, mendja nuk mund ta nxjerrë në pah vetvetiu një koncept të tillë, shprehet se mendimi për Zotin vjen nga natyra e njeriut.

Njeriu nuk e ka arritur këtë mendim me ndjenjat dhe formuar me mendjen e tij. Për këtë arsye, ky mendim ka lindur dhe ka dalë në pah bashkë me njeriun kur ai është krijuar. Andaj, nuk duhet të konsiderohet si diçka e habitshme e vërteta se Zoti ia ka vendosur në mendje njeriut mendimin për Të kur e ka krijuar. Për ta vërtetuar ekzistencën e Zotit duhet të nisemi nga ideja për Zotin, edhe pse ajo është e vendosur në mendjen e njeriut që kur është krijuar.<sup>2</sup>

Krahas qëndrimeve ideologjike dhe inatit të verbër të disa shkencëtarëve natyralistë, sistemi dhe harmonia në botë, e shpie njeriun te Krijuesi i kësaj bote. Andaj, gjithësia në të cilën gjendemi, krahas të gjitha ndryshimeve dhe detajeve, ka një sistem dhe një harmoni.<sup>3</sup>

Një fetar i vetëdijshëm e ka të pamundur t’i neglizhojë ligjet e natyrës dhe shkencën. Edhe pse në histori ka pasur prej atyre që i kanë shpallur luftë shkencës në emër të Zotit, kjo ka buruar nga mosperceptimi i mendimit teistik në lidhje me botën. Për këtë arsye, të gjithë librat e shenjtë, me në krye Kuranin, i cili është libri i shenjtë i Islamit, flasin për sistemin në gjithësi dhe na orientojnë për t’i studiuar ligjet fizike.

Shkurtimisht mund të themi se në pah nuk ka

1. Charles Darwin (Letër drejtuar John Fordyce)

2. Iljas ALTUNER, Universiteti Egdër, Revista “Shkencat Sociale”, Nr: 2, Tetor 2012, fq. 34.

3. Ibn Hejsem (v. 432/1041) Artikulli “Fi keifijeti er-reshad”.

ndonjë shkak të logjikshëm që e bën religjionin dhe shkencën ta luftojnë njëri-tjetrin. Andaj, problemi buron nga paaftësia për t’i caktuar saktë kufijtë e perceptimit të fesë, apo thënë ndryshe, nga paaftësia për të bërë një ndarje të shëndoshë ndërmjet fesë dhe traditave që popujt i mbartin në mënyrë mozaike, ose nga sjellja ideologjike natyraliste që e bën idhull shkencën. Këtë e ka formuluar bukur edhe Enis Doko, i cili është prej shkencëtarëve tanë fizikan dhe filozof: “Nëse e ndani shkencën nga natyralizmi dhe fenë nga tradita, do të vini re se nuk ka asnjë kundërshti ndërmjet religjionit dhe shkencës.”

Por natyralistët, të cilët përpiqen t’i vendosin perceptimet e tyre në lidhje me botën mbi mohimin e botës metafizike, siç nuk pranojnë asnjë të vërtetë përveç eksperimenteve dhe vëzhgimeve, pohojnë se kjo botë dhe ligjet e saj janë formuar nga një rastësi e verbër.

Ndërkohë, si mund të shpjegohet pa një Zot krijues sistemi madhështor qiellor në të cilin zë vend edhe bota jonë? Si mund të sillemi sikur nuk e dëgjojmë zërin hyjnor i cili u thërret zemrave dhe botës sonë të brendshme? Aq sa kemi nevojë për rregullat, të cilat duhet t’i zbatojmë, në mënyrë që të jetojmë, po aq kemi nevojë edhe për t’i kuptuar ligjet e funksionimit të gjithësisë. Andaj, siç e ka shprehur haptazi edhe Njutoni, natyra është libri i dytë i Zotit.

Pohimi i pozitivistëve se rëndësia e fesë është pakësuar për shkak të zbulimeve dhe zhvillimeve në mjekësi, nuk ka asnjë bazë. Në rënien e numrit të vdekjeve të njerëzve duke filluar nga shekulli i 17-të, rol më të madh kanë luajtur shërbimet për mbrojtjen e shëndetit se sa zhvillimet e mrekullueshme në mjekësi. Bashkë me pasurimin e popullsisë, u bënë të parandalueshme edhe sëmundjet si murtaja, tifoja dhe dizenteria, të cilat e mbanin vazhdimisht nën kërcënim botën dhe Evropën perëndimore dhe të cilat shkaktonin vdekje masive. Tharja e batakëve dhe ndërtimi i kanalizimeve e pakësuan numrin e mizave dhe të grerëzave. Pas ardhjes së shekullit të 18-të, këto sëmundje u zhdukën në të gjithë Evropën. Kjo situatë luajti rol në zgjatjen e pjesshme të jetës së njeriut dhe pakësimit të vdekjeve masive. Ndërsa zhvillimet në mjekësi përparuan ngadalë në shekullin e 18-të. Zbulimi i vaksinës së tërbimit nga Lui Pastër (1822-1895), i cili njihej për fetarinë dhe humanizmin e tij dhe përhapja e vaksinës së lisë, ndikoi pozitivisht te banorët e Evropës. Nëpërmjet rrugës që hapi mikrobiologu, kimisti dhe dijetari i madh francez Pastëri, u zhvilluan sistemet e vaksinimit dhe vazhdojnë të zhvillohen.





# TË HUMBASËSH në shqetësimet E KËSAJ BOTE

..... ❧ *Sami Byjkkajnak* ❧ .....

Shqetësime që nuk dinë të mbarojnë...

Në njërën anë, shqetësimi për profesionin, shqetësimi për punën, shqetësimi për të ardhmen, shqetësimi për karrierën, shqetësimi për para, shqetësimi për jetesën...

Në anën tjetër, shqetësimi për Allahun, shqetësimi për ahiretin, shqetësimi për umetin, shqetësimi për varrin, shqetësimi për fëmijët...

Po sot, cilat shqetësime janë në plan të parë, shqetësimet për këtë botë apo shqetësimet për botën tjetër?

Ja, hetimi i kësaj do të na japë përgjigjen se udhëtarë të cilit drejtim jemi ne.

Shqetësimi për profesionin apo për karrierën është prej çështjeve më të rëndësishme të shoqërive në kohët e sotme. Në këtë kohë të gjithë njerëzit po bëhen të dashuruar me profesionin. Kjo po shtohet aq shumë, sa që profesioni të fëmijët po shndërrohet në parim duke filluar që nga kopshti. Pyetja: “Çfarë do të bëhesh kur të rritesh?” - vjen në krye të pyetjeve që e nxisin këtë shqetësim. Kjo pyetje, e cila u bëhet fëmijëve duke filluar që nga kopshti, dashje apo pa dashje, formon një shqetësim për profesionin dhe karrierën të fëmijët. Në të vërtetë, ky është një lloj imponimi i stilit të jetës shekullariste. Jeta shekullariste sjell në rend shqetësimin: “Para së gjithash, duhet të bëhesh posedues i një profesioni dhe karriere. Ndërsa në aspektin material, gjithmonë duhet të mendosh për shkallët më të larta.”



Ndërsa përgjigjet që merren për pyetjen: “Çfarë do të bëhesh kur të rritesh?” - të cilat u bëhen fëmijëve që në fëmijëri, në përgjithësi janë të njëjta:

Mjek, inxhinier, mësues etj.

Përse?

Sepse një profesion i mirë, do të thotë shumë para. Shumë para, do të thotë një jetë e lumtur. Domethënë, në bazë të kësaj çështjeje gjithmonë qëndron ana materiale, pra, dynjaja. Ngaqë brezat edukohen me këtë gjë të imponuar, fillojnë të mbruhën me shqetësime ndaj kësaj bote dhe t’i bëjnë llogaritë e çështjeve materiale që në moshë të vogël.

Edhe edukimi i njerëzve me të vërtetën se edhe arritja e një profesioni ka moralin e saj, po neglizhohet në kohët e sotme. Fëmija që rritet me këtë neglizhencë, e shikon të lejuar çdo rrugë për të fituar sa më shumë, kështu që përpiket sikur po lufton për ta arritur atë profesionin apo karrierën që i është imponuar. Më vonë, kur të mos e arrijë dot karrierën që i është imponuar, ngelet i detyruar të punojë në punë që nuk i do. Dashje apo pa dashje, shqetësimi për para hyn brenda kësaj pune. Si rezultat i kësaj, po shtohen shumë njerëzit që çdo gjë e bëjnë për para, që hyjnë në çdo lloj forme për të siguruar jetesën, që shpenzojnë më shumë se rroga në mënyrë që të arrijë standardet e jetës dhe që e humbasin veten në bataket që i zvarrisin shqetësimet e nxitura që në fëmijëri.

Në një sistem edukimi, në të cilin nuk shtjellohet shqetësimi për besimin, edukohen breza që e poshtërojnë veten për karrierë materiale. Ndërkohë shoqëria duhet të përpiket për të nxjerrë breza që shqetësohen për besimin dhe ahiretin, sepse këto shqetësime janë aq të mëdha, saqë mund ta fusin në binarë interesin material, profesionin dhe karrierën.

Po, myslimani duhet të shqetësohet, por shqetësimi i tij duhet të jetë në drejtimin për t’u bërë një besimtar i devotshëm, një rob i përkushtuar ndaj Zotit (xh.sh.) dhe për të fituar ahiretin. Domethënë, shqetësimet e besimtarit duhet të peshojnë më shumë nga aspekti shpirtëror, sepse, besimi është ai që do t’i shuajë një nga një shqetësimet e myslimanit në aspektin material. Shqetësimi për ta kaluar jetën, e cila është një amanet i Allahut Teala, në formën

që do Zotëruesi i saj dhe për t’ia dorëzuar atë Atij, detyrimisht duhet të jetë mbi të gjitha shqetësimet në lidhje me aspektin material. Në të kundërt, njeriu shndërrohet në një rob të shqetësimeve për këtë botë.

Allahu nuk i thotë besimtarit që së pari “bëhu i pasur, bëj karrierë apo merr një profesion”. Allahu në fillim kërkon nga besimtari që të bëhet rob i devotshëm dhe të mbartë shqetësimin për t’ju nënshtruar Atij në mënyrë absolute. Pas kësaj, te Allahu i Madhëruar nuk ka rëndësi se cilin profesion do të zgjedhësh. Rob mjek, rob inxhinier, rob mësues, rob punëtor etj., sepse çdo status që nuk e ka robin në krye, siç nuk i jep qetësi shpirtërore poseduesit të tij, gjithashtu nuk u jep besim edhe njerëzve që e rrethojnë atë njeri. Ka shumë shembuj që

tregojnë se si u kanë bërë padrejtësi njerëzve shumë posedues karrierash të cilët e kanë harruar nënshtrimin ndaj Allahut të Lartësuar. Ditë pas dite po dëshmojmë se si dhunohen të sëmuret nga mjekët e edukuar duke i dhënë përparësi karrierës dhe pa vetëdijen e nënshtrimit ndaj Zotit (xh.sh.), se si i bëjnë operacion pacientët vetëm për të marrë paratë, se si japin shpirt njerëzit nëpër ndërtesa që janë ndërtuar nga inxhinierë të kapur rob prej interesit material, dhe se si shkojnë dëm brezat në dorën e një mësuesi të privuar nga vetëdija e nënshtrimit ndaj Krijuesit.

Për këtë arsye, të gjithë duhet të përpiqemi për ta luftuar dhe zhdukur imponimin e karrierës që bëhet ndaj fëmijëve në institucionin më të rëndësishëm të edukimit, pra, në familje. Pastaj duhet të rishikohet edhe një herë dhe të rregullohet edukimi me përparësi karrierën në institucionet arsimore. Prindërit në familje duhet t’ua japin fëmijëve shqetësimin për t’u bërë robër të devotshëm ndaj Allahut Teala.

Besimtarit nuk i sheh si shumë të domosdoshme në jetën e tij shqetësimet në aspektin material. Shqetësimi i besimtarit është që të bëhet rob i devotshëm ndaj Allahut të Lartësuar dhe të shkojë me zemër të pastër në ahiret. Shqetësimet e tjera përveç këtij janë shqetësime shekullariste. Ata nuk i japin gjë tjetër njeriut përveçse lakmi dhe tamah.

Thelbi i fjalës: Ti je udhëtar i atij drejtimi për të cilin shqetësohesh.





# Shqetësimet e kësaj bote

## dhe frika ndaj Allahut

— M. Ali Eshmeli —

Lajme të dhimbshme që i dëgjojmë shpeshherë:

- Krim në grindjen ndërmjet borxhlinjve: tre të vdekur.
  - Tragjedi në debatin për kufirin e tokës: pesë të vdekur dhe dhjetë të plagosur.
  - Armët folën në ndarjen e trashëgimisë: dy të vdekur.
- Edhe në çështje të tjera ka situata plotësisht të ndryshme:
- Intriga të mëdha për të arritur fitim të padrejtë.

- Trazirat e ndryshme të futura në jetën e tregtisë.  
- Favorizimet edhe ndaj atyre që nuk janë burra.  
Gjithmonë janë prezente edhe ato që përjetohen ndërmjet popujve:

- Lufta për naftë u rrit. Filan shtet pushtoi filan shtet. Qytetet janë shkatërruar dhe drejtësia e paqja janë prishur.

- Dikush ndërhyri te tjetri për t'i dhënë demokracinë: me miliona të vdekur.

- Shtetet e fuqishme përdorën të drejtën e tyre për ndërmjetësim: popujt edhe më të shkatërruar.

Sepse;

Shqetësimeve të kësaj bote në tregun e njerëzisë u jepet më shumë përparësi. Ndërsa frika ndaj Allahut është hedhur në plan të fundit.

Domethënë;

Njerëzit, të cilët janë udhëtarë të Ahiretit pa asnjë përjashtim, e kanë harruar fundin e asaj rruge dhe janë zhytur në këtë botë. Tashmë njerëzit kanë filluar t'i peshojnë sipas peshoreve të kësaj bote edhe çështjet e botës tjetër. Ndërkohë që formojnë shtëpitë, fëmijët, miqtë dhe veten e tyre, përzgjedhja e gjërave të kësaj bote ka kaluar në plan të parë. Edhe çështjet shpirtërore i kanë kapluar dhe zaptuar shqetësimet për këtë botë.

Kur shikojmë shprehjet që nxjerrin nga goja, shohim se të gjithë e kanë frikë Allahun Teala, por çfarë thonë sjelljet?

Kur i shikojmë ato, për fat të keq, pamjet ndryshojnë.

Peshorja e Ahiretit është e prishur në shumë zemra. Dashuritë provizore i kanë bërë njerëzit ta harrojnë Xhenetin e përhershëm, ta pandehin sikur është një përrallë që s'do të ndodhë dhe të bezdisen kur të flitet për të. Për shkak të kësaj, njerëzit rendin vetëm pas kënaqësisë dhe lumturisë së përkohshme, pas rehatisë së përkohshme, pas argëtimit të përkohshëm, pas qetësisë së përkohshme dhe pas pasurisë së përkohshme.

Kur njeriu ka në dorë një pretekst si nevoja, i gjen lehtë justifikimet më të logjikshme për të gjitha shqetësimet e kësaj bote. Faktikisht, për shkak të këtyre bie nëpër kurthe. Justifikimet e logjikshme e bindin atë për çdo gjë që bën. Edhe një vrasës madje nxjerr në pah shpjegime që ndërgjegjeve pothuajse fillon t'u vijë keq jo për të vrarin, por për vrasësin. U bënë rreth dyqind vjet që bota perëndimore, e cila ka përhapur terrorin në çdo vend duke e shkatërruar dhe përçarë botën islame,

i bën këto gjëra më forma që duket sikur po përhap drejtësinë. Ata të cilët kanë vrarë me miliona muslimanë, flasin me aq profesionalizëm dhe nxjerrin në pah justifikime aq të logjikshme, saqë ata që nuk e dinë të vërtetën kaplohen nga ndjenjat dhe dëshirojnë t'i ndihmojnë menjëherë.

Gjithmonë bëhet fjalë për shqetësimet ndaj kësaj bote!

Kur njerëzit bëhen robër të këtyre shqetësimeve, kjo është pamja tmerruese e kësaj bote dhe kjo është pika në të cilën arrihet.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në një hadith fisnik:

*“Koha kur popujt e huaj do ta thërrasin njëri-tjetrin siç e thërrasin për të ngrënë ushqimin në tavolinë, në mënyrë që t’ju sulmojnë ju, është afër.”*

Njëri prej atyre që gjendeshin aty e pyeti:

“A ngaqë do të jemi të pakët në numër atë ditë?”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj:

*“Jo! Përkundrazi, atë ditë ju do të jeni shumë, por do të jeni si mbeturinat që i merr rrëkeja dhe që s’kanë asnjë vlerë. Allahu do t’ua nxjerrë armiqtë tuaj frikën nga zemra ndaj jush dhe në zemrat tuaja do të hedhë dobësinë!”*

I thanë:

“Çfarë është dobësia, o i Dërguari i Allahut?”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj:

*“Dashuria ndaj kësaj bote dhe urrejtja e vdekjes...”* (Ebu Davud, Melahim, 5, 4297.)

Domethënë, mposhtja prej shqetësimeve të kësaj bote.

Historia është e mbushur plot me rezultatet dëshpëruese të kësaj. Shumë shtete dhe popuj të mëdhenj, u fshinë nga sipërfaqja e tokës për shkak të kësaj. Më së fundi, edhe pse kishte kaq shumë madhështi dhe fuqi, për shkak të robërimit nga shqetësimet për këtë botë, u shkatërrua edhe perandoria e madhe Osmane. Mbi gërmadhat e saj u formuan me dhjetëra shtete të vogla dhe pothuajse u përjetua ky ajet fisnik:

***“Vërtet Allahu e plotësoi premtimin e Vet, kur ju me vullnetin e Tij e thyet armikun. Por, kur ju u frikësuat, u grindët midis jush dhe kundërshtuat*** (Profetin a.s.), ***pasi Ai ju tregoi atë që pëlqenit,*** (Allahu e tërhoqi ndihmën e Vet). ***Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër. Pastaj Ai, për t’ju provuar, bëri që të zmbropseni para armikut dhe pastaj, sigurisht që***



**jua fali atë gabim. Allahu ka mirësi të madhe për besimtarët.”** (Al Imran, 152)

Domethënë se në zemrën që nuk ka frikë ndaj Allahut të Madhëruar hyjnë shqetësimet për këtë botë. Në këtë mënyrë, bëhen një me tokën edhe shoqëritë e forta.

Kjo është kështu për çdo çështje. Madje, edhe në dije.

I Dërguari i Allahut (a.s.), është shprehur shumë qartë:

*“Ai që e mëson vetëm për interesat e kësaj bote një dije me të cilën mund të fitohet pëlqimi i Allahut të Madhëruar, Ditën e Kiametit nuk mund ta ndjejë as aromën e Xhenetit.”* (Ebu Davud, Ilm, 12.)

Ata të cilët e planifikojnë të ardhmen e fëmijëve të tyre duke u shqetësuar për këtë botë dhe duke thënë: “Le të mësojnë e të shkojnë në pozita të larta dhe le të kenë profesione të rehatshme e fitimprurëse!”, nesër nuk do të bëjnë gjë tjetër përveçse të qajnë për shkak të përsëritjes së mësimëve që jep historia.

Andaj, njerëzit duhet ta dinë se çdo brez mund ta arrijë natyrën e tij të vërtetë vetëm duke u edukuar me Kuranin Fisnik.

Kjo e vërtetë i përngjan një qumështi të pastër. Ndërsa shqetësimet ndaj kësaj bote që kanë kaluar në plan të parë, i përngjajnë ujit që hidhet në këtë qumësht. Madje, ato janë si një ujë që s’bën për t’u pirë. Qumështi, i cili e humb pastërtinë me përzjerjen e atij uji, së pari e zhduk frikën ndaj Allahut Teala që gjendet nëpër zemrat e njerëzve. Pastaj shkatërron personalitetin e njerëzve.

Nisur nga ky aspekt, në edukimin e brezave si besimtarë të pastër të Kuranit Fisnik, është kusht që të mos përzihet asgjë në qumështin e pastër. Ndërsa për ta zbatuar këtë kusht, absolutisht është e nevojshme kjo ndjeshmëri që do ta shohim në shembullin e mëposhtëm:

Umeri (r.a.), ecte çdo natë nëpër rrugë duke thënë me vete: “Kalifi së pari është përgjegjës!”

Në këtë mënyrë, kontrollonte çdo gjë dhe shikonte nëse kishte apo jo ndonjë çështje për të cilën duhej të interesohej.

Përsëri ishte një natë në të cilën po ecte me të njëjtin qëllim.

Po kalonte pranë një shtëpie. Edhe pse ishte mesi i natës, dëgjoji disa zëra të lartë që vinin nga brenda. Ai ndaloi për shkak të rëndësisë së çështjes. Një nënë po e qortonte në mënyrë të habitshme vajzën e saj:

-Bijë, a nuk të thashë t’i hidhje pak ujë qumështit që do të shitet?

-Më the nënë...

-Atëherë, përse nuk ia hodhe ujin?

-Nënë, a nuk e di se Umeri e ka ndaluar këtë?

Nëna e pakujdesshme u nxehe shumë:

-O bija ime e pamend! Si do ta shikojë këtë Umeri në mes të natës?

Atëherë vajza, me frikën ndaj Allahut që kishte në zemër, i dha këtë përgjigje të pashoqe:

-Po, është mesi i natës. Ndoshta Umeri nuk na shikon dot, por, o nëna ime, a nuk na shikon Allahu? A edhe Allahu nuk na shikon?

Umerit (r.a.), iu mbushën sytë me lot. Në vetvetë e uroi këtë vajzë të gjorë. Më vonë, këtë zemër të mbushur plot me frikë dhe dashuri ndaj Allahut Teala e martoi me birin e tij. Nga brezi i asaj vatre të pastër, lindi edhe Umer bin Abdulazizi.

Ja, kjo është begatia e hallallit dhe e frikës ndaj Allahut të Lartësuar!

Ky është një rezultat absolut dhe i dobishëm i shqetësimit jo për këtë botë, por për botën tjetër!

Siç e dini, para këtyre brezave që u formuan me edukimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), historia për njerëzit ishte si një arkivol, por bashkë me ata breza, u gjallërua, u zbukurua, u përsos dhe fitoi përshpirtje e gjallërim, sepse ata breza, nuk ia hodhën asnjë prej shqetësimeve të kësaj bote qumështit që u formonte personalitetet dhe arritën të realizonin shprehjen e urtë: “Ai që vjen për të të vrarë, le të gjejë jetë tek ti!” Në këtë mënyrë, u bënë një brez i devotshëm dhe i përsosur që e kishin frikë Allahun e Madhëruar, sepse atë brez e edukoi i Dërguari i Allahut (a.s.). Krenaria

*Ata të cilët e planifikojnë të ardhmen e fëmijëve të tyre duke u shqetësuar për këtë botë dhe duke thënë: “Le të mësojnë e të shkojnë në pozita të larta dhe le të kenë profesione të rehatshme e fitimprurëse!”, nesër nuk do të bëjnë gjë tjetër përveçse të qajnë për shkak të përsëritjes së mësimëve që jep historia.*

e Gjithësisë e ngjalli Mekën dhe Medinën me atë brez. Gjithashtu, me atë brez ngjalli të gjithë gadi-shullin arabik. Me atë brez ngjalli Afrikën, Azinë, Andaluzinë, Anadollin dhe Ballkanin.

Ata breza besimtarësh ishin përfaqësuesit e vërtetë të Islamit. Ata breza ishin heronjtë që vraponin nga një fitore në tjetrën duke i hedhur në plan të fundit shqetësimet e kësaj bote kundrejt shqetësimeve ndaj botës tjetër. Ata u bënë breza që fituan lavdërimin e Allahut Teala:

“(O besimtarë që keni fituar personalitet me frikën ndaj Allahut! Djeni se armiqtë) **në zemrat e tyre kanë më shumë frikë nga ju sesa nga Allahu, ngaqë ata janë popull që nuk kuptojnë.**” (Hashr, 13)

Ata zbatuan ajetin:

**“Ata të cilët kumtuan shpalljet e Allahut, i frikësoheshin Atij e askujt tjetër përveç Tij. Allahu mjafton si llogaritës.”** (Ahzab, 39)

Ata e përvetësuan moralin profetik me një dashuri dhe besnikëri të madhe aq sa arritën të fitonin vlerësimin e Allahut, i Cili thotë:

**“I Dërguari është më i afërt për besimtarët...”** (Ahzab, 6)

Ata e mbajtën gjithmonë respektin. Për këtë arsye, u respektuan në të gjithë botën. Korrën fitore të mëdha. Urdhurat që i dërgonin nga vendi në të cilin gjendeshin, ishin ligje për qafirët. Andaj, moda e vallëzimit që doli në Francë dhe e cila u ndalua me një urdhër të Sulltan Sulejman Kanunit, nuk u shfaq më për njëqind vjet. Për këtë arsye, kjo ndalesë është shumë kuptimplote.

Ndërsa tashmë po ndodh e kundërta, sepse armiku i ka hedhur ujë atij qumështi. Pastaj, atë qumësht ua ka dhënë fëmijëve të brezave besimtarë për ta pirë. Shqetësimet për këtë botë hynë në funksion. Madhështia që kishin myslimanët u dobësua. Respekti filloi të binte. Më së fundi, paturpësitë dhe ligësitë gjetën vend për vete.

Pastaj filluan të bëhen poshtërsi që përfshinin ofendime ndaj të Dërguarit të Allahut, Muhamed Mustafasë (a.s.), i cili është njeriu më i bukur, më i pastër, më i bekuar, më i mëshirshëm dhe më i vlefshëm në sipërfaqen e tokës. Urrejtjes dhe sulmit të paturpshëm i vendosën emrin “liria e shtypit”. U përgatitën lojëra për ta përmendur Islamit bashkë me fjalën terror. Barbaria e papranueshme e atyre që u përgjigjën me të njëjtën injorancë ndaj injorancës së atyre, u vendos në skenar dhe Islami u bë objektiv i tyre. I Dërguari i Allahut (a.s.), u bë objektiv i tyre për ta sulmuar.

Të gjeshe një shofer të keq është e lehtë. A civilizimi është që ta kërkosh fajin te makina dhe timoni i saj nëse merr një shofer të tillë?

Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë se në urdhrat e Islamit nuk ka asgjë që e mbështet terrorin. Islami urdhëron mëshirë edhe për armiqtë, urdhëron drejtësi dhe urdhëron të ndalohet disfatizmi. Disa mund të nxjerrin tipa që nuk e dëgjojnë këtë, por këta tipa nuk i përkasin Islamit. Ata u përkasin vetëm atyre që i kanë nxjerrë. Historia islame është e mbushur plot me shembujt më të bukur dhe më të shkëlqyer të qytetërimit të virtyteve. Ata që përpiqen t’i hedhin baltë Islamit ngaqë myslimanët sot janë të pafuqishëm, le t’u hedhin një sy dhe t’i shikojnë librat dhe historitë e tyre.

Andaj, e gjithë çështja është që të vijmë në vete me dashurinë dhe moralin e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe të mos i reflektojmë sjelljet e papëlqyeshme të tipave që nuk e respektojnë atë. Pra, të marrim pjesë nga morali i Pejgamberit, i cili e ngjallte atë që shkonte për ta vrarë, të shfaqim aq shumë mirësi, saqë të mos ketë vend për gjëra të këqija dhe të reflektojmë moralin e lartë që do ta heshtë vetvetiu gabimin, duke përdorur formulën që Allahu i Lartësuar ia dha Pejgamberit (a.s.):

**“Mos u dëshpëro nga fjala e tyre. E gjithë fuqia i përket Allahut! Ai dëgjon dhe di çdo gjë.”** (Junus, 65)

Përfundimisht, ne duhet të veprojmë duke iu frikësuar vetëm Allahut Teala në çdo lloj situatë, sepse, të Dërguarin e Allahut, alejhi’s-selam, e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Cilët janë njerëzit më të mirë dhe më të ndershëm?”

Pejgamberi u përgjigj:

**“Ata që kanë më shumë frikë nga Allahu.”** (Buhari, Enbija, 8.)

Lum për ata që arrijnë mëngjesin e shpëtimit në këtë botë dhe në botën tjetër me anë të frikës ndaj Allahut të Lartësuar dhe që nuk bëhen prej atyre që mbyten në gabime të panumërta për shkak të robërimit prej shqetësimeve ndaj kësaj bote!

Lum për ata që mund të edukojnë një brez të pastër dhe praktikues të Kuranit brenda rregullave që i Dërguari i Allahut (a.s.), ka vënë për këtë çështje!

Lum për besimtarët që nuk i hedhin ujë apo ndonjë gjë tjetër këtij edukimi të personalitetit të pastër si qumështi!

Lum për ata që e fitojnë sprovën e dashurisë ndaj Atij!





## Vlera e Natës së Kadrit

Allahu (xh.sh.) thotë në Kuranin fisnik: **“Ne e zbritën atë (Kuranin) në natën e Kadrit. E ç’të mësoi ty se ç’është nata e Kadrit. Ajo është më e vlefshme se njëmijë muaj. Atë natë zbresin meleket dhe Xhebraili me lejen e Zotit, për të zgjidhur çdo punë. Ajo është paqe deri në daljen e agimit”** (Kadr, 1-5)

Falënderoj Zotin që na bëri krijesat më të larta, na bëri njerëz që ecin me dy këmbë dhe e shikojnë botën nga lart dhe nuk na bëri kafshë që ecin me katër këmbë dhe e shikojnë botën nga poshtë. Allahu (xh.sh.) na dha mendjen dhe nënshtroi gjithë ç’ka në qiej e në tokë për ne, ndërsa ne nuk na bëri të nënshtruar ndaj dikujt tjetër, por vetëm ndaj madhësisë së Tij.

A nuk meriton të falënderohet Allahu (xh.sh.)? Kush e di, ndoshta edhe ne mund të ishim pjesë e bashkësisë së kafshëve apo e pemëve, sepse të gjitha janë krijesa të Allahut (xh.sh.). Por Allahu (xh.sh.) caktoi për ne, që të jemi njerëz, krijesat më të larta të Zotit. A nuk duhet falënderuar ky Zot, i Cili na dalloi ne nga miliarda njerëz, që të jemi ndjekës të njeriut më të lartë, Profetit (a.s.)!? A nuk duhet ta falënderojmë Zotin, që na nxori nga errësira në dritë?! Çdo njeri me zemër të pastër duhet ta falënderojë Allahun (xh.sh.) për këtë mirësi kaq të madhe.

E dimë fare mirë, se ka shumë njerëz me mendje më të fortë se ne, me pozita më të larta se ne, me mundësi ekonomike më të mëdha se ne, por Zoti i gjithësisë nuk ua ka zgjeruar zemrën, nuk ua ka ndriçuar dritën e mendjes, por i ka lënë në errësirë, sepse ata vetë kanë pëlqyer errësirën.

Bëji një llogari vetes tënde. Çfarë shpenzimesh ke bërë për të ardhur këtu ku je? Erdhëm ndoshta pa ditur ku po shkojmë, ndoshta pa u menduar gjatë,

por ishte mëshira e Allahut (xh.sh.), që na nxori nga errësirat në dritë. Mjafton njeriu të kujtojë vetëm një ditë nga koha kur nuk e njihte Zotin dhe do ta kuptojë se çfarë njeriu ka qenë. Falënderojmë Allahun (xh.sh.) që me mëshirën e tij na bëri njerëz, na bëri ndjekës te profetit Muhamed (a.s.).

A nuk falënderohet Zoti, që na dalloi nga shumë myslimanë dhe na mundësoi ta arrijmë e ta agjërojmë muajin e Ramazanit, sepse ka pasur shumë myslimanë, të cilët e kanë lutur Allahun, që ta arrijnë Ramazanin, por Allahu (xh.sh.) u ka caktuar që të mos e agjërojnë këtë muaj.

Para disa ditësh pyesnim njëri - tjetrin se kur fillon Ramazani.. Kurse tani pyesim njëri - tjetrin se kur është fundi i Ramazanit, kur është dita e Bajramit.

Subhanallah! Në fillim kishim shqetësim, nëse do të kishim mundësi të rrinim pa ngrënë, nëse mund të çoheshim për syfy, që të mos kishim uri gjatë ditës, ndërsa sot agjërimi është bërë pjesë e zemrave tona, pjesë e jetës sonë, është bërë shoku më i mirë, miku më i afërt dhe nuk e di se si do të ndihen zemrat tona, kur të largohet ky muaj.

Ramazani është një muaj, por jeta përbëhet nga vite e vitet përbëhen nga muajt. Kjo është jeta e njeriut. Një ditë ke lindur dhe patjetër një ditë do të lajmërohen njerëzit për vdekjen tënde. Jeta, si çdo gjë në këtë botë, ka një fillim dhe një fund.

Po të shikosh në fenë islame, do vëshesh se pjesa e fundit e çdo pune është më e rëndësishmja.

Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: **“Pjesa e tretë e natës është pjesë më e rëndësishme. Është pjesë kur Allahu (xh.sh.) zbret në qiellin e dynjasë, ashtu siç i takon madhësisë së Tij dhe thotë: “A ka njerëz që kanë halle, t’ua zgjidh Unë hallet? Kush kërkon prej Meje që t’i jap, kush me lutet, t’i**



**përgjigjem. Kush më kërkon falje që ta fal, kush kërkon mbrojtje, që Unë ta mbroj**". Të rrallë janë ata njerëz, të cilët ngrihen në pjesën e tretë të natës, marrin abdest dhe pasi falin dy rekate, i drejtohen Zotit me lutje, sepse kanë halle të mëdha, por e dinë që ka një Zot, që sidomos në këtë pjesë të natës, pret vetëm që duart e besimtarëve të ngrihen drejt Tij dhe Ai t'ua plotësojë lutjen.

Profeti (a.s.) ka thënë: **"Mosha e popullit tim është rreth 60 vjet"**. Duke u nisur nga kjo thënie e profetit (a.s.), ju tërheq vëmendjen që të jeni të kujdesshëm. Sidomos ata që kanë mbushur 40 vjeç, ta dinë se i janë afruar kohës së fundit, kohës së tretë të jetës së tyre. Ata nuk mund të jenë si përpara. Ata janë burra tashmë dhe presin në çdo moment t'iu vijë Azraili (a.s.), meleku i vdekjes dhe duhet të përgatiten për të.

Po kështu ndodh edhe me muajin e Ramazanit. Dhjetë ditshi i fundit tregon, se këtij muaji po i afron fundi. Për këtë dhjetë ditësh profeti (a.s.) ka thënë: **"Dhjetë ditshi i fundit nuk është një-lloj as si pjesa e parë as si pjesa e dytë e muajit. Janë ditët e fundit, ditët kur duhen përqendruar të gjitha forcat, kur duhet dhënë maksimumi"**. Inshallah do të jenë këto ditë dëshmitarë për ne dhe jo kundra nesh.

Sot të gjithë myslimanët flasin për dhjetë ditshin e fundit të muajit të Ramazanit, sepse me të vërtetë janë ditë të veçanta, ditë që do të dëshmojnë për ata njerëz që kanë agjëruar, që janë falur, që kanë dhënë sadaka. Do të dëshmojnë se e respektuan muajin e Ramazanit dhe Zoti i gjithësisë do të shpërndajë dhuratat e tij në fund të këtij muaji.

Në këtë dhjetë ditësh gjendet nata e madhe e Kadrit. Ajo natë i jep vlerë dhjetë ditëve të fundit. Përthimi nga arabishtja është *Nata e Vlerave*. Një

natë më e mirë se 1000 muaj.

Subhanallah! Njëmuaj muaj janë 83 vjet dhe kush rastis në këtë natë, falet për Zotin dhe i lutet atij me sinqeritet, llogaritet tek Zoti sikur ka adhuruar Allahun (xh.sh.) 83 vjet me radhë. 83 vjet është si një jetë tjetër. Është sikur njeriu të jetojë dy jetë brenda një jete. Kjo është mëshira dhe begatia e Allahut (xh.sh.).

Ata njerëz që merren me tregti dhe e dinë se c'është fitimi, shfrytëzojnë momentet kur del malli me çmim të lirë dhe blejnë sa më shumë. Allahu (xh.sh.) na e dha Natën e Kadrit, që të marrim sa më shumë shpërblime prej Tij. Për një natë, iu jep njerëzve një shpërblim prej 83 vitesh, ose më mirë shpërblimin e një jete tjetër brenda jetës së tyre.

Në jetët tona shpesh bëjmë gabime, në adhurimet tona bëjmë edhe lëshime, kemi dhe neglizhenca. Por sevapi i kësaj nate të jepet i plotë, sikur ke jetuar 83 vjet pa bërë asnjë gabim.

Profeti (a.s.) e luste Allahun (xh.sh.) që t'i jepte mundësinë ta kapte Natën e Kadrit dhe i nxiste shokët e tij, gratë dhe fëmijët të luteshin, që Allahu (xh.sh.) t'ua pranojë adhurimet në Natën e Kadrit.

Në këtë Natë zbresin melekët e Allahut (xh.sh.). Ata kërkojnë falje për mua dhe për ty. Kur ti lexon Kuran, ata lexojnë Kuran pranë teje. Kur ti falesh, ata falen pranë teje. Kur ti lut Allahun për mëshirë dhe për falje, ata thonë: "O Zot fale robin Tënd". Melekët nuk zbresin nga një apo nga dy, por zbresin me turma të mëdha nga qielli. Nuk imagjinohet dot numri i melekëve të Allahut (xh.sh.), sepse Profeti (a.s.) ka thënë: **"Kur shkova në qiej, pashe që nuk kishte asnjë pëllëmbë vendi bosh, por në çdo pëllëmbë vend kishte një melek, që i lutej Allahut (xh.sh.)"**.

Këta melekë zbresin për të kërkuar falje për



besimtarët, për ata besimtarë që e duan faljen e Allahut (xh.sh.).

Në këtë Natë caktohet rrisku i njeriut. Përse nuk e lut Zotin, të ta shtojë rriskun, të ta shtojë edhe pak jetën, që të bësh edhe disa punë të mira! Lutju Allahut (xh.sh.) në këtë Natë, se inshallah duaja jote do të pranohet. Kjo Natë është falje, është qetësi dhe paqe prej Zotit të gjithësisë. I qetë me Allahun (xh.sh.), paqe me melekët e Allahut (xh.sh.). Ka paqe edhe me shejtanin e mallkuar, sepse ai nuk ka fuqi të veprojë në këtë Natë.

Njerëzit, edhe ata që s'kanë agjëruar, të pyesin se kur është Nata e Kadrit. Pse muslimanët nuk e caktojnë një herë e mirë Natën e Kadrit? Njerëzit duan ta festojnë këtë Natë. Ndoshta njerëzit nuk falen e nuk luten, por të paktën bëjnë një pjatë me hallvë, që shtëpisë t'i vijë era festë. Edhe kjo është pjesë e festimit të kësaj Nate, por kurrësi nuk është ky qëllimi i saj. Qëllimi është të festojnë zemrat e njerëzve. Të qajnë për gjynahet që kanë bërë dhe të festojë e të gëzohen për shpërblimin që marrin nga Allahu (xh.sh.), shpërblim pa llogari. Qëllimi final është të kënaqim Zotin e të fitojmë Xhenetin e Tij, me mëshirën e Tij. Vërtet që ia vlen të gëzohesh e të festosh për këtë gjë. E lus Allahun (xh.sh.) që mëshira e Tij të na udhëzojë për ta gjetur Natën e Kadrit.

Zoti më mëshirën dhe urtësinë e Tij e ka fshehur këtë Natë. Ne nuk e dimë me saktësi se kur është kjo Natë. Profeti (a.s.) ka thënë: **“Allahu (xh.sh.) ma tregoi kur është Nata e Kadrit. Kur po dilja t'ju tregoja, erdhën dy njerëz duke u zënë me njëri - tjetrin dhe e harrova natën e Kadrit. Kërkojeni atë në dhjetë ditshin e fundit të muajit Ramazan, në netët teke”**.

Profeti (a.s.) po dilte t'u tregonte besimtarëve se si të fitonin natën e Kadrit. Subhanallah, u bë shkak grindja e dy personave, që Profeti (a.s.) ta harronte natën e Kadrit. Por edhe kjo ishte prej urtësisë së Allahut (xh.sh.). Imagjino se çfarë bëjnë konfliktet mes myslimanëve, sa e sa bereqet largohet nga shtëpitë dhe zemrat tona prej përçarjes.

Lus Allahun (xh.sh.) të na bëjë prej atyre njerëzve, që e arrijnë Natën e Kadrit, Natën më të madhe, Natën më të lartë, duke agjëruar ditën e duke bërë ibadet (adhurim) natën. Ai njeri që e kalon këtë natë duke adhuruar Zotin, duke kërkuar falje prej Tij me durim e me shpresë, ai është njeri që Zoti e do shumë.

Profeti (a.s.), ai njeri që falej çdo natë, falej aq shumë saqë i ënjteshin këmbët, ai e njihte Zotin e

gjithësisë. Ai dhe familja e tij ishin ndryshe dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Tregon Aishja (r.a.): “Kur vinin dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, Profeti (a.s.) i përvishej adhurimit. E zgjonte familjen e tij ta gdhinte këtë natë me adhurim. Ai bënte maksimumin që mund të bëjë një mysliman”. N.q.s e kemi Profetin (a.s.) si shembull, le të shtojmë edhe ne diçka në punët tona, qoftë kjo lexim Kurani, namaz nate, sadaka etj.

Aishja (r.a.) e pyeti profetin (a.s.): “Sikur ta rastis Natën e Kadrit, çfarë më këshillon që të them?”

Profeti (a.s.) tha: *“Thuaj sa më shpesh: O Zot Ti je Falës i madh, Ti je Bujar, Ti e do shumë faljen, prandaj më fal mua”*. Lutuni për falje për vetët tuaja, për prindërit tuaj, për bashkëshortet dhe fëmijët tuaj, lutuni për gjithë myslimanët, për ata që vuajnë çdo ditë. Nuk ka koprraci më të madhe, sesa të mos i lutesh Allahut (xh.sh.). Po t'i lutesh dikujt, ai mërzitet, ndërsa Allahu (xh.sh.) mërzitet kur nuk i lutesh Atij.

Ju kujtoj për një obligim tjetër, që është në fund të Ramazanit, i cili nuk duhet harruar. Po flas për **sadakanë e fitrit**. Është një obligim material, simbolik, por shumë i lartë tek Allahu (xh.sh.). Është pastrim për agjëruesin, është ushqim për fukaranë. Unë nuk do të ndalem tek vlera e tij se sa duhet të jetë, por them që kur ta nxjerrim sadakanë, ta bëjmë me sinqeritet. Shpresojmë që Zoti t'i falë gabimet tona nëpërmjet kësaj shume simbolike. Obligimi i sadakatul - fitrit është në dhjetë ditshin e fundit të Ramazanit, por preferohet të jepet pas natës së Kadrit. Sidoqoftë ajo duhet të jepet patjetër para namazit të Bajramit. Pas namazit të Bajramit nuk konsiderohet si sadaka e fitrit por thjesht si sadaka.

E lus Zotin t'i ketë pranuar punët tona që kemi bërë në Ramazan dhe ato që do t'i bëjmë këto dhjetë ditë me ndihmën e Allahut (xh.sh.)! Lus Zotin e gjithësisë që ta arrijmë natën e Kadrit! Lus Allahun (xh.sh.) të na ketë falur gjatë këtyre ditëve, por sidomos të na falë në këta dhjetë ditë të fundit të Ramazanit! Lus Zotin ta ketë pranuar prej nesh agjërimit, namazin, lutjet, sadakanë dhe çdo punë të mirë që kemi bërë! Lus Zotin t'i pastrojë zemrat tona nga hipokrizia, gjuhët tona nga gënjeshtria, sytë tanë nga mashtrimi! Lus Zotin të na mëshirojë neve dhe të gjithë ata që e duan mëshirën e Allahut (xh.sh.)! E lus Allahun (xh.sh.) të na forcojë me fenë e Tij! Zoti e forcoftë Islamit në zemrat tona, në shtëpitë tona, në tokat e myslimanëve dhe në mbarë botën!

# MIRËSITË E AGJËRIMIT DHE URISË

M. Sami Ramazanollu

Dijetarët kanë thënë:

Agjërimi dhe uria kanë dhjetë cilësi të mira:

1- Uria të kënaq zemrën, të nënshton shpirtin ndaj Allahut dhe të mpreh sytë. Ndërsa ngopja, të trash mendjen, të jep dembeli dhe të verbon intuitën. Ajo e shton avullin në gjak dhe për këtë arsye në zemër shfaqet një rëndesë. Në këtë mënyrë, njeriu nuk i pranon dhe nuk u përshtatet mendimeve që thuhën dhe nuk mund ta kuptojë urtësinë e tyre.

2- Uria të zbut zemrën. Ndërsa kënaqësia e zemrës e përgatit njeriun të perceptojë ëmbëlsinë e lutjes dhe ndikimin e dhikrit dhe adhurimeve të tjera.

3- Uria e nënshton zemrën që ajo të mos lavdërohet. Në një hadith kudsî, Allahu i Madhëruar, thotë: *“Unë jam bashkë me ata që u thyhet zemra për të më kënaqur Mua”*. Në të njëjtë kohë, uria eliminon edhe ndjenjat e vetëlavdërimit dhe mburrjes, të cilat janë fillimi i rehatisë së panevojshme e devijimit dhe të cilat bëhen shkak i privimeve prej mirësive të shumta. Kjo, sepse egoja nuk thyhet me asgjë tjetër më tepër se me anë të urisë.

4- Kur është i uritur, njeriu nuk i harron fatkeqësitë dhe, po ashtu, nuk i harron as ata që kanë pësuar dëme dhe fatkeqësi. I ngopuri i harron të uriturit. Ndërsa të uriturit, e njohin dhimbjen e të uriturve dhe fatkeqëve. Ata nuk i harrojnë të vuajturit, të varfrit dhe të dobëtit.

5- Uria thyen të gjitha dëshirat e kësaj bote dhe bën presion të vazhdueshëm mbi egon (nefsin emmare), që urdhëron gjithmonë për keq.

6- Uria heq gjumin e tepërt, që i jep njeriut dembeli dhe trulllosje. Ndërsa kush ha shumë, pi shumë. E, kush pi shumë, fle shumë. Dhe, atij që fle shumë i shtohet shkujdesja dhe indiferenca. Kujt i shtohet indiferenca pëson humbje dhe bëhet pishman. Për këtë arsye, të vjetrit kanë thënë: *“Mos hani shumë, mos pini shumë, sepse flini shumë dhe pësoni humbje.”*

7- Kur njeriu nuk është i ngopur, e ka më të lehtë të kryejë adhurime, ndërsa kur është i tejnngopur, e

ka më të vështirë t'i vazhdojë adhurimet.

8- Kur janë të uritur, trupi dhe organet e tij janë më të shëndetshëm dhe më larg sëmundjeve. Kjo, sepse në shumicën e rasteve, shkaku i sëmundjeve është ngrënia, pirja, fjetja dhe gjaku i tepërt. Sëmundjet bëhen pengesë për adhurimet, shqetësojnë zemrën dhe thyejnë dëshirën për adhurim.

9- Ai që nuk ha shumë, bën një jetë të thjeshtë dhe pa vështirësi. Kush kënaqet me pak ushqim, kënaqet edhe me pak pasuri. Për këtë arsye, Resulullahu (a.s.), ka thënë: *“Kush kursen, nuk bie në varfëri.”* Pra, kush mban rrugën e mesme në jetën e vet, nuk bëhet i varfër.

10- Kur je i uritur, sadakanë e jep me gjithë shpirt. Ushqimin e tepërt ua ndan jetimëve dhe të varfërve. Ndërsa në Ditën e Kiametit, rri nën hijen e sadakasë. (shih. Rijadu's-Salihin, 309.)

Muhamed bin el Harisi (r.a.), thotë: *“I kam pyetur pesë grupe për pesë gjëra dhe të gjithë më kanë dhënë të njëjtën përgjigje”:*

1- Mjekët i pyeta për ilaçin më të mirë. Ata më thanë: *“Uria dhe ushqimi i paktë”*.

2- Të urtët i pyeta për atë që e ndihmon më shumë robin në adhurimin e Allahut. Ata më thanë: *“Uria dhe ushqimi i paktë”*.

3- Asketët i pyeta për atë që u jep më shumë forcë asketëve. Ata më thanë: *“Uria dhe ushqimi i paktë”*.

4- Dijetarët i pyeta për atë që i ndihmon më shumë në mësimin përmendsh të diturisë. Ata më thanë: *“Uria dhe ushqimi i paktë”*.

5- Sunduesit i pyeta për të gjetur zgjidhjen e të qenit gjithmonë të vëmendshëm dhe se cili është ushqimi më i mirë: Ata më thanë: *“Uria dhe ushqimi i paktë”*.

Ndërsa Jahja bin Muadhi (r.a.), thotë: *“Nëse uria do të ishte diçka që shitej në pazar, atij që dëshiron botën tjetër, nuk do t'i duhej të blinte asgjë tjetër përveç saj.”*



## REZISTENCA NDAJ ANTIBIOTIKËVE

Që kur u zbulua penicilina në vitin 1928, antibiotikët janë përdorur kundër shumë lloje infeksionesh. Por tani mjekët po zbulojnë se gjithnjë e më shumë baktere janë rezistente edhe ndaj antibiotikëve më të fuqishëm. Praktika mjekësore do të ndryshojë rrënjësisht nëse nuk bëhen ndryshime në përdorimin e antibiotikëve në spitale dhe nga mjekët privatë.

Në vitin 2015, Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëroi se po shkojmë drejt një "periudhe post-antibiotike" kur më shumë njerëz do të vdesin për shkak të infeksioneve të zakonshme.

Vetëm në Indi, llogaritet të kenë vdekur 58 mijë foshnja vetëm në një vit, për shkak të një infeksioni rezistent ndaj antibiotikëve.

Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve vlerëson se 23 mijë vetë vdiqën në Shtetet e Bashkuara në vitin 2014 për shkak të rezistencës ndaj ilaçeve.

"Për një kohë të gjatë, ka pasur disa lloj antibiotikësh rezervë në çdo kohë, kështu që sa herë që humbim aftësinë për të përdorur njërin, fillonim të përdornim tjetrin. Për fat të keq tani, numri i antibiotikëve rezervë është zero".

Bakteriet shndërrohen vazhdimisht, kështu që ato që i rezistojnë ilaçeve që duhet t'i luftojnë, riprodhohen. Kjo është diçka normale dhe antibiotikët vetë nuk shkaktojnë rezistencë por përdorimi i gabuar i tyre, është një nga faktorët kryesorë për zhvillimin e mikrobeve rezistente ndaj antibiotikëve.

Ajo që e rëndon më shumë situatën, është fakti që shumë njerëz nuk e kuptojnë se antibiotikët janë efektivë vetëm kundër infeksioneve bakteriale, jo për viruse si gripi ose i ftohti.

Për ta zgjidhur këtë krizë, shkencëtarët po punojnë për zhvillimin e ilaçeve të reja. Por më e rëndësishme është të ruhen ato që janë.

Sipas një studimi të Qendrës për Kontrollin e Sëmundjeve, Spitalet amerikane po japin ilaçe më të forta dhe më të shumta se ç'është e nevojshme. Agjencia u ka kërkuar mjekëve në spital të jenë më të kujdesshëm kur japin recetat për antibiotikët. Qendra po shqyrton gjithashtu edhe shkaqet e infeksioneve.

"Rezistenca ndaj antibiotikëve po shkaktohet jo vetëm se po përdoren shumë antibiotikë por edhe nga përhapja e shumë infeksioneve, mungesa e higjienës, kontakti aksidental me sipërfaqe të ndotura, prandaj kontrolli për infeksionet është i rëndësishëm".

Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve këshillon që antibiotikët të përdoren sipas recetës dhe të merren deri në fund, edhe nëse ndjehesh më mirë. Megjithatë, duhen marrë masa urgjente në nivel global për të parandaluar katastrofën që mund të shkaktojë një periudhë post-antibiotike.

## DOBITË E AGJËRIMIT

Shumë njerëz e konsiderojnë agjërimin thjesht si një rit fetar por agjërimi krahas dobive të shumta shpirtërore ka edhe dobi të shumta shëndetësore. Agjërimi ndihmon në eliminimin e toksinave nga trupi, redukton sheqerin dhe yndyrën në gjak. Krijon shprehi të të ushqyerit të shëndetshëm dhe rritë imunitetin. Më poshtë por radhisim 10 dobitë më të mëdha që mund të përfitojmë nga agjërimi.

### 1. AGJËRIMI RRIËTË DETOKSIFIKIMIN

Ushqimet e përpunuara përmbajnë shumë aditiv. Këta aditivë bëhen toksina në trup. Disa nga to nxisin prodhimin e produkteve të avancuara përfundimtare të sheqerosura. Shumica e këtyre toksinave depozitohen në yndyra. Yndyra digjet gjatë agjërimit, veçanërisht kur prolongohet. Dhe toksinat pra lirohen. Mëlçia, veshkat si dhe organet e tjera janë të përfshira nga detoksifikimi.

### 2. AGJËRIMI PUSHON SISTEMIN E TRETJES

Gjatë agjërimit, organet digjестive pushojnë. Funkzioni normal fiziologjik vazhdon sidomos në prodhimin e sekrecioneve digjестive, por në shkallë të reduktuar. Kjo ndihmon në mbajtjen e balancit të lëngjeve në trup. Zbërthimi i ushqimit bëhet me ritme të qëndrueshme. Lirimi i energjisë po ashtu ndjek një model gradual.

### 3. AGJËRIMI ZGJIDH PROBLEMET INFLAMATORE

Disa studime tregojnë që agjërimi nxit shërimin e sëmundjeve inflamatore dhe alergjive. Shembuj të këtyre sëmundjeve inflamatore janë artriti reumatoid, artriti dhe sëmundjet e lëkurës si psoriasis. Disa ekspert pohojnë që agjërimi mund të nxisë shërimin e sëmundjeve inflamatore të zorrëve siç është koliti ulceroz.

### 4. AGJËRIMI ULË SHEQERIN NË GJAK

Agjërimi rritë zbërthimin e glukozës në mënyrë që trupi të marrë energji. Redukton prodhimin e insulinës. Kjo e pushon pankreasin. Glukagoni prodhohet për të mbështetur zbërthimin e glukozës. Rezultati i agjërimit është reduktimi i sheqerit në gjak.

### 5. AGJËRIMI RRIËTË ZBËRTHIMIN E YNDYRËS

Përgjigjja e parë e trupit ndaj agjërimit është zbërthimi i glukozës. Kur depoja e glukozës është

e lodhur, fillon ajo që quhet ketosis. Ky është zbërthimi i yndyrave për të liruar energji. Yndyrat e depozituara në veshka dhe muskuj zbërthehen për të liruar energji.

### 6. AGJËRIMI PËRMIRËSON SHTYPJEN E LARTË TË GJAKUT

Agjërimi është një nga metodat pa ilaçe për të reduktuar shtypjen e gjakut. Ndihmon në uljen e rrezikut të arterosklerozës. Arteroskleroza është bllokimi i arterieve nga pjesët e yndyrës. Gjatë agjërimit, glukozja dhe më vonë edhe depozitat e yndyrës përdoren për të prodhuar energji. Shkalla e metabolizmit ulet gjatë agjërimit. Hormonet si adrenalina dhe noradrenalina gjithashtu zvogëlohen. Kjo e mban metabolizmin të qëndrueshëm dhe brenda limiteve. Dobia e kësaj është ulja e presionit të gjakut.

### 7. AGJËRIMI NXITË HUMBJEN E PESHËS

Agjërimi nxit humbjen e shpejtë të peshës. Redukton sasinë e deponuara të yndyrës në trup. Reduktimi i yndyrës dhe konsumimit të sheqerit, dhe rritja e konsumimit të frutave janë masa më të mira për të arritur uljen e peshës.

### 8. AGJËRIMI NXIT DIETË TË SHËNDETSHME

Është vërejtur se agjërimi ulë dëshirën për ushqime të përpunuara. E nxitë dëshirën për ushqime natyrale sidomos ujin dhe frutat. Kjo është një mënyrë se si agjërimi nxitë një stil jete të shëndetshme.


### 9. AGJËRIMI RRIËTË IMUNITETIN

Kur një individ është në dietë të balancuar në mes të dy agjëremeve, kjo mund të rrisë imunitetin. Eliminimi i toksinave dhe reduktimi i depozitave të yndyrës gjithashtu ndihmojnë trupin. Kur një njeri përdor fruta për ta prishur agjërimin, ato rrisin sasinë e vitaminave dhe mineraleve esenciale në trup. Vitaminat A dhe E janë antioksidant të mirë që janë prezent në fruta. Ato ndihmojnë në rritjen e imunitetit.

### 10. AGJËRIMI MUND TË NDIHMOJË NË TEJKALIMIN E VARËSIVE

Disa autorë kanë vërtetuar se agjërimi mund të ndihmojë në uljen e vartësisë ndaj substancave abuzive.





## MËRKURI KA FILLUAR TË LËVIZË NË ANËN E KUNDËRT

Mërkuri ka hyrë në fazën e tërheqjes - një fazë kjo që u mundëson vëzhguesve të qiellit të kënaqen me pamjet mahnitëse.

Sipas shkencëtarëve kjo fazë në të cilën ka hyrë Mërkuri mund të ketë ndikim negativ në komunikacion, teknologji, biznes dhe udhëtime.

Kjo ngjarje po fajësohet për shumë gjëra të këqija dhe të papritura që mund të ndodhin deri në përfundimin e saj.

Të gjithë planetët dhe objektet në sistemin

tonë diellor e kalojnë këtë fazë - jo vetëm Mërkuri. Marsi është jashtëzakonisht i veçantë në këtë fushë, për shkak se kjo fazë në këtë planet ndodh njëherë në dy vjet dhe se mund të shihet vetëm natën.

Faza e tërheqjes është kur planetët lëvizin në drejtim të kundërt në raport me planetët e tjerë, nga perëndimi në lindje. Astronomët thonë se planetët jo vetëm që po e ndryshojnë drejtimin, por po duket se po lëvizin në një mënyrë ndryshe nga Toka.

## MISTERET E TRURIT

Shumë të panjohura mendojnë shkencëtarët rreth trurit njerëzor. Ndërsa shkenca përparon ngadalë në të gjitha fushat, disa zona të trurit mbeten ende të errëta sa u përket njohurive që kemi për to. Truri është një nga pjesët më komplekse dhe më pak të kuptuara të trupit njerëzor. Fatkeqësisht, nëse do të ishte edhe më i thjeshtë, ne ende nuk do të mund të kuptonim një pjesë të paditurisë sonë.

Si funksionon ky grup qelizash që mund të krijojë kujtime, ndjenja dhe vetëdije? Është e mrekullueshme të mendosh se disa impulse elektrike, disa fjalë në ekran mund të na bëjnë të mendojmë për një send të caktuar dhe të njohim më mirë me anë të perceptimit botën që na rrethon.

Disa nga mendjet më të ndritura të neuroshkencës ende nuk arrijnë të zbulojnë saktësisht se çfarë e nxit trurin të punojë. Çfarë i jep njeriut personalitet? Cilat janë dallimet midis gjumit dhe zgjimit? A është vullneti i lirë një


iluzion? Përse është e vështirë të repikohen superkompjuterët?

Ja se cilat janë 8 misteret që vazhdojnë edhe sot të mendojnë shkencëtarët.

### SI ËSHTË TRURI KAO I SHPEJTË?

Të gjithë e shohin trurin e njeriut si një superkompjuter, por në fakt ai është shumë i ngadaltë. Shpejtësia me të cilën udhëtojnë sinjalet në tru është një e njëmiliona e shpejtësisë së sinjalit në kompjuter.

Pavarësisht kësaj, ne mund të njohim një fytyrë, një këngë apo një aromë menjëherë nga sa i duhet një kompjuteri për të kryer të njëjtin proces.



Është në dukje paradoksale, por mendohet se ka të bëjë me aftësinë e trurit për të përpunuar informacion në linja paralele, por gjithsesi mbetet një temë e panjohur.

### **NGA VJEN PERSONALITETI?**

Në vend që të thoni se keni një tru, është më e saktë nëse thoni që ju jeni truri. Ajo gjëja e qullët që keni në kokë me gjasa është vendi nga ka prejardhjen personaliteti juaj, por çfarë të veçante ka truri juaj që ju formëson juve?

Kjo është e gjitha pjesë e debatit natyra kundër mjedisit, çfarë pjese e personalitetit tuaj vendoset nga gjenet dhe fiziologjia, dhe sa vendoset nga mjedisi? Ideja është se personaliteti juaj duhet të jetojë në trurin tuaj, por ne prej qindra vjetësh nuk e dimë se si do të dukej truri nëse do të kishim të bënim vetëm me gjenet.

### **PËRSE FLEMË DHE ËNDËRROJMË?**

Gjumi është shumë i rëndësishëm. Pavarësisht rreziqeve të kalimit të një pjese të madhe të ditës dhe jetës në gjendje jo të ndërgjegjshme, të gjithë gjitarët dhe shpendët flenë. Është një gjë jetësore, por ne ende nuk e kemi idenë përse ndodh.

Si fillim, nuk ka arsye të vërtetë përse gjumi supozohet të na japë energji. Ne e marrim energjinë nga ushqimi dhe djegim shumë energji kur flemë. Por sërish kur zgjohemi nga gjumi ndihemi të freskët dhe më energjikë. E njëjta gjë i mundon shkencëtarët edhe për ëndrrat.

### **SI I RUAJMË KUJTIMET?**

Ashtu sikurse disku i ngurtë në një kompjuter, kujtimet kodohen fizikisht në trurin tonë dhe ne jemi në gjendje të mendojmë për ngjarje të së shkuarës. Shkencëtarët e trurit besojnë se në këtë mënyrë funksionon truri, por ne nuk e dimë nëse ka një mënyrë tjetër të funksionimit të tij nëse nuk do të ishte për kujtimet.

Ka shumë lloje kujtimesh

dhe shumë mënyra se si mund të kujtoni ngjarjet e së shkuarës. Kujtimet nuk ruhen si “bit”-et diskrete të kompjuterëve, por në fakt ka mënyra të ndryshme të kombinimit të neuroneve. Ne nuk e dimë me siguri si formohen ato, si zhduken apo çfarë e bën të mundur krijimin e kujtimeve false.

### **A JEMI VEÇSE KOMPJUTERË?**

Kohët e fundit njerëzit janë mundur nga ideja se truri njerëzor është veçse një përpunues klasik i informacionit - një kompjuter. Shumë i përparuar, por gjithsesi një kompjuter.

Nëse kjo është e vërtetë, atëherë duhet të jetë shumë e mundur të krijohet një mendje njerëzore në formën e një makinerie? Ky lloj kompjuteri do të kishte të gjithë vetëdijen dhe kompleksitetin e trurit real. Megjithatë, shkencëtarët nuk e kanë ende të qartë se si do të mund të krijonin një kompjuter po aq real sa truri, duke qenë se shumë veprime tonat nuk janë zbuluar se nga burojnë.

### **SI FUNKSIONON VAZHDIMISHT?**

Një fakt që ka habitur shumë shkencëtarë lidhet me mënyrën sesi truri vazhdon të punojë pavarësisht të gjitha rrethanave.

Një nga problemet më të mëdha që truri duhet të tejkalojë është se merr sinjale të ndryshme nga shqisa të ndryshme gjatë gjithë kohës.

Truri ynë është gjithashtu mjeshtër i iluzionit. Duke përdorur sisteme të ndryshme që funksionojnë si një i vetëm ne arrijmë të kuptojmë gjërat dhe të menaxhojmë gjithçka duke e bërë të duket si një eksperiencë e vetme.

### **ÇFARË ËSHTË NDËRGJEGJJA?**

Me gjasa ky është misteri më i madh i trurit njerëzor, si e krijon truri idenë e ndërgjegjes? Si funksionon ndërgjegjja jonë? Pavarësisht se shkencëtarët kanë zbuluar se çfarë e aktivizon dhe çaktivizon trurin, nuk dihet ende se si funksionon nënvetëdija.

Disa mendojnë se nënvetëdija është rezultat i ndërveprimeve të pafundme komplekse të trurit, por të tjerë mendojnë se ka disa elementë të trurit që kur bashkohen krijojnë ndërgjegjen. Misteret e trurit nuk kanë fund.

